




AMANET RAMAZANI
Doracak

Ismail Bardhi



© LOGOS-A
SHKUP
PRISHTINË
TIRANË
2019

Ismail Bardhi
AMANET RAMAZANI

Boton: LOGOS-A
Biblioteka: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Halil Berisha
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus Print
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

ISBN 978-9989-58-769-6

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2019

Tirazhi: 2000

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.


Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.



AMANET RAMAZANI

Ismail Bardhi




MENDIMI ISLAM

PËRMBAJTJA:

NË VEND TË HYRJES.....	11
RAMAZANI PA MILENIUME	15
Besimtarë – agjëroni!	15
Agjërimi	21
Nijeti	22
Kush është i obliguar të agjërojë	25
Kush nuk është i obliguar të agjërojë.....	25
Çka e prish/asgjëson agjërimin	26
Disa rregulla rreth agjërimit	26
Syfyri (sehuri) dhe iftari	27
Teravîh namazi.....	29
Bedri	30
Lejletu-l-Kadr.....	32
Itikafi	34
Sadekatu-l-fitri (apo vitret).....	35
Bajrami	36
RAMAZANI – LEXIMI LUTËS I KUR’ANIT	51
1) Ç’është ky “lexim lutës”?	54
2) Struktura e leximit lutës të Kitabit	57
TEOLOGJIA E RAMAZANIT	71
Teologjia e emancipimit	73
Relativizmi në kërkimin e së vërtetës	74
Ortodoksia dhe ortopraktika.....	76
Paraqitja e “New Age”	77
Parimi i shumicës	78
Temat aktuale.....	80
Si përfundim	81

PASQYRIMI METAFIZIK I AGJËRIMIT.....	85
AGJËRIMI NDËRMJET FESË DHE BESIMIT	95
RAMAZAN I RI.....	105
(Përshkrim sipas kohës dhe vendit)	105
KUR ËSHTË BAJRAM?!?.....	113
INTERVISTA PËR “SHENJA”.....	121
SHKURT	147



*Fëmijëve, nënave dhe të moshuarave të vrarë,
të pastrehë, të dëbuar dhe ... në Irak,
Libi, Jemen, Siri, Mianmar dhe gjetiu!*

“O besimtarë! Agjërimi u është bërë obligim i detyrueshëm, siç u ishte bërë obligim edhe atyre që qenë para jush, ashtu që të bëheni të devotshëm.”

(Kur’ani, 2:183)

“Dhe kur të të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet. Prandaj le të kërkojnë përgjigje prej Meje dhe le të më besojnë Mua, për të qenë të udhëzuar.”

(Kur’ani 2:186)

“Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: të dëshmosh se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij, të falësh namazin, të ndash zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe ta vizitosh shtëpinë e shenjtë të Allahut.”

(Hadith)

NË VEND TË HYRJES

Amaneti dhe Ramazani janë fjalë dhe emra që edhe tek ne janë shqiptarizuar, pra që përdoren (përfshirë edhe emrin e përveçëm Ramadan) dhe përmbajtja e tyre ka kuptim fetar dhe kulturor. *Amaneti* është term që është përdorur para kohës dhe hapësirës dhe është pranuar vetëm nga njeriu. Amaneti te ne përdoret në momentet më të vështira, më të rëndësishme të kohës, si p.sh.: *amanet gjuhën, amanet vendin, amanet namuzin/nderin*, ndërsa Kur'ani thotë: “*vahfedhu ejmanekum – përmbajuni amanetit*” (El-Maide, 89).

Tradita muslimane shqiptare me përgjegjësi dhe dashuri e ka kuptuar peshën e amanetit dhe të Ramazanit, respektivisht agjërimit; shqiptari është munduar që nga kjo traditë ta kulturojë kulturën dhe mënyrën e jetesës së tij. Për fat të keq, kohëve të fundit vërehen shenja negative në lidhje me këtë, sepse ka forca të ndryshme që mundohen të na zhveshin nga feja dhe nderi dhe ne, në vend që ta “ndihmojmë” Islamin, ta burgosim atë që as të tjerët të mos e pranojnë!

Në vijim po e përcjell një rrëfim që e kam dëgjuar nga rahmetli Mulla Beqa, i cili ishte një hoxhë i urtë, që e fliste gjuhën shqipe rrjedhshëm. Ai ishte imam në xhaminë e Jahja Pashës dhe ishte i njohur për “shpotitë” e tij. Por, para se të kryente shërbimin e tij në Shkup, ai kishte qenë imam edhe në Shqipëri “në kohën e Mbretit”, kur sapo kishte filluar të përhapej lëvizja komuniste shqiptare. Sipas rahmetliut, shtresa e urtë, e qytetëruar, e vendit e kishte kuptuar shejtanllëkun e kësaj lëvizjeje, që u bë “mbarë-

shqiptare". Një ditë prej ditësh, siç ka qenë dhe mbetet traditë, ishte ftuar hoxha në një familje muslimane dhe aty kishin ardhur edhe aktivistët e rinj të komunizmit. Në mesin e tyre kishte qenë edhe Mehmet Shehu. Natyrisht, hoxha ka folur duke u mbështetur mbi fjalorin e fesë dhe kulturën e saj, që për marksistët ka qenë "opium". Siç duket, rahmetli Mulla Beqa e kishte kuptuar që në fillim më mirë se ata të cilëve u janë dashur dekada të tëra për ta kuptuar këtë lëvizje dhe këtë person me "nam", që ua bëri bashkëkombësve të tij atë që nazizmi ua bëri çifutëve. Me një fjalë, ajo që shqiptarët ia kanë bërë dhe vazhdojnë t'ia bëjnë njëri-tjetrit nuk ka paralele në botë dhe histori. Nga fjalët e këtij demagogu, që më vonë arriti të bëhej njeriu i dytë në Shqipëri, rahmetli Mulla Beqa ishte nxehur aq shumë, sa ia kishte futur një shuplakë në mes të mexhllisit. Natyrisht, kjo më pas ishte një nga arsyet që ai duhej ta braktiste Shqipërinë, sepse i shkonin në vesh fjalët se "hoxha duhet likuiduar".

Në kontekst të amanetit të Ramazanit, Mulla Beqa rrëfente edhe për atmosferën e agjërimit në kohën e tij, që më kujtohet shumë mirë, dhe të cilën ai e përshkruante si vijon: "Muaji i Ramazanit ishte një muaj të cilin mbarë Shqipëria e priste me respekt. Por, diçka më e thellë dhe më me peshë se kjo ishte se tri ditët e fundit para Bajramit për dyqanxhinjtë dhe besimtarët e pasur ishte periudha e regjistrimit të mallit, që në fakt ka qenë përgatitje për dhënien e *zekatit* dhe *sadakatul fitrit*, andaj gjatë këtyre ditëve rrugët e qyteteve ndriçoheshin me llamba vajguri.". Me një fjalë, një përshkrim i Shqipërisë dhe shqiptarëve si "Jerusalem i Ballkanit".

Edhe ky ribotim i zgjeruar bëhet për arsye se koha është shumë e vështirë, përplot frikë dhe pasiguri; sepse i

mençuri e ka humbur rrugën, lirinë; sepse njeriu kurrë nuk ka qenë aq i robëruar siç është sot; sepse edhe të mundurën e mbështet diku; sepse ka frikë të mendojë; sepse tradhtia dhe mashtrimi janë bërë “shpëtim”. Ndërkaq agjërimi është mundësi që të përjetohet një liri që nuk vjen nga poshtë, por nga lart, dhe që mundëson të lirohemi nga brengat e sipërpërmendura, ngaqë ajo është mburoja më e mirë. Ne e kemi të domosdoshme ta ruajmë, ta mbrojmë, këtë muaj, sepse ky është muaj që e përgatit shpirtin dhe mendjen e njeriut për shenjat e *kijametit*: me një fjalë, që e bën njeriun të reshtë së frikësuar.

Kjo përmbledhje bëhet në një kohë kur thuajse përsëritet fillimi i shekullit të 20-të. Ishte ajo kohë dëbimesh, luftërash, masakrash, uzurpimesh dhe grabitjesh... thuajse njësoj si kjo koha jonë, ku shumë shtete u shkatërruan, u plaçkitën dhe kur “e arritura” më e madhe ishte helmimi e asgjësimi, respektivisht eksperimentimi i prodhimeve të mendjes “së robëruar” me fëmijët, nënat, të moshuarat. Dhe, për gjithë këtë nuk di ç’të them tjetër, veçse: “frikë dhe drithërimë”!

Koha e agjërimit është koha që mbështetet mbi një lashtësi, e cila me një urtësi të thellë e mbron dhe e përgatit shpirtin e njeriut që ta luftojë fuqinë e demonit, respektivisht shejtanit më të madh në botë; e shejtani më i madh në botë sot është teknologjia dhe “globalizmi”, që është duke na e marrë lirinë dhe duke na i robëruar mendjen dhe nderin. Agjërimi është koha dhe mundësia që në lutje dhe heshtje të luftohet diçka e tillë.



RAMAZANI PA MILENIUME

Besimtarë – agjëroni!

Edhe pse është e vërtetë që Zoti e ka vulosur fenë ashtu siç është ajo në esencën e vet fillestare dhe përfundimtare, kur askush nuk ka ekzistuar që ta dëgjojë, ta shohë e ta përjetojë atë pa urdhrin e Zotit, vërtetësia e fesë dëshmohet edhe me vetë *ajetin/shenjën* e Kur'anit, ku Allahu *xhel-le shanuhu* thotë: “*Nuk krijova xhinn dhe ins/njerëz pos që të Më adhurojnë*” (51:56). Qëllimi i paraqitjes së krijesës në këtë botë nga Zoti është që ai të jetë i nënshtuar, i dëgjueshëm vetëm ndaj Perëndisë. Pa këtë humb gjithçka. Kjo vërtetësi e fesë medoemos vërtetohet në çastet e fillimit dhe të përfundimit të çdo sendi (3:83). Ndër këto dëgjueshmëri dhe bindje është edhe urdhri i Zotit: *Agjëroni besimtarë!*

Lutja islame edhe në aspektin kohor ka një formë të gjallë lëvizëse e cila për çdoherë ia ngjyros çdo çast të jetës njeriut besimtar. Këtë në fakt atij ia mundëson kalendari lunar të cilin e kanë muslimanët, sepse nuk ka kohë, stinë e ditë që përputhet me datën statike e të mos ketë lutje, festë fetare dhe agjërim – zbritje të Shpalljes.

Që ta vërtetojë pavdekshmërinë e fesë Zoti bën intervenimin e përsëritur të përhershëm të urdhrave të Tij, edhe pse në shikim të parë kjo mund të duket si një tautologji pa ndërrime dhe ndryshime, por, për çdoherë i ngjan zanafillës së vet, sepse kemi bindjen dhe mosbindjen, dënimin dhe shpërblimin gjithmonë të regjistruara në freskinë e tyre. Agjërimi si lutje e tejkalon çdo përmasë të lutjeve të tjera për shkak se gjithë të lejuarën për një çast

Zoti e bën të ndaluar: Ai e bën hallallin haram, gjë që për logjikën është e pakapshme. Këtu vërtetohet edhe ajo se Zoti kur ndalon nuk ndalon që të krijojë fyerje, por me qëllim që të kërkojë nga krijesa më e lartë vetëm devotshmëri, respekt, heshtje, dëgjim, bindje, flijim.

Nënshtrimi të Vërtetës dhe bindja, qenësinë njerëzore e shndërrojnë në përsosuri, që do të thotë se njeriu është në gjendje sikur e sheh Zotin.: *sepse edhe pse nuk e sheh Atë, Ai e sheh atë*. Zoti i përfshin shikimet, ndërsa shikimet nuk e përfshijnë Atë. Arsyeja është e verbër, ndërsa zemra është për të shikuar. Prandaj në të takohen “shikimet” e zemrës së shikuar. Këtë agjërimit ia mundëson besimtarit.

Një herë në praninë e as’habëve Pejgamberit i paraqitet Xhibrili *alejhis-selam* në formë të dukshme të “njeriut”, jashtëzakonisht i pastër, pa gjurma mbi vete se ka udhëtuar, për asnjërin i njohur, dhe i drejtohet Muhammedit *alejhis-selam* duke e pyetur për nënshtrimin (*islam*), bindjen (*iman*), bukurinë (*ihsan*) dhe Çastin (*saat*) me qëllim që “t’i mësojë ata në fe (*din*)”. Këtu bindja është shënuar me atë të cilës ajo i përket: me Zotin, *melekët* e Tij, librat e Tij, lajmëtarët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe larjen e borxhit të së mirës dhe të keqes së tij. Bindja e tillë përfshin besimin në të vërtetën e asaj të cilës i përket, e ajo është realiteti i vërtetë i asaj që është. E kur njerëzit kanë bindje të tillë do të thotë se asaj plotësisht ia nënshtrojnë veprimin e vet. Pejgamberi *alejhis-selam* thotë: “Bindja është njohje në zemër, shqiptim me gjuhë dhe veprim me gjymtyrët.” Sipas kësaj, bindja përfshin njohjen, të folurit dhe të vepruarit. Mirëpo fjala është për “njohjen në zemër”. Njohja e tillë e mundëson përsosurinë njerëzore. Ajo është të parit e shumësisë në njëjësinë dhe njëjësisë në shumësinë. Asaj i përgjigjet zemra, si aftësi njerëzore e lidhjes së

drejtpërdrejtë me Mendjen, apo njohjen e dukurive në vërtetësinë e krijueshmërisë së tyre burimore. Njohja e dukurive ndarë nga zemra i redukton ato në jashtësinë e tyre, që shprehet në gjendjet e ndryshme të “verbësisë”, “ndryshkjes”, “ngurtësisë” dhe “sëmundjes” së zemrës. Gjendja e tillë do të thotë të kihet zemër por të mos kuptohet (7:179). Bindje mund të ketë vetëm zemra e shëndoshë, ndërsa atë Zoti e shkruan në zemër (58:22). *“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin”* (48:4).

Ajo është njohuria më e lartësuar. Ajo është e brendshme dhe e pandashme nga të qenit. E kur ajo ta ndriçojë shpirtin, ndahet në format e veta të ndryshme, kështu që mund të jetë ndjenjë apo e folur e arsyeshme. Ai i cili di/njeh në zemër atë njohuri e tregon me të folurit e tij. Gjendja e arsyes është reflektim i Mendjes, ndërsa të folurit – dyanshmëri e arsyes me Mendjen. Të folurit e tillë është në përputhje me njohurinë e zemrës; ajo është lidhje me krijimin, meqë Zoti krijon me “Fjalë”. Prandaj të vepruarit është e pandashme nga të folurit. Mirëpo fjala mund të ndryshojë në vepër për shkak të mundësisë së njeriut për zgjedhje të lirë. Ndryshimi i fjalës që është në reciprocitet me njohurinë në zemër, e degradon qëllimin njerëzor: *“Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni”* (61:3). Ajo që është e njohur në zemër dhe e shprehur në fjalë e vërteton veprimin me gjymtyrët apo *amelun bi'l-erkan*.

Nënshtrimi dëshmon veprimin, e në pajtim me këtë edhe është i përfshirë në bindjen. Nga kjo rrjedh se bindja kërkon edhe nënshtirim por edhe ajo se çdo nënshtirim nuk është edhe bindje. Nënshtrimi ose veprimi është paraqitje e të pamatshmes në botën e matshme. Njohuria për

atë që është në zemrën e njeriut nuk është e arritshme për askënd, pos për Allahun: *“Kurse Allahu e di se çka ka në zemrat tuaja”* (33:51). Të shfaqurit e asaj njohurie në të folur është në dispozicion edhe të të tjerëve, por gjykimi për harmoninë me të brendshmen – vetëm Zotit. Mirëpo, të vepruarit në botë është e matshme, prandaj për të mund të gjykojnë edhe të tjerët. Në dallimin e nënshtrimit (*islam*) dhe bindjes (*iman*) tregon *ajeti* (49:14): *“Beduinët thanë: ‘Ne kemi besuar!’ Thuaj: ‘Ju nuk keni besuar ende, por thoni: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja. E nëse e respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është shumë mëkatfalës, shumë mëshirues’.*” Bindja është në zemër, por të shprehurit e saj në botën e shumësisë është e mundur në vepra. Mirëpo fjalët dhe veprat nuk mund të themelohen në *“njohurinë në zemër”*, si shprehet Shpallja: *“... Ata ju bëjnë lajka me fjalët e tyre, kurse zemrat e tyre kundërshtojnë...”* (9:8).

E kundërta e bindjes është mohimi i asaj që është e njohur (*kufr*). Krijimi i njeriut është i qartë, por e tillë është edhe mundësia e dukshme e dy përgjigjeve para kësaj qartësie – falënderimi dhe mohimi. Përgjigjen e parë e shprehin edhe fjalët e Pejgamberit *alejhis-selam*: *“Çdo e mirë është në duart e Tua, ndërsa e keqja nuk të kthehet Ty.”* Meqë me posedimin e zemrës njeriut i është mundësuar njohja e së Vërtetës, bindja është njohje e asaj të vërtete me fjalë dhe vepër, ndërsa mohimi – refuzim i saj me fjalë dhe mosveprim. Prandaj bindja është unitet i njohurisë, të folurit dhe të vepruarit.

Tradita shënon se kur meleku Xhibril e pyeste Pejgamberin Muhammed *alejhis-selam*: *“Më thuaj ç’është ihsani?”* *“T’i bëhesh rob Zotit sikur je duke e parë Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh, Ai vërtet të sheh ty”*, u përgjigj ai.

Lidhjes foljore “vepro atë që është mirë dhe bukur” i përgjigjet folja kur’anore *ihsan*. Kështu, duke u nisur nga përcaktimi i asaj foljeje në *Hadithin* e njohur në të cilin Xhibrili e pyet Pejgamberin *alejhis-selam* për “nënshtrimin” (*islam*), “bindjen” (*iman*), “kryerjen e asaj që është mirë dhe bukur” (*ihsan*) dhe “Çastin” (*saat*) mund të vërehet reciprociteti qenësor i veprimit të tillë dhe robërimit: “Të vepruarit e asaj që është e mirë do të thotë t’i bëhesh rob Zotit sikur je duke e parë Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.” Nënshtrimi e përcakton veprimin, ndërsa bindja veprimit ia jep shprehjen e arsyeshme dhe themelimin e tij në zemër, nëpërmes së cilës njohuria e arsyeshme është shprehje e shembujve mbi-individuale të çdo gjëje në Mendje. Të kryerit e asaj që është e mirë dhe e bukur veprës, shprehjes dhe diturisë ia jep kuptimin më të thellë dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me Bukurinë si thirrje e së Vërtetës. Domethënë, në pajtim me këtë, Bukuria është përmbajtja më e lartësuar e nënshtrimit dhe bindjes. Ajo është thelb i çdo qëllimi të lidhur me Realitetin. Njeriu i kthehet natyrës së tij burimore dhe e njeh veten pikërisht nëpërmjet kryerjes së asaj që është e mirë dhe e bukur. Kjo është udha e vendosjes së përsosurisë njerëzore si mundësi më e lartësuar.

Këtë përmasë të bindjes kemi mundësi ta vërejmë në të gjitha lejetet dhe ndalimet që Zoti i ka urdhëruar në Librin e Shenjtë. Një ndër to është edhe agjërimi. Agjërimi i muajit të Ramazanit është ndër ndodhitë më gjallëruese që ka mundësi t’i përjetojë besimtari musliman. Në këtë muaj fillon zbritja e vetë Shpalljes si vulosje e fundit e saj, lufta e Bedrit me ushtarë të dukshëm dhe të padukshëm, fitore e garantuar nga vetë Zoti. Më në fund kemi *Lejletu-l-Kadrin*, që është më e mirë se njëmijë muaj.

Për shkak të karakterit të tekstit dhe me qëllim që ai ta ketë formën më të lehtë të kuptimit të agjërimit, së pari do të fillojmë me vetë *ajetet* të cilat flasin mbi këtë urdhër të Zotit:

“O besimtarë! Agjërimi u është bërë obligim i detyrueshëm, siç u ishte bërë obligim edhe atyre që qenë para jush, ashtu që të bëheni të devotshëm.

Në ditë të caktuara me numër, por ai nga ju, i cili është i sëmurë ose në udhëtim – atëherë tjera ditë me të njëjtin numër. Ndërsa ata që nuk mund ta mbajnë – kompensimi është të ushqejnë një varfanjak. Dhe kush jep më tepër, vullnetarisht, ajo është aq më mirë për atë. Por të agjëroni është më mirë, ta dini.

Muaji Ramazan është ai në të cilin filloi të shpallet Kur’ani, udhëzim për njerëzit dhe argument i qartë i rrugës së drejtë dhe dallimit të së mirës nga e keqja. Cili prej jush që do ta arrijë atë muaj, ta agjërojë atë, e kush është i sëmurë ose ndodhet në rrugë, të njëjtin numër ditësh le ta agjërojë më vonë! Allahu ju dëshiron lehtësim e nuk ju dëshiron vështirësi. Por ditët e caktuara t’i plotësoni dhe Allahun ta madhëroni për shkak se u ka udhëzuar në rrugë të drejtë, mbase do të jeni mirënjohës.

Dhe kur të të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet. Prandaj le të kërkojnë përgjigje prej Meje dhe le të më besojnë Mua, për të qenë të udhëzuar.”

(Kur’ani, 2:183-186)

“Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: të dëshmosh se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij, të falësh namazin, të ndash zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe ta vizitosh shtëpinë e shenjtë të Allahut.”

(Hadith, Muttefekun alejh)

Kur'ani dhe *hadithet* e shumta këtij *ibadeti* ia kanë dhënë formën më të plotë, gjë që edhe sot ne muslimanët jemi duke e praktikuar. Por që ta kemi më të sistematizuar këtë lutje do të përcaktohem duke i dhënë po ato përkufizime të caktuara në mënyrë më të shkurtë, si p.sh.: koha e agjërimit, nijeti, rregullat e agjërimit, kush është dhe kush nuk është i obliguar të agjërojë, çka e prish agjërimin, *iftari* e *syfyri* (*sehuri*) dhe bukuritë e tyre, *teravih* namazi, *sadekat'ul fitri*, *i'tikafi* dhe *Bajrami*.

Agjërimi

Fjala *saum* ndër të tjerat ka kuptimin: agjërim, qëndrimi pa ushqim, heshtje, strehim nën hije, qetësim, përkorë, heqje dorë, shijim (i vdekjes) etj. Kuptimi thelbësor i kësaj fjale sipas konotacionit mekkas është “të bëhesh i qetë”, “heshtje” (19:26). Por, sipas konotacionit medinas merr formën e “të agjëruarit e muajit të Ramazanit”, e që është përfundimtar.

Agjërimi ka 5 kategori juridike: *farz* (p.sh. muaji i Ramazanit); *kadha* (kur duhen agjëruar ditët e lëna gjatë Ramazanit me arsye); agjërimi me të cilin dikush është zotuar (me betim – *jemin*); *kefare*t (në kushte kur bëhet shpërgim për kundërvajtje); *istiska* (kur vendoset për t'iu lutur Zotit për siguri në këtë botë, si p.sh. për rënien e shiut në kohën e thatësisë). Agjërimi i Ramazanit për muslimanët është bërë *farz* në vitin 2 sipas Hixhrit. Caktimi i kohës së fillimit të agjërimit vërtetohet me paraqitjen e Hënës së re (fillimit të muajit sipas kalendarit lunar Hixhri), siç ka thënë edhe Pejgamberi *alejhis-selam*: “Agjëroni kur ta shihni (Hënën e re), e hani kur ta shihni, e nëse në këtë ju pengojnë retë, atëherë plotësojeni (muajin) Sha'banin me tri-

dhjetë ditë” (Muttefekun alejhi). Verifikimi i paraqitjes së Hënës së re në ditët e sotme mund të bëhet në mënyrë më të përpiktë, duke shfrytëzuar arritjet shkencore-teknike. Por, që mos të vijë deri te çrregullimi i harmonisë midis muslimanëve të një vendi, është e këshillueshme që të ndiqet vendimi i autoritetit më të lartë fetar të vendit të caktuar, dhe atë sipas *hadithit* të Pejgamberit *alejhis-selam*: “Bajrami i Ramazanit është kur populli ha, ndërsa Bajrami i Kurbanit është kur populli ther kurban” (Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe të tjerë). Përgjegjësia e udhëheqjes së besimtarëve është e madhe që të ketë kujdes për këtë çështje me rëndësi të veçantë dhe t’i informojë ata me kohë, që ta largojë çdo mosmarrëveshje të papëlqyeshme. Përpjekjet individuale lidhur me fillimin dhe mbarimin e agjërimit duhet të jenë të kujdesshme dhe me kulturë të lartë po ndaj këtyre vendimeve. Kjo nuk do të thotë se përgjegjësia individuale apostrofohet. D.m.th., agjërimi është të agjërosh për Zotin, duke krijuar bindje sa më të fortë dhe pastërti shpirtërore në kohë të caktuar.

Nijeti

Nevejtu en-esume gaden lil-lahi te’ala – “vendosa që nesër të agjëroj për Allahun e Lartësuar”. Që një *farz/vaxhib* i fesë të kryhet sipas rregullave fetare patjetër duhet bërë *nijet* (vendosje e qëllimit), d.m.th., para fillimit, duhet përcaktuar dhe qëllimzuar lutjen, *ibadetin*. *Nijeti* përpos në vete është bukur të thuhet edhe në mënyrë të dëgjueshme – për vetveten. Kjo ngaqë *ibadeti* i bërë pa *nijet* në terminologjinë fetare është i quajtur *batil*, i kotë. Pejgamberi *alejhis-selam* thotë: “*In-nemel a’malu bi-n-nijjat* – Pa dyshim, veprat janë sipas qëllimeve (nijeteve)”. Në këtë drejtim Ga-

zaliu në veprën e tij *Ihja...* thotë: “Ibadeti pa *nijet* është i pavlerë”. Në tërë procesin e lutjes/*ibadetit* kërkohet qëllimi, *nijeti*. Po ashtu, siç thotë edhe Ebu Is’hak esh-Shiraziu: “Vazhdimësia e *nijetit* është e domosdoshme deri në përfundimin e *ibadetit*”. *Nijeti* buron nga zemra, e zemra njëkohësisht është edhe hapësira ku pasqyrohen arsyeja dhe vëmendja. Për këtë arsye, *nijeti* në jurisprudencën islame emërohet si *fi’l sher’i*, vepër Sheriati. Sipas El-Baxhuriut ekzistojnë katër parakushte për realizimin e *nijetit*: ai që bën *nijet* duhet të jetë besimtar; të jetë me arsye të shëndoshë; të jetë i vetëdijshëm për veprën e caktuar dhe të ekzistojë mundësia për kryerjen e asaj vepre. Lidhur me *nijetin* përsëri vërejmë edhe problem që ka të bëjë me besimin në Zotin, i cili nuk lejon mospërcaktimin e qëllimit dhe vendosjes, ngase ndër fjalët më të urryera tek Ai janë: “O Zot, më fal nëse dëshiron”. Lidhur me këtë Pejgamberi *alejhîs-selam* ka thënë: “Le t’ia parashtojë njeriu Allahut kërkesën e tij me një qëndrueshmëri dhe me një qartësi të theksuar. Për Allahun asnjë kërkesë nuk është e tepërt apo përtej (fuqisë së) Tij”. Forca e *nijetit* vërehet në mënyrë paradoksale, si p.sh. në rastin kur për shkak të harresës, lodhjes ose gjatë kryerjes së lutjes pa dashje thyhen rregullat e agjërimit, e në anën tjetër agjërimi nuk priset. Të gjitha këto nuk ndikojnë aspak në prishjen e *nijetit*. Për atë që pa qëllim e prish agjërimin, d.m.th., nëse ai person ha diçka pa qenë i vetëdijshëm, Pejgamberi *alejhîs-selam* ka thënë: “Allahu e ka ushqyer atë”. Këtë formë, këtë përgatitje Krijuesi e kërkon nga krijesa e tij, njeriu, që t’i tregojë se asnjë segment i jetës së tij nuk është shpërfillur nga Ai.

E problemet që e rrethojnë besimtarin e hapësirës sonë janë të shumta. Ai e ka humbur kuptimin e jetës, ka

filluar të dyshojë në çdo gjë, ka filluar t'iu besojë vetëm fjalëve dhe të luftojë për fjalët, edhe pse historikisht ato e kanë tradhtuar dhe e kanë lënë pa strehë. Duke patur parasysh momentet tona dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohemi, do të dëshiroja që forcën e *nijetit* ta interpretoj duke u bazuar në realitetet tona të sotme. Besimtarit shqiptar, në kohën kur të tjerët krijojnë shtet, i ndodhi që jo t'i forcohet shteti, por ai t'i varfërohet dhe t'i shkatërron. Në hapësirën e tij gjeografike i është lejuar që t'u lihet vend eksperimenteve të ndryshme dhe realizimeve të misionarëve të ndryshëm. Atij i ndodh që për një çështje të ketë shumë zgjidhës, për një vend të ketë shumë kryetarë, ta ketë një vend të ndarë për shumë të tjerë. Përfundimisht ai nuk di se a është i sigurt për vetveten në shtetin e vet. Besimtari i provinencës islame medoemos duhet të tregohet si njeri i cili i ka plotësuar kushtet elementare për *nijetet* (qëllimet) e veta, natyrisht i vetëdijshëm se për çka ka vendosur. Vendosja dhe qëllimet për vepra doemos duhet ta ndjekin atë gjatë tërë jetës për realizimin e tyre. Agjërimi si *ibadet* nuk është i pranuar tek Zoti edhe nëse kryhet apo ekziston në mënyrë formale – vetëm se për shkak të mosvendosjes për të (mungesës së *nijetit*) ai shkon kot. *Nijeti* në formën e theksuar më sipër me të vërtetë është më se i nevojshëm për besimtarët që synojnë të jenë të lirë, të dinë ta mbajnë atë që ua ka dhënë Zoti. Natyrisht se edhe ky muaj i agjërit besimtarin duhet ta përkujtojë për këtë moment shumë të rëndësishëm – *nijetin*. Ai duhet të betohet se qëllimet e veta do t'i vazhdojë derisa t'i kryejë në mënyrën më të mirë, do të thotë, do të bëhet i pjekur, i rritur dhe të dijë të vendosë për iman, fe e vatan.

Kush është i obliguar të agjërojë

Për çdo kusht të fesë ekzistojnë norma/rregulla të caktuara të cilat duhet të plotësohen që ai të jetë i pranuar. Sa i përket agjërimin, kushtet për kryerjen e këtij obligimi janë që: *personi të jetë musliman, të jetë i pjekur (në moshë) sipas Sheriatit, të ketë arsye të shëndoshë, të mos jetë udhëtar, të mos jetë i sëmurë, nëse është femër mos të jetë me të përmuajshmet apo lehone* (femra gjatë të përmuajshmeve dhe lehonisë nuk guxon të agjërojë, por pas kalimit të asaj gjendjeje duhet ta agjërojë numrin e njëjtë të ditëve të lëna). Po ashtu edhe udhëtari është i liruar nga ky obligim, por Kur'ani e plotëson këtë duke thënë: *“Por, të agjëroni është më mirë, ta dini”*. Edhe i sëmuri duhet t'i ndjekë rregullat e parapara, por vetëm nëse sëmundja verifikohet me diagnozën përgjegjëse mjekësore se agjërimi i tij rrezikon jetën, kështu që në atë rast ai është i liruar nga agjërimi. Mirëpo, kusht për lirim e këtillë është që ai të japë *fidje* – shpagesë, respektivisht të ushqejë një të varfër për çdo ditë që nuk e ka agjëruar dhe atë vetëm nëse ka sëmundje nga e cila nuk mund të ketë përmirësim të gjendjes së tij shëndetësore.

Kush nuk është i obliguar të agjërojë

Që të plotësohet teksti i lartshënuar duhet theksuar anën tjetër të tij. D.m.th., nuk janë të obliguar të agjërojnë: *jomuslimani, fëmija i cili akoma nuk është i pjekur sipas Sheriatit, personi me të meta psikike* (ai as nuk duhet të agjërojë e as nuk është i detyruar të japë *fidje*, *personat e matufosur, pleqtë në moshë të shkuar të cilëve agjërimi ua rrezikon shëndetin, por këta duhet të japin fidje për çdo ditë të paagjëruar* (nëse kanë mundësi), *të sëmurët të cilëve agjërimi ua rrezikon shëndete-*

tin e të cilët duhet të agjërojnë ditët e lëna pas përmirësimit të gjendjes së tyre shëndetësore (nëse nuk u përmirësohet gjendja ata duhet dhënë fidje), gratë shtatzëna ose gjidhënëse nga frika se agjërimi do t'ua çrregullojë shëndetin, me të vetmin kusht që ditët e lëna t'i agjërojnë më vonë.

Siç u tha më lart nuk janë të obliguara të agjërojnë as gratë të cilat janë me të përmuajshmet si dhe lehonat, të cilat duhet t'i plotësojnë ditët e lëna pas kalimit të gjendjes në të cilën janë. Edhe personi që është i detyruar ta prishë agjërimin me qëllim që ta shpëtojë dikë nga rreziku i jetës atë ditë duhet ta agjërojë më vonë. Udhëtari po të dëshirojë mund të agjërojë, por nuk është i obliguar për këtë; në qoftë se nuk agjëron, ditët e lëna duhet t'i plotësojë më vonë.

Çka e prish/asgjëson agjërimin

Prishja apo asgjësimi i agjërimit bëhet: qëllimisht (*ta'amut*), me dije (*ilm*) dhe me vullnet të lirë (*ihtijar*). Këto janë bazat kryesore të cilat e vënë në peshojë arsyeshmërinë e personit, por kemi kategori të cilat bazohen mbi këto dhe që e prishin agjërimin, si: futja e çfarëdo gjëje në trup në qoftë se kjo bëhet me vetëdije, e që ka mundur të pengohet (p.sh. marrja e ushqimit dhe pijes; thithja e tymit (pirja) të duhanit etj.); vjellja e qëllimshme; marrëdhënia seksuale; derdhja gjatë ditës e shkaktuar me vetëdije dhe qëllimisht (vetëkënaqja); pranimi i injeksioneve ushqimore apo vitaminoze; marrja e gjakut në damarë; gjakderdhja gjatë të përmuajshmeve dhe gjatë lehonisë të gratë.

Disa rregulla rreth agjërimit

Agjëruesit i lejohet të agjërojë edhe duke qenë *xhunub* (i papastër) dhe të lahet edhe pas agimit të diellit. Edhe

nëse njeriu pa qëllim bëhet i papastër gjatë ditës (nëse vjen deri te derdhja në gjumë apo nga lodhja), ai vetëm duhet të lahet ndërsa agjërimi nuk i asgjësohet. Gruaja të cilës i mbarojnë të përmuajshmet apo gjendja e lehonisë duhet të agjërojë madje edhe nëse nuk mbërrin të lahet para agimit. Agjëruesit i lejohet mjekimi i dhëmbëve, madje edhe shkulla e tyre, me kusht që të mos e gëlltisë gjakun (natyrisht lejohet edhe anestezioni i duhur gjatë shkulljes së dhëmbit). Agjëruesit i lejohet që të mjekohet duke marrë pika për sy dhe për vesh, madje edhe nëse shija e tyre ndjehet në fyt. Të sëmurëve nga astma u lejohet ta përdorin inhalatorin (pompën) gjatë agjërimit. Agjëruesit i lejohet shpëlarja e gojës, pastrimi i dhëmbëve, të freskohet apo lahet por gjithnjë me kusht që të ketë kujdes se mos të futet ujë në trupin e tij. Agjërimin nuk e asgjëson marrja erë e aromatikëve, por duhet shmangur kësaj. Gatuesit apo gatueses të ushqimit i lejohet ta shijojë ushqimin me majën e gjuhës dhe menjëherë ta nxjerrë atë. Bashkëshortëve u lejohet çdo gjë që nuk shpie deri te eja-kulimi, d.m.th. puthja apo përkëdhelja lejohen.

Syfyri (sehuri) dhe iftari

Muhammedi *alejhis-selam* thotë: “Ngrihuni në syfyr, sepse vërtet në syfyr ka bereqet.” Ai po ashtu thotë: “Vija ndarëse mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ehl-i kitabit (ihtarëve të Librit) është ngrënia e syfyrit”.

Syfyri apo *sehuri* është forma që përsëri njeriu e thërrret në vetë-disiplinim. *Syfyri* ka shije tjetër të ushqimit, ai ka lëshuar rrënjë të thella në këtë hapësirë: edhe në atë kohë kur jashtë vërehet një vdekje e natyrës, agjëruesit korrrespondojnë duke zgjuar njëri-tjetrin nga gjumi, duke

dërguar ushqim. Traditë e syfyrit tek ne ka qenë dhe akoma mbetet përgatitja e petave, ose “mantive”.

Në literaturën fetare islame vërejmë shkrime që kanë vlera të thella mistike, po ashtu edhe kulturore fetare që tregojnë bukurinë, heshtjen momentale, shenjtërinë e ushqimit që vetëm agjëruesi mund ta përjetojë. Ndër të tjerat ky moment është edhe nga ato që i ngjasojnë bukurive të xhennetit – aroma e bukur e *iftarit* faktikisht edhe e ka këtë përmasë. Pejgamberi *alejhis-selam* ka thënë: “Agjëruesi në kohë të iftarit posedon *duâ* që nuk refuzohet”, dhe “Njerëzit janë në të mirë përderisa e nxitojnë iftarin”. *Iftarin* Pejgamberi jonë *alejhis-selam* e ka filluar me hurmë.

Me të vërtetë në kohën e iftarit dyert kah qielli janë të hapura për besimtarin, atij i mundësohet që sinqerisht t’i drejtohet Zotit me lutjet më të mira, duke thënë: “*Allahu-mme inneke afuvvoun tuhibbul afove fa’fu anni.*” (“*Allahu im, me të vërtetë Ti je Ai që falë dhe dëshiron të falësh, pra më fal.*”).

Përveç kësaj kemi edhe lutjen para iftarit: “*Allahumme leke sumtu, ve bike amentu ve alejke tevekkeltu ve ala rizkike eftartu.*” (“*O Zot, për Ty agjërova, Ty të besoj, në Ty mbështetem dhe me begatitë Tua iftar bëj*”).

Në traditën muslimane vërejmë një bukuri të jashtëzakonshme dhe kulturë të lartë të gatimit. Për iftar përgatiten ushqime të veçanta apo tradicionale dhe atë të llojllojshme. Me rëndësi është se te familjet të cilat mundohen të kenë rregulla jetësore dhe kulturë të lartë familjare apo shtëpiake, nga fëmijët dhe të rriturit kërkohet që të ulen së bashku për iftar, para iftarit duke lexuar Kur’an e në kohën e iftarit duke bërë lutje të përbashkët Allahut, duke kërkuar nga Ai falje, begati dhe udhëzim jo vetëm për vete por edhe për mbarë njerëzimin, e sidomos ndihmë për ata të cilëve u bëhet padrejtësi e madhe në këtë botë.

Nuk është e ndaluar të plotësohet dhe të zbukurohet ky moment i rëndësishëm për çdokënd në mënyrë të veçantë; ky është prej momenteve kur edhe fizikisht shpirtit i mundësohet të depërtojë, respektivisht ta përjetojë peshën e metafizikës, duke heshtur, duke u lutur. Duhet patur kujdes se si kalohet kjo kohë, ajo nuk lejon zhurmën, çmendurinë e televizorit dhe mungesën e kulturës.

Teravih namazi

Është namaz i cili kryhet në mbrëmjet e muajit të Ramazanit. Transmetohet se Muhammedi *alejhis-selam* i ka çmuar lartë ato namaze, por gjithashtu ka tërhequr vërejtjen se ato nuk duhet të bëhen të obligueshme. Konsiderohet se Omeri r.a. i ka tubuar pas një *kariu* (lexuesi të Kur'anit) ata që individualisht apo në grup faleshin në xhaminë e Medines. Gjithashtu rrëfëhet se përparësi i jepte pjesës së parë të natës për këtë lloj namazi. E drejta islame parasheh që *teravija* të falet menjëherë pas namazit të jacisë. Ai përbëhet nga dhjetë *taslime*, secili prej të cilëve ka dy *rekate*; pas çdo katër rekatesh ka pushim, prej nga edhe emërimi "pushim", *teravih*. Namazi i teravisë mund të falet individualisht por më e pëlqyer është që të kryhet në grup (*xhemat*). Duke mos u thelluar në interpretimet e ndryshme medh'hebike, *teravih* namazin ne e falim siç u tha më lart, d.m.th., 20 rekate. Kjo traditë e rrënjosur në kulturën muslimane edhe të hapësirës sonë shqiptare kërkon që meqë është muaji i zbritjes së Kur'anit, në të sa më shumë të lexohet Kur'ani, natyrisht duke patur parasysh që të mos shkaktohet mundim ose lodhje tek muslimanët. Kjo nuk do të thotë se gjatë *teravih* namazit duhet lexuar shpejtë e vetëm *ajete* të shkurta, gjë që për fat të keq është

dukuri e përhapur tek ne. Tek ne ka qenë praktikë që të ketë xhami të caktuara ku gjatë muajit të bekuar në *teraviih* namazin të lexohet i tërë Kur'ani, pra të kryhet një *hatme*. Familjet muslimane disa herë kanë shkuar bashkërisht në xhami për *teraviih* namazin, duke i marrë edhe fëmijët me vete. Natyrisht se gjatë kësaj krijohet një atmosferë familjare fetare, prej asaj sjelljes së njerëzve të pjekur e deri te loja e fëmijëve. Për çdoherë muaji i Ramazanit ka bërë që xhamitë tona të jenë të mbushura me xhemat.

Bedri

Bedri është betejë që ka ndodhur me 17 Ramazan, të vitit 2 sipas Hixhrit. Edhe pse kjo shënohet ose shkruhet nga historianë të ndryshëm, interpretues të shumtë të lëmenjve të ndryshëm, prapëseprapë duhet theksuar se beteja e Bedrit është betejë që nuk i takon retorikës së luftërave të zakonshme, sepse këtë e dëshmon vetë Kur'ani me thënien: *“Allahu ju ka ndihmuar në Bedër, kur ishit të pafuqishëm – prandaj frikësohuni Allahut që të jeni mirënjohës”* (3:123) dhe: *“... dhe kur gjuaje nuk gjuaje ti, por gjuante Allahu...”* (8:17). Këto thënie kur'anore mbi betejën e Bedrit janë të ngjashme me mrekullitë e mëparshme që janë paraqitur si dukuri që kanë dëshmuar fuqinë e Perëndisë dhe dërgueshmërinë e profetëve të ndryshëm, si Isait, Musait, Nuhut e shumë e shumë të tjerëve. Mirëpo këtu, në këtë betejë kemi diç të re brenda muxhizes, mrekullisë së përgjithshme, sepse thirret edhe “njeriu” që të jetë pjesëmarrës i muxhizes, i kësaj beteje mrekulluese para së cilës çdokush ka heshtur, ka ulur kokën dhe vetëm sexhde ka bërë në mënyrë simbolike që të vërehet vetëm një gjë, respektivisht besimi në Zotin. Bedri është nocion i

parë i cili paraqitet brenda domethënieve enciklopedike të kuptimit të fjalës betejë dhe atë vetëm duke treguar se këtu fare nuk ka patur të bëhet thjesht me një betejë, por me besimin në Zotin, nënshtrimin ndaj Tij. Është fakt se për t'u paraqitur një betejë siç është Bedri në këtë muaj të Kur'anit kanë qenë rrethana shumë të rrezikshme për besimtarët në krye me vetë të Dërguarin Muhammed Mustafa *alejhis-selam* dhe shokët e tij, të cilët filluan të luftohen me të madhe nga idhujtarët, të pabesët. Bedri u paraqit për shkak të çmendurisë së mushrikëve (idhujtarëve) dhe urrejtjes patologjike të tyre ndaj *teohidit*/Islamit, dhe padrejtësisë ndaj besimtarëve – muslimanëve, si p.sh. spastrimi i muslimanëve nga Mekka, izolimi i tyre nga jeta shoqërore dhe dallimet familjare, e sidomos dominimi i nënshtrimit të përgjithshëm të forcës së idhujtarisë. Për fat të keq idhujtarët, ateistët akoma janë prezent mbi faqen e dheut siç kanë qenë ata të kohës së Pejgamberit *alejhis-selam*. Përsëritja e Ramazanit e me këtë edhe vetë përsëritja në brendësinë e saj edhe e Bedrit, thërret që çdoherë ta kujtojmë shpëtimin e njeriut besimtar duke ia dhënë sigurinë dhe paqen botës me tërë bukuritë e saja, e vetëm që i ligu, ateisti dhe antiteisti vulgar të mos marrin hov e më në fund të prezantojnë fuqi djallëzore mbi tokë. Beteja e Bedrit tregon se për suksesin përfundimtar nuk janë të nevojshme vetëm përgatitja fizike, numri dhe mbështetja materiale, por se përveç kësaj, dhe atë si faktor i pandashëm, shkojnë edhe namazi, duâja dhe lutja Atij i cili dhuron ndihmë dhe fitore! Pejgamberi *alejhis-selam*, përkrah vendosmërisë së tij për t'u përleshur me armikun, në vendin Urejsh, një natë para Bedrit, u fal gjatë dhe luti Allahun Fisnik për sukses. Ai e dinte se fitorja vjen vetëm nga Allahu, e se Atij më së shumti mund t'i afrohet me

ubudijjet/robërim. Nuk është e kotë se për çdo vjet paraqitet Ramazani së bashku me Bedrin, njëri për ta pastruar shpirtërisht mbarë njerëzimin, e tjetri për t'u thënë të këqijve: nuk keni të drejtë të mbisundoni mbi njerëzinë.

Dobësia e besimit, mosdëgjimi i urdhrave të *nijetit*, Kur'anit, hadithit për çdoherë ia sjellin sprovat më të mëdha njerëzimit. Njëherë ndodhi që një pjesë e besimtarëve vetëm pse u vonuan në dëgjueshmëri ndaj urdhrat të Pejgamberit *alejhis-selam* në Uhud, të ballafaqohen me disfatë...

Lejletu-l-Kadr

Muaji Ramazan pandërprerë interpretohet dhe përsëri ka në vete resurse të pashtershme si të kuptimit, të përjetimit ashtu edhe të interpretimit. Ajo që e bën të mundshme një gjë të këtillë është edhe *Nata e Kadrit*. Allahu *xhel-le shanuhu* pyet (97): “E ti ç'mendon se ç'është nata e Kadrit?” dhe Vetë përgjigjet: “*Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.*” Përse është kështu? Vetëm për shkak se: “*Ne e shpallëm atë (Kur'anin) në Natën e Kadrit!*” Përpos kësaj, kemi momentin tjetër se vetë fjala thërret që të menjëherë diç rreth kuptimit të *kadrit*: në këtë natë përcaktohet ardhmëria e njeriut – fati i tij si për nga çka-ja ashtu edhe nga si-ja; njeriu në këtë natë hetohet, merret në llogari, në përgjegjësi, meqë në këtë Natë: “*...me lejen e Zotit të tyre, zbresin engjëjt dhe Xhibrili për të gjitha çështjet.*” Me siguri për këtë arsye kjo natë është quajtur *Lejletu-l-Kadr* apo *Nata e Fatit*, pastaj edhe *Nata e Paqes*, ndërsa në *suren ed-Duhan* ajo quhet edhe *Lejletu-l-Mubareke* – *Nata e Bekuar*.

Ngjarja më e rëndësishme e cila ka ndodhur që nga zanafilla e gjinisë njerëzore e deri më sot është bashkimi i botës më të lartë me atë më të ultën, bashkimi i Qiellit dhe

Tokës, respektivisht shpallja e Kur'anit dhe zbritja e udhëzimit për mbarë njerëzimin, për të qenë në rrugën e drejtë. Pikërisht kjo ka ndodhur në Natën e Kadrit, e cila është natë e zgjedhur dhe prandaj netët e tjera të shënuara, megjithëse secila me rëndësi të veçantë, as që mund të krahasohen dhe ta kenë vlerën që e ka kjo natë. Sipas Ibn Abbasit, mufessirit të parë të Kur'anit nga as'habët: "atë Natë Kur'anit ka zbritur i tërë nga *Levhi-Mahfudhi* në qiellin më të ulët – *es-Sema'ud-dunja*, prej nga Xhibrili *alejhis-selam* me urdhër të Allahut të lartësuar Kur'anin gradualisht ia shpallte Muhammedit *alejhis-selam* gjatë 23 viteve."

Pse kjo natë e vërtetë, të cilën Kur'anit e vulos, është lënë pa u përcaktuar në mënyrë të përpiktë se cila natë është gjatë Ramazanit? Në thëniet e mufessirit të parë të Kur'anit, vetë Muhammedit *alejhis-selam*, lexojmë: "Kërkoni Natën e Kadrit gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit" si dhe "Atij që Natën e Kadrit e kalon në *ibadet*, duke besuar dhe duke shpresuar shpërblim nga Allahu, Allahu do t'ia falë të gjitha mëkatet e mëparshme". Është mirë që në këtë natë pandërprerë ta përsërisim lutjen: "*Allahumme inneke afuvvun tuhibbul afoe fa'fu anni*", të lexohet Kur'anit me *hushu* (përrulje), *tedebbur* (thellim) dhe duke qarë – po, po, pse të mos lotojnë sytë duke lexuar Kur'anit? Besimtari e ka lehtë ta besojë këtë Natë, sepse beson në Allahun *xhel-le shanuhu*, i Cili duke mos ia harruar dobësitë e tij njerëzore e përgatit çdo send vetëm që atij t'ia ngjyrosë tërë jetën me lutje, duke ia falur mëkatet, duka ia pastruar shpirtin; ia dhuron këtë Natë në mënyrë të gjallë se me të vërtetë në këtë Natë, e cila në traditën tonë më së tepërmi, natyrisht duke ndjekur literaturën e hadithit, thuhet se bie në natën e 27-të të muajit të agjërit, vërehet zbritja/ngjitja, "shëtitja" e melekëve, zbritja e

tyre nga qielli duke thirrur: “*Selam (Paqe)! Ashtu është deri kur të agojë mëngjesi.*”

Itikafi

Sistemi i lutjes në Islam është ndër sistemet që për çdoherë përcjell plotësim të tërësishëm mes jetës së përbotshme dhe asaj shpirtërore. Këtë kemi mundësi ta vërejmë gjithandej kur është fjala për lutjen, duânë, devotshmërinë etj. Mes tyre kemi të ashtuquajturën praktikë të devotshmërisë, apo *itikaf*. Pejgamberi *alejhis-selam* ka qëndruar në xhami (në *itikaf*) dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. *Itikafi*, që është veçanërisht i parapëlqyer, nënkupton tërheqjen nëpër xhami, duke bërë *nijet*, për një numër të caktuar ditësh sipas dëshirës së besimtarit. Ai që hyn në *itikaf* nuk guxon të dalë gjatë atyre ditëve jashtë, pos për nevoja fizike dhe marrje të *abdesit*. Ai brenda xhamisë agjëron, kryen namaz, lexon Kur’anin, ha *iftarin* dhe *sehurin*. Në mesin e muslimanëve, edhe brenda trojeve tona, praktikohet që kjo periudhë e *itikafit* të jenë dhjetë ditët e fundit të muajit të agjërimit – Ramazanit, në të cilat bie edhe Nata e Kadrit. *Itikafi* është *sunneti muekkede*. Duhet thënë se burri doemos duhet bërë *itikafin* në xhami, ndërsa gruaja atë duhet ta bëjë në shtëpi, duke i ndjekur rregullat e lartshënuara.

Në këtë kohë të vështirë kur njeriu harrohet, harxhohet, vritet, shkelet, fundoset në pafundësi, ballafaqohet me trishtimin, frikën, rrezikun, i nënçmohet besimi, i shpallet luftë, arrestohet, para botës i bëhet padrejtësi, thirret në amoralitet në emër të moralit, gjë që e pamë në Kosovë, në Shqipëri, Bosnje, Çeçeni, në Lindje e në Perëndim, brenda mirësive të botës njeriu dita-ditës është duke u

bërë i panjohur. Me siguri se Zoti të gjitha këtyre u ka garantuar zgjidhje, udhëzim, natyrisht se me fe dhe besim – agjërimit, e pse pra jo edhe me *itikaf*. *Itikafi* në këtë kohë është ndër virtytet më të larta të njeriut ku drejtpërsëdrejti ai e detyron vetveten që të bëhet ndihmëtar i së mirës – fesë, u ndihmon engjëjve/melekëve për ta mbyllur shejtanin; bëhet forcë që edhe po atë shejtan të mallkuar ta ketë nën sundimin e vet, t'i hapë horizontet nga qielli, e sheh atë që s'ka mundësi çdokush ta shohë, i nënshtrohet Allahut *xhel-le shanuhu*, duke i bërë lutje për shpëtimin e njeriut/njerëzimit, familjes, fëmijëve. Në këtë izolim nga e gjithë kjo në vendin e quajtur *xhami*, ku përpos lutjes, *sexhdes*, përgatitjes së mbrojtësve të së mirës dhe humanitetit nuk ka asgjë tjetër, njeriut të kohës sonë në errësirë, në vetmi kur nuk ekziston asgjë pos sinqeritetit i mundësohet ajo që ka thënë Zoti: “*Dhe kur të të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet. Prandaj le të kërkojnë përgjigje prej Meje dhe le të më besojnë Mua, për të qenë të udhëzuar.*” (2:186) Këta njerëz duhet të respektohen dhe të duhen nga ne se me të vërtetë kemi nevojë për lutje dhe njerëz të këtillë.

Sadekatu-l-fitri (apo vitret)

Shikoni se ç'bën Islami: tërë këtë metafizikë madhështore, pas të gjithave: *nijetit, agjërimit, lutjes, Bedrit, Lejletu-l-Kadrit, itikafit* kërkon diç siç është *sadekatu-l-fitri*. Një dërhem, ose pjesës materiale të kësaj bote ia jep shenjtërinë dhe e bën detyrim për çdo musliman dhe muslimane. Ushqyesi, apo përkujdesësi i familjes jep *vitret* për të gjithë anëtarët e familjes, e nëse ndonjëri nga anëtarët jep *vitre* për vetveten, atëherë ajo është edhe më mirë. *Vitret*

duhet dhënë para namazit të Bajramit. Lejohet që ato të jepen një apo dy ditë para Bajramit, ndërsa në rast nevojë edhe më herët. *Vitret* jepen në lartësi apo sasi të ushqimit njëditor për një person. Në këtë drejtim, është mirë që të shihet që personit të cilit i jepen *vitret* t'i jepet ajo që atij do t'i ishte më e dobishme. Nga *sadekatu-l-fitri* te ne është duke u bërë një institucion që krijon mundësi për mirëmbajtjen e institucioneve shkollore arsimore, siç janë medresetë dhe fakultetet, ku duhet të shkollohen njerëz me besim, virtyte të larta morale dhe që bëhen "pasardhës të profetëve", që do të dinë të mbajnë shtet dhe popull, me kulturë të lartë fetare e morale, e sidomos atyre që do të dinë ta lartësojnë fjalën e Allahut mbi faqen e dheut.

Bajrami

Siç e kishim haram të ushqehemi gjatë agjërimit në muajin Ramazan, me ardhjen e Bajramit e kemi haram agjërimin. Feja islame e cila i drejtohet mbarë njerëzimit dhe e thërret atë në bashkim njeh dy festa: njëra është *'Idu-l-Fitr*, apo *Fitr Bajrami* dhe tjetra *'Idu-l-Ed'ha*, *Kurban Bajrami*. Nuk kemi mundësi e as të drejtë që festat fetare t'i zbresim në hapësirën e përbotshme të atyre festave që kanë karakter shtetëror apo kombëtar, meqë vetë Pejgamberi *alejhis-selam* kështu e ka caktuar, dhe në të njëjtën kohë simbolet e fesë, përcaktimet e fesë për çdoherë janë mbi karakteret shekullare. Nuk do të thotë se meqë jetojmë mbi rruzullin tokësor ku ka shumë shtete, kombe etj., të mendojmë se nuk duhet patur momente që karakterizojnë dhe lartësojnë vendin tonë në tërë atë rruzull tokësor.

Festa fetare me njeriun sillen mu si prindi me fëmijën; ajo na gëzon dhe thërret që t'i gëzojmë edhe të tjerët duke

u vizituar familjet, farefisi, fqinjët e miqtë, duke forcuar dashurinë ndaj njëri-tjetrit, me qëllim që të kenë *thevabe* – shpërblime.

Po Zot, Ty të besojmë dhe për Ty agjërojmë!

Agjërimi, nëse kuptohet vetëm si abstenim nga haja e pija, është mjerim, sepse atë e bën vetëm kafsha. Njeriut në këtë kohë i mundësohet që drejtpërsëdrejti të komunikojë me Zotin, drejtpërsëdrejti t'i lexojë fjalët, respektivisht shenjat e Zotit; i mundësohet që të ketë një iftar me mbi një miliard njerëz në kohë të caktuar; i mundësohet që në atë kohë t'i lutet Zotit për çdo send mirë e mirë të analizuar e të vendosur e Zoti t'ia pranojë ato. Shumëkuptimësia e agjërimin natyrisht se ka qenë shpëtim edhe për nënën e pastër, Merjemen, e cila e lindi Isain *alejhis-selam*, dhe prej mundimeve dhe shpifjeve të shumta, u detyrua që të abstenojë nga fjala dhe të thotë: *“Unë të Gjithmëshirshmit i jam zotuar që të agjëroj (të hesht)...”*. Me agjërimin si solidaritet botëror në formë të urisë njëkohësisht i paraqitet luftë edhe djallëzisë botërore. Është fakt se agjërimin e prishin disa momente nga bota materiale, por përpos kësaj feja rëndësi të veçantë i kushton edhe pastrimit të shpirtit, devotshmërisë ndaj Zotit, meqë pa këtë agjërimi e humbet formën e shpërblimit dhe merr formën e dënimit.

Me të vërtetë rregullat fetare thërrasin zemrën dhe arsyen njerëzore duke mos e komplikuar dhe vështirësuar normën fetare; ato thërrasin që muslimani të dijë të besojë, të jetë i mençur, i lirë e të vendosë të agjërojë, të bëjë punë të mbarë, duke mos iu frikësuar harresës e lodhjes.

Në fund po i përmendim thëniet vijuese të Muhammedit *alejhis-selam* lidhur me muajin e bekuar të agjërimin:

“Agjërimi është mbrojtës dhe (agjëruesi) le të mos kryejë vepra të turpshme e të këqija, nëse dikush e sul-

mon apo e fyen, le t'i thotë dy herë: 'Unë agjëroj'. Pasha Atë që shpirti im është në duart e Tij, era e gojës së agjëru-esisit është më e këndshme te Allahu sesa era e parfumit. (Agjëruesi) e len ushqimin, pijen dhe kënaqësitë (thotë Allahu) për Mua. Agjërimi është Imi dhe Unë për të shpërblej dhe për secilën vepër të mirë do ta ketë shpërblimin e dhjetëfishuar."

"Kur hyn muaji i Ramazanit hapen dyert e qiejve dhe mbyl-llen dyert e xhennemit, ndërsa shejtanët lidhen me zinxhirë."

Literatura e konsultuar:

Kur'ani Kerimi; Sahihu-l-Buhariu në gjuhën shqipe, v. 5, Prishtinë 1994; Nerkez Smailagiç, *Leksikon Islama*, Sarajevë 1990; L. Shentürk, Sejfettin Jazixhi, *Islam Ilmihali*, Ankara, 1996; *Islam Ansiklopedisi*, TDV, Istanbul (v. agjërimi).

P.S.

Pranimi i agjërimit duhet të mbështetet mbi burimin e tij, të jetë larg "modernizimit" të tij, respektivisht praktikimit të tij në format që në dukje janë të mira, por që në esencë e burgosin shpirtin dhe ia zënë frymën kulturës.


Kohëve të fundit kanë filluar të organizohen iftare të përbashkëta nga shoqata e individë, me para të grumbulluara nga muslimanët dhe kjo, për fat të keq, është duke u bërë traditë "e domosdoshme", duke harruar se iftaret e këtilla janë duke ia zënë frymën *vahjit, sunnetit* të Pejgamberit a.s. dhe lotit të zemrës. Koha e iftarit është kohë kur agjëruesi ballafaqohet me aromën e xhennetit; iftaret janë ato që i bashkojnë familjet dhe që mundësojnë përqaftimin prind-fëmijë, siç është një përshkrim kur'anor.


Muaji i agjërimit është muaji kur ka zbritur/zbret Kur'ani, që neve na mundëson ta mësojmë, ta lexojmë e ta dëgjojmë atë dhe të heshtim, e jo *vazet* që i kapërcejnë përmasat e besimit dhe kulturës, sepse ligjëratat, për

momentin, qysh para se të fillojnë janë të vdekura ose shprehin një tautologji të bezdisshme; ato janë duke na ngarkuar me “përgjegjësi” e “dënim”. E të mos flas për kulturën e të folurit dhe shprehjeve që vetëm janë duke e varfëruar Fjalën e Shpalljes. Vazet kanë arritur në atë derexhe, saqë çdokush që flet “bukur” konsiderohet teolog, pa marrë parasysh thellësinë e urtësisë së teologjisë që e ligjëron ai. Dëshmi për këtë është se ne jemi të robëruar nga një injorancë “e shenjtëruar”.

Muaji i agjërimit, përpos ripërtëritjes së besimit, është një mundësi e veçantë, që para nesh parashtron disa pyetje, si: si jeni duke i kuptuar fjalët “përgjegjësi”, “gënjeshër”, “mashtrim”?; si jeni duke i kuptuar fjalët “arsimim”, “edukatë” e “kulturë”?... Me një fjalë, agjërimi është një moment që na pyet: si jeni duke e zbukuruar jetën, kulturën tonë, duke u mbështetur mbi lirinë që na e ka dhënë Zoti, si në pranimin ashtu edhe në refuzimin e fesë? Ai na flet shtruar: je besimtar – mos u bëj arrogant; je mosbesimtar – mos u bëj edepsëz!

Muaji i Ramazanit kërkon dhe mundëson që hapësirën e Kur'anit ta përjetojmë në gjallërinë e tij; ai kërkon nga ne përpjekje, shpirt dhe vdekje, sikur je duke e lexuar Fjalën e Tij para Tij.





اعوذ بالله من الشيطان الرجيم
 بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ



URDHNAT VEPRUESE.

Detyrimi i domosdoshem i agjinimit.

Agjinimi është i detyrshëm për gjithë myslimantë që janë bërë të zotët e vedit e të mendës të cilët do t'ia bënë një me qellim robrije të mos hangër, mos pë, dhe të u rrujtë nga sendet që prishin agjinimin, ç' prej agimit e deri në prenim të diellit.

Agjinimi është porsë nemazi një robni trupore; sikundër e kanë pasë detyrë të domosdoshme popujt e kaluem; një vit e gjymës mbas hixhretit ashtu u është bërë detyrë e domosdoshme me ajet edhe myslimanve.

Ai që mohon agjinimin e Ramazanit numrohet kaurr (qafir), e ai që nuk e mban pa nevojë bahet mëkatnuer (gjynahqar).

Agjinimi është prej robnive të mdhaja.

Zoti i vertetë urdhnon e thotë: — Çdo vepër e njerzve është e tyne, vetëm agjinimi i tyne është i emi. Shperblimin e agjimit e ap vetë.

Qellimi i agjinimit.

Njeriu ka një cillsí njerzore e një cillsi shtasore. E para është për të njohur vedin edhe Krijuesin e ti, me krye urdhnat e Perendis edhe m' u ruejtë nga urdhun-ndalimet e Tija. E dyta është me hangër, me pì edhe me i u shtrua ephshit vehtuer.

Plotsimi i cillsís njerzore perfitohet tue kundreshtuem cillsin shtasore. Tue pasë barkun plot e fuqin në vend, i shtrohet ephshit edhe priret lehtësisht nga mëkati.

Për të pasë në dorë ephshin, agjinimi është mjetei mà i bukur; agjinimi e rëxou fuqin trupore, e në këtë mëndyrë e shpeton zemren nga vullndeti i lig.

Tue genë unshëm me pritë yftarin me tryzë të haenave perpara është një durim i madh! Këtë virtyt perveç agjinimit nuk ka ndo 'i send qi të bëjnë me vuejtjet e uris, t'edës e të tjerave, me kuptue vleftjen e të qenunit te shndetit e të qefit, e bëjnë njerin t' i falet nderit Krijuesit, edhe të siellet i mëshrirshëm kundrejtë të vorfënve.

Fillimi i agjinimit është imsaqi (agim) e të

prishunit e agjinimit quhet yftâr ; haeja qi të ngranet në mengjes quhet syfyr (suhur).

Shkallët e agjinimit.

Agjinimi âsht mji robni e naltë qi njerin e afron ke i Madhi Pnrendi. Agjinimi ka grada ose shkallë të ndryshme.

I.- M' u ruejtë, si mbas Sherjatit, nga sendet qi prishin agjinimin, âsht farz për mysliman.

II.- Asht shkalla e të mirëve d. m. th. atyne qi u a ka ndreqë gjendjen e vëprimit. Për me arrijtë në ket shkallë perveç agjinimit, do të ruhen sÿt nga harami, gjuha nga të ligat, do të këndohet Kurân edhe do të per-mendet emni i Zotit shpesh e shpesh ; mâ të shumten me heshtë, me udigjuem Kurân e fjalë të mira ; duert, kambët e gjymtyrët tjerë me i ruejtë nga të këqijat e me i bâ vegla në punë të mira. N' yftâr e në syfyr nuk ban me hangër tepër.

III.- Asht grada e atyne qi i a mrrijnë afrimit ke Perendija. Ata qi arrijnë në ket shkallë, perveç se u binden kushteve qi thame ma nalt e mbassi të zotpojnë mbi epshin e tyne plotsisht, ata në çdo send nuk shohin tjetër vetëm madhnin e fuqin hyjnore. Qe atëherë në zemren e pastër, sikver nji pasqyrë deperton drita hyjnore.

Dobinat shndetsore t' agjinimit

E dini se dora e kamba e jonë tue punuem gjithnji lodhen. Për mos m' u prishë rregullimi i veprimevet t' ona, ndo 'i herë lypset të pushojmë. Kjo është një rregull shndetsore qi ka të bājë edhe me lukthin (stomak, mide). Pra ushqimet qi tresim për ditë e lodhin lukthin, prandej për të vepruem lukthi rregullisht ka nevojë qi një herë në vit të pushojë ditën. Vertetë qi tue e mbajtë lukthin unshëm perkohsisht, trupi liget, por në vend të damit bâhet perisë (pehrisë). Sa të jët e mundur n' yftâr e në syfyr duhet me ngranë gjâ t' ushqyeshme e të lehta për me i a mrrijtë qellimit.



Agjinimi i Ramazanit.

*KUSHTET E TË BAMUNIT
FARZ T' AGJINIMIT TË RAMAZANIT.*

Muslimant qi janë bâ te zotët e vedit e të mendes e kanë farz me agjinue ; vetëm në rasë se trupit të tyne i vjen ndonji dam ose smundje ata qi janë udhtâr edhe grât të cilat janë në gjaqe të përmuejshme e llahuza (hajz e nifás) kanë lêje sherie me e prishë agjinimin. Për të qenë i drejtë agjinimi lypset me e bâ nijet me zemer e me gjuhë në ket mënyrë : „E bâna nijet për agjinimin e nesermen“.

Agjinimi do të bâhet nijet me kohë. (1)
Nijeti mbas kole âsht i pa vend.

Ata qi nuk janë të zotët e vedit e të mendes nuk e kanë farz me agjinue; por n' e bashin nijet edhe agjinojnë kanë sevabë.

Të dishmuent e hanes.

Ju e dini se muejt nuk janë gjithmonë tridhet ditsh; sidomos muejt arabisht (hana) don me thanë tue pà hanen e ré dishmohet fillimi i mojit. Prandej âsht nevoja m' u dijtë fillimi i çdo mojit të hanës.

Kështu qi ditën njizet e ndandë të Shabanit, në rasë qi të shihet hana e Ramazanit me kohë, tue dishmue me dy dishmitarë para kadis, në qoftë moti i vrânët tue dishmue një grue ose një bûrr mysliman i drejtë (qi të két të mira mâ shum se të liga) bâhet farz agjinimi. Për muejt tjerë nuk mjafton dishmija e lajmi i një njeriut. N' âsht se Shabani bâhet tridhet ditsh, n' e nesre do t' agjinohet pa dyshim Ramazani. Pejgamberi i ynë ka agjinue nandë Ramazana: katër nga njizet e nandë, e pesë nga tridhet ditësh. Ilami Sherija qi epet prej gjyqtarit në një qytet për Ramazan e Shevâl duhesh të jët i pranueshëm edhe ndër qytete tjera për të mbajtë Ramazanim e për të bâ Bajramin.

(1) *Koha e nijetit për agjinim të Ramazanit fillon me Prendimin e diellit e deri para mjesdites, por mâ mirë âsht në kohen e imsaqit.*

Dita e dyshimt (jeumi sheq).

Ramazani i madhnueshëm, edhe ne mos u vertetoftë tue pàm hanen, ditës tridhet Shaban i thonë dita e dyshimtë. Shkaku është se nuk mund të dihet mirë qi ajo është e mbrama e Shabanit apo fillesa e Ramazanit.

Diten e dyshimtë me agjinue tue bâ nijet për Ramazan është meqruh.

Ashtu edhe n' u pafte hana në të tridheten natë të Ramazanit, agjinohen nijzet e nandë dit; ose plotsohen tridhet dit, n' e nesre bâhet Bajram.

Shkurtim

Agjinimi është një robni e pranueshme ke i Madhi Zot. Një vit e gjymës mbas hixhretit është bâ farz. Agjinimi është një mirërritje fetare qi njcrin e ndalon nga epshi; i mëson të qenunin e vleftjen e shndetit. Agjinimi na detyron me i u falë nderës Perendis për të mirat qi Ai na ka dhanë. Na ban të mshrirshëm kundrejtë të vorfenve.

Agjinimi ka tri gradë... E para është m' u ruejtë nga sendet qi e prishin si mbas Sherjatit. Ky është farz për gjith të ngarkuemt (muqelef). E dyta është perveç se m'e ruejtë doren, kamben, synin, gjuhen e gjith gjymtyrët nga harami, me zemër me permendë Zotin, me hangër pak në yftâr ashtu në syfyr. Kjo është shkalla e të mirve.

E treta është një gradë më e ultë se të parat. Ata që arrijnë në këtë gradë hjekin dorë prej shekullit edhe hyjnë në grupin e myslimanvet që janë t'afërmë tu Perëndija.

Agjnimimi është i dobishëm edhe për shndet. Ai është një lloj periziti që i jep fuqi lukthit, zorrvet e trupit. Hej! shumë smundje.

Ata që nuk kanë fuqi me mbajtë agjnimin udhtarët e gratë e nevojitura (zyrri), me kusht që m'ë bënë kazë mund prishin.

Pleqt me kusht që të paguejnë shperblimin (fidje) janë të falun nga agjnimimi. Për agjnim është nevoja me e bënë nijet. Mbassi të kalojë koha nuk bëhet nijet e pa këtë s'agjinohet. Ata që nuk janë të zotët e vedit e të mendes, po që se agjinojnë tue bënë nijet fitojnë sevabë.

Njizet e nandta ditë e Shabanit, në qoftë se shihet hana e ré mbas prendimit të diellit, edhe dishmohet nga dy a më shumë vetë, ver-tetohet moji i Ramazanit. Kuerse është moti i vrânët mjafton me dishmin e një myslimanit të drejtë.

Në rasë që hana nuk mund të shifet por Shabani mbushë tridhet ditë n'ë nesre është dita e Ramazanit.

E tridhetta ditë e Shabanit quhet dita e dyshimtë. Në këtë ditë me nijet Ramazanit, nuk agjinohet. Edhe Bajrami është me të pame të hanës, në qoftë se nuk është e mundun me e pënë do t'agjinohen tridhet ditë plot.

DETYRË

Shka është agjinimi? Sa është koha e një ditës? Kur është bû farz? Shka ka urdhnue Zoti për agjinim? Dëftenje qellimin e nemazit? Kujt i thonë yftâr e syfyr? Sa gradë ka agjinimi? Dëftoni këta tri gradë. Çfarë dobije ka për shndet agjinimi? Cilat janë kushtet e agjinimit? Për të cilët është lêja sherí me lanë agjinimin? Kush është i falun kuerse paguen shperblim? Qysh bëhet nijet agjinimi? A agjinohet pa nijet? Qyshë dishmohet hana e Ramazanit? Sa Ramazana ka mbajtë Pejgamberi i ynë? Kujt i thonë dita e dyshimtë? A ban me mbajtë Ramazan ditën e dyshimtë?



Pse i prezantova si “*copy-paste*” këto faqe të mësipërme ku në mënyrë të përmbledhur jepen udhëzime mbi rregullat e agjërimit? Për arsye të një nostalgjie ndaj përgjegjësisë fetare kur edhe në kohën më të lodhshme muslimanët shqiptarë janë munduar ta ruajnë amanetin e Zotit dhe kanë krijuar organe fetare si Këshilli i Lartë i Sheriatit, që do të merrej me çështjen e gjykimeve juridike për çështjet e sheriatit, edhe pse ne ka kohë që nuk e kemi një të tillë.

Këshilli i Lartë i Sheriatit (KLSH) është formuar nga Kongresi Mysliman Shqiptar i shkurtit-marsit 1923. Ky ka qenë kongresi i parë i myslimanëve, pas tij kanë vijuar edhe dy kongrese të rëndësishme, ai i 1925 dhe i 1929. Këtë Këshill e kanë udhëhequr emra eminentë të historisë fetare dhe shtetërore, si: Hafiz Ali Korça, Vehbi Dibra e të tjerë. Për këto ka shkruar Ali Basha: *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011.



RAMAZANI – LEXIMI LUTËS I KUR’ANIT

“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua.”

(El-Bekare, 186)

“Vërtet është e gjallë Fjala e Zotit dhe efikase. Është më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe. Depërton deri aty sa e ndan shpirtin dhe frymën”

Fjalë e urtë

Ditë pas dite dhe javë pas jave e përrjetojmë në lutje leximin e Fjalës së Zotit si në vetmi ashtu edhe brenda bashkësisë – xhematit të tubuar të besimtarëve. Predikimi e interpreton dhe aktualizon Fjalën e Zotit të lexuar ashtu që dëgjuesit ta pranojnë më thellë dhe më qëndrueshëm. Në kumtimin e Fjalës së Zotit nga Libri, vetë Zoti u flet njerëzve apo popujve. Nga ana e tyre, besimtarët e falënderojnë Krijuesin, i cili u flet me fjalët e Librit: *“Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit! Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit! Sunduesit të Ditës së Gjykimit! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë! Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”* (El-Fatiha, 1-7)

Askujt nga ne mbase nuk i është e panjohur përvoja me Fjalën e Zotit: *“Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së*

tyre (duke u thënë): *'A nuk jam Zoti juaj?'* Ata thanë: *'Po, dëshmuam!'*. Të mos thoni në ditën e Kiametit: *'Ne për këtë (dëshmim) ishim të pandërgjegjshëm''* (El-A'raf, 172). Kjo është përvojë të cilën në mënyrë aq thelbësore dhe të fuqishme e përshkruan: *"Është e gjallë, vërtetë, Fjala e Zotit dhe efikase. Është më e mprehtë nga çdo shpatë me dy tehe. Depërton deri aty sa e ndan shpirtin dhe frymën..."* (Fjalë e urtë). Përvoja e tillë e Fjalës së Zotit rrjedh nga marrja me të vazhdimisht dhe duke u përsëritur ndër gjenerata nëpër të gjitha situatat jetësore, në të cilat është gjendur besimtari, dhe në të cilat është dashur ta vërtetonte dhe ta dëshmonte besimin e tij edenian. Ndoshta kemi patur fatin që edhe ne të përjetonim diçka të ngjashme në kumtimin dhe interpretimin e fjalëve të Librit – *Kitabit*. Nëse fjala e Librit na ka prekur aq fuqishëm, atëherë me siguri do të dëshironim që edhe vetë ta lexojmë Librin. Kjo mund të bëhet në vetmi, në qetësi dhe në fshehtësinë e dhomës sonë: *"Kur të kryeni namazin, përmendeni Allahun, kur jeni në këmbë, ulur, të mbështetur. E kur të qetësoheni, atëherë faleni namazin në mënyrë të rregullt, pse namazi është obligim i caktuar për besimtarët"*. (En-Nisa, 103); në prani të disa besimtarëve, vëllezërve dhe motrave që synojnë të kuptuarit më të thellë të fjalës së Zotit, ndaj dhe dëshirojnë që me të të frymëzohen për jetë dhe veprim, ose duke u lutur kërkojnë dritë dhe ndihmë: *"(Përkujto) Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtarët që drita e tyre flakëron para tyre dhe në të djathtë të tyre. (U thuhet) Myzhde e juaj sot janë xhennetet nën të cilat rrjedhin lumenj, aty do të jeni përgjithmonë. E ajo është fitore e madhe"* (El-Hadid, 12); *"... Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: 'Zoti ynë, vazhdoni dritën tonë, falna neve. Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send'"* (Et-Tahrim, 8)

A nuk mundemi që asisoj, në privatësi ta kuptojmë fjalën e Zotit për atë se çfarë thotë ajo dhe çfarë dëshiron të prodhojë në jetën tonë? Gjithsesi, sepse ai që e lexon Librin me qëndrim të drejtë të zemrës, nuk e lexon atë kurrë vetëm. Këtu është para së gjithash Ummeti, apo bashkësia e atyre që jetojnë nga ajo fjalë dhe që e interpreton me kompetencë. Atë e udhëheq Shpirti i Shenjtë – *Ruhul Kudus*: “*Thuaj: ‘Atë (Kur’anin) e sollti ‘Ruhul Kudus’ – shpirti i shenjtë – plot vërtetësi nga Zoti yt, për t’i përforcuar edhe më ata që besuan, dhe për të qenë udhërrëfyes e myzhide për muslimanët’*” (En-Nahl, 102), në të kuptuarit më të thellë të tërë Librit. Në leximin tonë privat ne thuajse e përsërisim atë që të dërguarit e kumtojnë dhe interpretojnë që nga fillimi dhe nga e cila ai jeton përhershëm (En-Nisa, 163). Nuk guxojmë të harrojmë edhe atë se besimtari në *mihrab* në kërkimin dhe leximin e tij personal të porosisë së Librit nuk është pa Frymën e Zotit: “*Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kur’anin)*” (Shûra, 52). Kjo vlen sidomos atëherë kur fjalën e Zotit e lexojmë në përuljen gjatë lutjes dhe në përkushtimin e zemrës ndaj Zotit hulumtojmë se ç’dëshiron të na thotë fjala e Tij përkitazi me shpëtimin tonë, për jetën tonë të përbashkët dhe personale, në çastin e dhënë historik të jetës personale apo të jetës së bashkësisë. Për këtë, si udhëzim për hyrje në leximin, lexuesit mund t’i ndihmojnë p.sh. këto pyetje: Çka na nxit fjala e Zotit dhe ç’duhet bërë ne si përgjigje ndaj saj, përgjigje që ngrihet në mes të jetës sonë dhe sipas së cilës e fitojmë dhe e vërtetojmë përvojën e shpëtimit tonë?

Krahas këtyre pyetjeve mund të ndërliidhen edhe disa të tjera, më tepër të natyrës parimore, për të cilat do të dëshironim të thoshim diçka më tepër këtu. Si, në të vërtetë, ta lexojmë Librin në mënyrë lutëse? Si të na bëhet *duâ* per-

sonale leximi i Librit, i një pjese të tij, qoftë në vetmi, qoftë bashkë edhe me disa lexues të tjerë të përkushtuar? Duhet përmendur që për frymën e Librit do t'i ishte më e përshatshme që ai të lexohej, dëgjohej, shqyrtohej në bisedë dhe shkëmbim përvojash me fjalën e Zotit në një bashkësi më të vogël besimtarësh, duke supozuar, natyrisht, pjesëmarrjen në interpretimin e fjalës së Zotit. Në të vërtetë, është me rëndësi të kihet ndër mend premtimi i Zotit në fjalët e të Dërguarit: *“Aty ku janë bashkë dy ose tre veta në emër Timin, aty jam edhe Unë ndër ta”*. Ai po ashtu premtonte plotësimin e lutjeve të atyre që I luten, sidomos nëse në të do të shprehej dëshira për kënaqësinë e Tij: *Dhe thonë: “I lartësuar është Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është realizuar”. Dhe duke qarë bien përdhe me fytyrat e tyre (kur dëgjojnë Kur’anin) dhe kjo ua shton edhe më shumë përluljen (ndaj Allahut)”* (El-Isra, 108-09).

Këto vërejtje për sjelljen tonë lutëse personale ndaj Shkrimit të Shenjtë mund të shërbejnë për shqyrtimin dhe lutjen personale si dhe për përgatitjen personale për dëgjimin dhe leximin e përbashkët të *kitabullah*. Gjatë kësaj do të udhëhiqeshim dhe këshilloheshim nga përvoja shumëshekullore e pejgamberëve, d.m.th., me atë mënyrë të sjelljes lutëse me fjalën e Librit, që është e njohur me emrin lexim hyjnor, që ne në mënyrë të lirë e përkthejmë me sintagmën “leximi lutës i Fjalës së Zotit”. Koha e muajit të Ramazanit mundëson një përvojë të tillë.

1) Ç’është ky “lexim lutës”?

Leximin lutës të Shkrimit të Shenjtë mund ta përkthejmë si vijon: ushtrim i rregulluar, i ekuilibruar i dëgjimit personal të fjalës së Zotit, siç është *namazi*. Në vijim do të duhej t'i interpretonim pjesët përbërëse të këtij përshkrimi.

USHTRIM: Bëhet fjalë për angazhim aktiv me tekstin e Shkrimit: këtë e theksoj ngaqë në jetën tonë fetare ka shumë çaste dhe gjëra pasive, që i bëjmë kryesisht të shtyrë nga të tjerët, apo nga shprehia. Ndërsa, leximi lutës i Shkrimit është koha kur njeriu vetëdijshëm futet në të dhe e fut edhe veten aty, duke iu ekspozuar pa ngurrim veprimtari të fjalës së Zotit që i flet nga teksti; është kjo po ashtu kohë kur njeriu i vendos dhe i trason seksionet rrugore të ardhshme të ecjes së tij jetësore. Është ky angazhim i vetëdijshëm personal me Fjalën e Zotit. Kjo veprimtari gradualisht bëhet lutje personale dhe shndërrohet në njëfarë pasiviteti: ndodh takimi me Zotin, që na prek dhe sfidon: *“Thuaj: “Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve”* (El-En’ am, 162).

I RREGULLUAR: Leximi lutës i Shkrimit ka strukturën dhe dinamikën e tij të brendshme shumë të thjeshtë, që ne, fatkeqësisht, e harrojmë shpesh ndaj dhe Shkrimi na duket disi i thatë, i harxhuar, bezdisës dhe i pakuptueshëm.

DËGJIMI: Ndonëse përmendim “leximin e shenjtë”, ai është në të vërtetë dëgjim i Fjalës së Zotit, respektivisht pranimi i saj si dhuratë. Karakteristikat e dëgjimit të tillë janë ato të pejgamberëve, i Zekirijait, Isait a.s. (Merjem, 3, 18, 21, 30). Me këtë në mënyrë organike ndërliidhet ai qëndrim që përshkruhet si ruajtje dhe mbledhje e ngjarjeve nga jeta e Isait a.s., në zemrën e nënës, respektivisht si ruajtje e atyre kujtimeve. Pra, bëhet fjalë për dëgjimin dhe ruajtjen e fjalës, që bëhet në gjendje të përkushtimit, bindjes dhe mahnitjes – ngase ne nuk jemi zotërues të Fjalës së Zotit, por vetëm shërbëtorë të saj! Nga kjo rrjedh që gjatë leximit lutës të Libri nuk do të kërkojmë diçka që do t’ua rrëfenim të tjerëve, apo që do të na e kënaqte kureshtjen. Duhet që në qetësi dhe paqe t’i lejojmë Zotit të na flasë

dhe ne të zbulojmë se ç'është për Të me rëndësi në lidhje me ne.

Dëgjimi PERSONAL: Nuk bëhet fjalë për dëgjim të predikimit apo ligjëratës së lexuar në xhami. Është ky çasti i dëgjimit personal, i cili detyrimisht e plotëson dëgjimin në bashkësi (xhemat) të fjalës së Zotit në *ibadet* ose në forma të ndryshme të devotshmërisë. Pa dëgjimin e përbashkët të Fjalës së Zotit, "leximi i shenjtë" shndërrohet në individualizëm, derisa pa leximin lutës personal të Shkrimit, dëgjimi i tij në bashkësi zhytet lehtë në frazat e përgjithshme, respektivisht na lë indiferentë dhe nuk depërton në jetën tonë.

FJALA: Kitabi – Shkrimi u është dhënë njerëzve nga Zoti, ai është i frymëzuar nga Shpirti i Zotit, "i dobishëm për mësim, bindje, përmirësim, edukim në drejtësi, që njeriu i Zotit të jetë i virtytshëm, i aftë për çdo vepër të mirë." Në qendrën e saj ai dëshmon për Pejgamberin a.s.; për pritjen e paraqitjes së tij; për jetën, fjalët dhe veprat e tij; për jehonën e jetës së tij dhe veprimin përgjatë historisë... Kjo do të thotë se në të mua më flet ajo Fjalë që më ka krijuar, që e mbart fshehtësinë e jetës sime, ku gjendet çelësi për të kuptuarit e përvojave dhe situatave të mia të kaluara dhe të tashme, ku qëndron kuptimi i jetës sime (El-Hixhr, 29); është ajo Fjala që e ka fshehtësinë e ecjes përpara të besimtarëve dhe në të cilën është drita për të kuptuarit e duhur të gjendjes së sotme të historisë sonë njerëzore. Në të kuptuarit e tillë të fjalës së Shkrimit më flet Shpirti i Zotit, i cili e përshkon mbarë realitetin, dhe i cili është më real nga e gjithë ajo që më rrethon. Ai i depërton të gjitha nivelet e jetës personale dhe të përbashkët të neve njerëzve: atë ekonomike, shoqërore, politike, kulturore, fetare... Pra, flitet gjithmonë për dëgjimin e

Fjalës sipas së cilës bota është krijuar, e cila e mban, e udhëheq, e drejton...

2) Struktura e leximit lutës të *Kitabit*

“Leximi i Shenjtë”: *“Ikre bismi Rabbikel-ledhi halek”* (Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi) (El-Alek, 1) ka histori të gjatë mijërvjeçare, ngase është bërë që në shkrimet e para të shpallura. Atë, në mënyrën e tyre, e kanë bërë profetët në raport me traditat më të hershme – *Ehli Kitab*. Me të është në lidhje të ngushtë edhe leximi i tyre i famshëm i Ligjit dhe profetëve përmendësh. Struktura e saj ka gjetur kodifikimin e parë të njohur për ne (Merjem, 16), ndërsa është përkryer tek hafizët dhe Shkruerit e parë të shkronjave të Kur’anit, ne praninë e Muhammed Mustafasë a.s..

a) Merr dhe lexo!

Leximi lutës duhet të jetë sa më i rregullt, për çdo ditë, ose si të vendosim, sipas mundësive kohore, si p.sh., në kohët e namazeve. Gjithashtu, duhet që paraprakisht ta përcaktojmë se sa kohë do t’i kushtojmë kësaj; e gjithë kjo le të jetë brenda tridhjetë minutash, ose më tepër; kësaj kohe duhet t’i përmbahemi dhe ajo nuk duhet shkurtuar. Nëse dëshirojmë që thellësisht ta përjetojmë shenjën e Fjalës së Zotit, duhet që atë ta lexojmë para iftarit. Ndimmesë e madhe është nëse leximi bëhet gjithmonë në vendin e njëjtë; ambienti i rregulluar në mënyrë të përshtatshme mund të jetë shumë i dobishëm për leximin, por ky nuk është kusht pa të cilin nuk mundemi.

Pasi të ujdise mi në vendin tonë dhe duke qenë të ndërgjegjshëm që libri të cilin e kemi në dorë, para nesh, nuk është çfarëdolloj libri, por porosia e Zotit e regjistruar për

njeriun, për ne, ndaj dëshirojmë ta kuptojmë dhe përthithim më thellë, do të lusim për udhëzim dhe dritë nga Zoti që porosinë e Tij ta pranojmë zemërhapur dhe me dashuri, p.sh.: “Më ndriço o Zot, me Shpirtin Tënd, që ta kuptoj dhe ndjej atë që më porositi në këtë lexim të fjalës Tënde. Më mundëso ta shoh atë që është e mirë dhe e drejtë për mua në sytë e Tu. Më jep forcë ta pranoj atë...”. Pastaj do ta hapim Librin e Shenjtë dhe do ta lexojmë ngadalë atë pjesë ose vend ku kemi mbetur, ose që e kemi zgjedhur. Le të bëhet kjo në një qetësi të brendshme dhe, aq sa është e mundur, në qetësi të jashtme: *“Dhe kur lexohet Kur’an, dëgjojeni atë dhe heshtni, ndoshta do të jeni të mëshiruar”* (el-A’raf, 204).

Si duhet më tej të vazhdojë kjo shkallë e parë *Lexo?* Fjalën e Librit do ta lexojmë ngadalë dhe të përqendruar. Sipas intensitetit të përqendrimit mbi tekstin dhe sipas peshës së tekstit do të ishte mirë që pjesën tonë ta lexojmë disa herë, që ta kuptojmë dhe përvetësojmë sa më mirë, duke i vërejtur elementet dhe momentet e tij thelbësore. Ky veprim është shumë i thjeshtë: duhet patur kujdes për fjalët, për subjektet e ngjarjes, për ndjenjat e pejgamberëve dhe aktorëve, për tiparet e veprimit të tyre, për faktet që përmenden ose që rrjedhin nga të folurit apo veprimi i aktorëve. Do të ndalemi edhe në botën e pasur të simboleve që eventualisht i sjell teksti. Do t’i ekspozohemi veprimit të të gjitha atyre momenteve, do të lejojmë të na godasin dhe do t’i dëgjojmë jehonat e tyre ideore dhe shqisore në shpirtin tonë... Nëse tanimë kemi arritur afërsi me Shkrimin e shenjtë – Fjalën e Allahut, do të rikujtojmë mbase edhe disa vende paralele ose pjesë të ngjashme nga Libri – ose atyre që janë të kundërta me tonën; do të na kthehen, mbase, edhe kujtime për marrjet tona të mëpar-

shme të ngjashme me Shkrimin... Kështu të lexuarit tanë gati pa u vërejtur do të shtrihet në kontekst më të gjerë, ndërsa pjesa e zgjedhur do të na bëhet plastike, elokuate dhe e pasur në të shprehurit e saj; gjithnjë e më shumë do ta zbulojmë profilin e saj, thellësinë dhe lartësinë e elementeve të saj. Do të vërejmë, për shembull, se nuk është shkruar përnjëherë e as rastësisht, por që është fryt i të menduarit dhe meditimit në mëshirën e Zotit, përmbledhje e përsiatjes së vetë pejgamberëve, evliave dhe shehidëve e as'habëve të Pejgamberit a.s.

Këtë lloj leximi mund ta bëjnë shumë lehtë të gjithë besimtarët që e dëshirojnë këtë, ngase kjo nuk është ekzegjenzë në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Gjatë kësaj, natyrisht, duhet të angazhohemi, sepse pa angazhimin e brendshëm teksti ndoshta do të na thotë disa gjëra që tashmë i njohim dhe të cilat atëherë eventualisht do të orvatemi t'i zbatojmë tek vetja dhe në jetën tonë të përditshme, por që pjesa e jonë e zgjedhur nuk do të mund ta çlironte tërë fuqinë jetësore me të cilën është e ngarkuar dhe atë ta "derdhim" në shpirtin tonë. Teksti i shenjë në të vërtetë është *si hekuri i shkrirë që rishtas farkohet që të mund të shihet forca e pjesëve të veçanta të tij*. Në këtë kuptim vlen rregulla e lashtë nga koha e Hidrit a.s.: Tërë veten tënde tërësisht dorëzoja tekstit, ndërsa tërë tekstin tërësisht zbatoje tek vetja!

Me këtë u futëm në shqyrtimin e fjalës së Zotit si përsiatje.

b) Shqyrtimi dhe meditimi

Kur, duke e lexuar kështu tekstin, e ndjejmë se kuptimi i tij na dhurohet në ndonjë fjali, shprehje, fjalë, tablo, simbol, aktor, ngjarje të përshkruar dhe të ngjashme, ne i dorëzohemi atij. E përsërisim për shembull atë fjalë, shpr-

ehje ose fjali ngadalë në vete dhe përpiqemi ta ndjejmë barrën, peshën, bukurinë, harmoninë e saj. E shikojmë fotografinë, pamjen, veprimin e ngjarjes ose e imagjinojmë simbolin dhe domethënien e tij më të thellë të fshehtë të brendshëm. Me këtë lejojmë të na vinë sidomos në shprehje vlerat e përhershme të tekstit; tani për tani nuk ndalemi në atë se si të gjitha këto tingëllojnë në brendësinë tonë, por i shqyrtojmë, i meditojmë qëndrimet, ndjenjat, mendimet dhe veprimin e aktorëve të tekstit, e kapim kuptimin dhe peshën e fjalëve të tyre... Gjatë kësaj gjithashtu mund të na ndihmojnë të gjitha fuqitë e imagjinatës sonë: në shpirt do ta paraqesim për shembull atë që e kemi lexuar si ngjarje të gjallë... si fjalë që na drejtohet neve personalisht. Tek ne do të fillojnë të jetojnë asociacione dhe kujtime të ndryshme, por ne duhet që gjithmonë t'i ndërlihdhim me porosinë e tekstit me të cilin merremi, që ajo që zgjohet tek ne, të mos na dridh dhe tërheqë andej nga teksti ynë nuk dëshiron të na udhëheqë. Kësisoj fitojmë qasje të thellë në vetë "çështjen e tekstit".

Për këtë le ta vështrojmë, për shembull, qëndrimin e Zotit ndaj njeriut, atë që çdo tekst i Shkrimit të Shenjtë e shpreh pak a shumë në mënyrë të qartë: mëshirën, dashurinë, besnikërinë, drejtësinë, kujdesin e vëmendshëm... Ose qëndrimin e njeriut ndaj Zotit: falënderimin, pendimin, lavdërimin, përuljen, lutjen, frikë-respektin, mahnitjen...; le t'i shohim edhe ato qëndrimet negative: gënjeshtërinë, poshtërsinë, tradhtinë, frikën, llogarinë... Vlerat e përhershme të tekstit tonë, që do t'i vërejmë kësisoj, do të na nxisin t'i krahasojmë me situatën tonë personale jetësore: do të pyetemi se si i përjetojmë ne ato, do të shohim se si gjendemi në to dhe si reagojmë ndaj tyre (p.sh.: a na prekin në mënyrë të këndshme apo të pakëndshme; a na

gëzojnë apo na shkaktojnë dhimbje; çfarë dhimbjesh; a e ndjejmë që më me dëshirë do të iknim prej tyre apo do të qëndronim në to përgjithmonë...?)

Meditimi i tillë prej besimtari është i ngjashëm me atë të Merjemes: ajo në të vërtetë në vete i ruante ngjarjet dhe fjalët në lidhje me Isain a.s., të birin e saj, i zgjidhte në zemrën e saj dhe i ruante me kujdes në kujtesën e zemrës. Ruajtja dhe zgjedhja e kujtimeve nga Merjemja e fuste edhe vetë atë në të kuptuarit më të thellë dhe më gjithëpërfshirës të Zotit, të Cilit ajo iu vu në shërbim. Edhe me ne do të jetë ngjashëm, ngase fjalët e Shkrimit për ne janë si udhërrëfyes dhe shtigje që çojnë në thellësinë e kuptimit të jetës sonë. Aty në të vërtetë zbulohet veprimi i tërësishëm shpëtimtar i Zotit, vullneti i Tij i shenjtë në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Meditimi na tregon se Zoti flet qetë dhe përmes aluzioneve dhe tablove, nga larg, duke e shënruar atë që dëshiron të na e kumtojë në Shpirtin. Këtë, nga ana tjetër, mund ta zbulojë dhe pranojë vetëm njeriu që kalon mjaft kohë për këtë, që përpiket të jetojë në qetësi dhe që lejon ta kaptojë qetësia e brendshme dhe në mënyrën e përshkruar i dorëzohet udhëheqjes nga Fjala e Zotit.

Është plotësisht e natyrshme dhe në harmoni me gjënë në me të cilën merremi që, herët a vonë, të ndjejmë se si Zoti na drejtohet pikërisht neve me fjalën të cilën e lexojmë dhe që e përthithim në vete. Në të vërtetë, Zoti dëshiron që te çdo njeri të arrijë që fjala e Tij të mbillet porsia fara në zemrën e tij dhe aty të mugullojë dhe të mbijë me fryt. Pra, fjala e jashtme e Zotit synon të bëhet fjalë e brendshme e jona. Si mund ta dallojmë nëse kjo na ka ndodhur? Si ta njohim fjalën e brendshme?

Në jetën tonë ka mendime dhe ndjenja “të lehta” që vinë e shkojnë. Por ka edhe të tilla që kanë peshë të jashtë-

zakonshme dhe të cilat sikur janë varur për zemrën dhe kanë depërtuar në të. Mendime dhe ndjenja të tilla të rënda dhe depërtuese, që na pushtojnë në kontaktin intensiv me Shkrimin, nuk do të ketë pa frymëzimin e Shpirtit të Zotit. Ai ua jep peshën jetësore. Ato na zbulohen dhe ne i përjetojmë si dritë të brendshme të fesë, si dhuratë e të kuptuarit, njohjes, diturisë, urtësisë... Pra, kur njeriu ta ndjejë se ndonjë fjalë, fotografi, shprehje, simbol ose fjali, ose ngjarje nga Shkrimi i Shenjtë në meditim e godet kësisoj, atëherë ai guxon që këtë ta interpretojë dhe pranojë si shenjë se Zoti dëshiron që në shpirtin e tij ta vendosë farën e jetës së re, të orientuar kah rritja dhe pjekuria më e madhe. Nuk do të ishte mirë sikur njeriu t'iu ikte çasteve të tilla, mbase i shtyrë nga frika dhe zemërngushtësia (respektivisht mungesa e besimit), ngaqë Zoti do të mund të kërkonte tepër nga ai. Nëse disa gjëra na shtyjnë me këmbëngulje në veprime dhe ndryshime në jetën tonë, të cilat ndoshta prekin më thellë në rrjedhën e jetës sonë dhe në mënyrat e veprimit, do të ishte jo vetëm mirë dhe e arsyeshme, por edhe e nevojshme që për to, në kohën e duhur, të flitim edhe me dikë që ka përvojë më të madhe shpirtërore dhe njohje më të thellë për atë se çfarë ndodh te njeriu kur atë e pushton Fjala e Zotit. Meqenëse Fjala e Zotit u është dhënë të gjithëve, nuk do të ishte e arsyeshme të mendohet se çdokush është mjeshtër për vete në të kuptuarit dhe zbatuarit e saj, të cilit nuk i nevojitet njeri, sepse ai di dhe mundet gjithçka.

c) Bisedo me Zotin (lutja mendore dhe gojore)

E pamë se si nga shumësia e mendimeve dhe ndjenjave në meditim ose shqyrtim lind diçka që e godet lutësin si një e vërtetë ose çast, diçka që është sidomos e

rëndësishme për të dhe që e plotëson me një përmbajtje që dëshiron të jetojë tek ai. Guxojmë të themi që kjo nuk është pa *Shpirtin e Zotit*, dhe se njeriu këtu e zbulon fjalën e Zotit të drejtuar atij, e cila e prek, e ndriçon, e trimëron dhe e nxit. Kështu do të zbulojmë se tashmë para nesh nuk qëndron një shumësi gjërash dhe idesh për meditim dhe madje e kemi zbuluar *“atë të vetmen të rëndësishmen”, “atë pjesën më të mirë”*. Tani ne e kemi radhën që në mendimet tona, në ndjenja ose gojarisht, mbase duke belbëzuar, ta trajtojmë përgjigjen tonë ndaj apelit të fjalës së Zotit të pranuar. Kështu, në të vërtetë, futemi në njëfarë bisede me Zotin: pasi Ai na ka folur në lexim dhe shqyrtim, ne tani përpiqemi t’ia japim përgjigjen tonë në lutje, me fjalë tona, vetëm në mendime ose duke i shqiptuar fjalët që na janë zgjuar me fjalën e Zotit – ashtu siç do të na sugjeronte zemra.

Fjala e Zotit e kërkon gjithmonë përgjigjen tonë. Prandaj ajo edhe ka depërtuar në historinë tonë dhe në zemrën tonë, e ka ngritur dhe e ka zgjeruar atë. Ajo na frymëzon dhe na lëviz, na bën të gëzuar, të qetë, të bindur, plot me frikë-respekt, dashuri, përkushtim, përulje – varësisht nga ajo se çfarë është ajo fjalë nga Shkrimi me të cilën merremi, dhe si është gjendja jonë e brendshme. Duhet t’i shfrytëzojmë *“krahët”* që tani i janë dhuruar shpirtit (afektet, ndjenjat), ngase qëllimi i tyre është të na mbartin më afër devotshmërisë dhe dashurisë së Allahut. Pra, duhet lejuar që ajo që tani na e lëviz zemrën të zhvillohet në lutje të zemrës, që do të zhvillohet në formën e bisedës me Allahun, ashtu siç bisedon shoku me shokun. Me këtë rast, nuk do t’i ndjekim vetëm mendimet që na i sugjeron teksti dhe të cilat i përthithim nga ai, por gjithnjë e më shumë do ta kërkojmë Zotin *“në”* mendimet dhe *“pas”* tyre; kjo është njësoj

si kur trupin tonë ia ekspozojmë rrezeve të diellit – kështu në të vërtetë e mbajmë shpirtin të ekspozuar ndaj Zotit.

Kjo e folur spontane me Zotin është e lidhur për përjetimin e asaj që e kemi përthithur në vete gjatë leximit dhe meditimit. Kjo lutje mendore dhe gojore (sipas gjendjes shpirtërore), duhet të zgjasë për aq sa është “e pastër”, pra për aq sa nuk është e penguar nga shqetësimet të cilat domosdo paraqiten, ose deri sa lutësi nuk fillon “të humbet” në mendimet dhe fjalët e veta personale. Kur ta vërejme këtë, duhet t’i kthehemi rishtas fragmentit tonë dhe, me ndihmën e tij, t’i përmbledhim mendimet dhe t’i përqendrojmë ato duke e ndjekur porosinë e tij ose fjalën, tablonë, simbolin apo shprehjen e tij. Nëse kemi vërejtur se ka kaluar koha që e kishim paraparë për leximin lutës të Shkrimit të Shenjtë, mund ta përfundojmë “leximin hyjnor” tonin me falënderim të shkurtër, ose thjesht duke e thënë *Fatihane*. Koha për këtë lutje mendore ose gojore tek fillestarët do të jetë kryesisht më e shkurtër, ngase ata nuk mund të mbeten gjatë kohë në të pa shpërqendrim ose pa bredhje brenda ndjenjave dhe mendimeve personale, të nxitura nga teksti i Shkrimit. Duhet patur kujdes që teksti i Shkrimit të mos bëhet pretekst, respektivisht justifikim, për “përpëlitje” në idetë dhe mendimet e parapëlqyera personale, të cilat nuk do ishte e domosdoshme të kenë kurrfarë lidhjeje me tekstin e fragmentit të zgjedhur për leximin lutës.

Sipas kësaj, e shohim që leximi lutës i Shkrimit të Shenjtë nuk mbetet në meditimin, kur shkon nga qëndrimi lutës, nga biseda me Zotin në horizontin e dashurisë dhe vetë-dorëzimit ndaj Zotit, i cili sipas fjalëve të Shkrimit i sfidon ndjenjat, mendimet dhe vullnetin tonë. E gjithë kjo arrihet me bisedën, në përgjigjen Zotit. Kështu va-

zhdimisht rishtas do ta dëgjojmë Zotin dhe do të përpiqemi t'ia japim përgjigjen tonë të besimit dhe dashurisë, duke iu dorëzuar me besnikëri dhe butësi, në falënderim, përrulje, lutje – ashtu siç do të na sugjerojë zemra.

Nga kjo bëhet e qartë se qëndrimi i tillë ndaj Shkrimit i bashkon në qëndrimin dhe përpjekjen tonë të përgjithshme lutëse frymën dhe shpirtin, mendjen dhe zemrën, mendimin, ndjenjat dhe vullnetin. Mund të thuhet se lutja e tillë e sintetizon qenien tonë, duke e ngritur te Zoti, dhe njëkohësisht e thellon identitetin tonë. Në gjithë këtë është e pranishme dhe zhvillohet ajo dinamikë spontane që e bart përgjërimit tonë nga të menduarit dhe të shqyrtuarit drejt thjeshtësisë së mendimit, ndjenjave dhe elanit të tërë qenies nga Zoti. Me atë rast sipas rregullës hapen dy mundësitë vijuese për të cilat duhet të jemi të vëmendshëm: Zoti mund ta mbajë dhe ruajë njeriun në afërsi të vetën dhe ta nxisë dashurinë e tij me dashurinë e Vet, ose ta nxisë për ndonjë veprim, për vendim për ndonjë shërbim, në pajtim me stilin tashmë të zgjedhur të jetës, ose t'i hapë perspektiva krejtësisht të reja për të cilat nuk ka menduar akoma.

ç) Ngrite shpirtin te Zoti (përsiatja)

Përsiatja shfaqet kur shumësia e ndjenjave, mendimeve dhe lutjeve shkrihet në vrojtimin e personazhit të Pejgamberit a.s., që është i pranishëm në çdo faqe të Kur'anit, në çdo fragment të Shkrimit të Shenjtë. Çdo gjë që deri më tani e ka lëvizur njeriun në nivelin e ndjenjave, vullnetit dhe mendjes në përsiatje disi është “thjeshtëzuar”, respektivisht është derdhur dhe shkrire në një gjest themelor ose qëndrim të shpirtit tonë, pra të brendësisë sonë. Lutja këtu bëhet krejtësisht e thjeshtë, kryesisht pa folur, e ngjeshur në ngritjen e thjeshtë të shpirtit tek Zoti;

është kjo lutje e thjeshtë, e cila nuk ka nevojë për fjalë, por që shprehet në orientimin e papenguar të brendshëm nga Zoti. Ajo edhe mund të shprehet me fjalë të shkurtë që kumbon në brendësinë tonë, ndërsa e drejtuar Zotit: “Ti!”, “Më mëshiro!”, “Zoti im!”, “Të falënderohem!”, “Më ndihmo!”, “Përsose dashurinë time!”... apo ashtu siç na tregon frymëzimi i brendshëm. Thelbi i përsiatjes qëndron në atë që shpirti, respektivisht i tërë njeriu, të pushojë në qetësi para Zotit, në vetëdijen për praninë e pashprehshme të Tij, në gjestin e dorëzimit, faljes, përuljes, pendimit, falënderimit, e të ngjashme. Këtë çast të lutjes ndoshta më së miri e ka përshkruar S. Kierkegaard në ditarët e tij: “Për aq sa lutja ime bëhej më e sinqertë dhe më e devotshme, kisha gjithnjë e më pak diç për të thënë. Dhe në fund – heshta plotësisht. Dhe u bëra – dëgjues. E kjo është diçka tërësisht ndryshe nga të folurit. Në fillim mendoja se të lutesh do të thoshte të flasësh; por mësova se të lutesh nuk do të thotë vetëm të heshtësh, por të lutesh do të thotë – të dëgjosh! Kështu është kjo: të lutesh nuk do të thotë ta dëgjosh veten duke folur, të lutesh do të thotë të qetësohesh, të heshtësh dhe të presësh derisa të na dëgjojë Zoti” – pra të depërtojme deri tek ajo që ta dëgjojmë (në shpirt ta kuptojmë) se Zoti na dëgjon.

Përsiatja është rrugë në përjetimin e Zotit, për çka jemi të bindur se është i aftë çdo njeri. Përjetimi i Zotit qëndron në këtë: dalja nga vetvetja në dëgjimin e fjalës së Zotit; lejimi që Zoti vazhdimisht të na sprovtojë me fjalën e Tij. Aftësia për përsiatje e zbuluar dhe e ushqyer kësisoj do të na e mbushë zemrën dhe do të na ndjekë kur do të kalojmë nëpër tunelin e kundërshtive dhe mosbesimit duke e dëshmuar të Vetmin.

* * *

Kalimet midis etapave të veçanta të përshkruara janë gati të pavërejtura dhe nuk duhet të merremi shumë me to, duke dashur ta përcaktojmë saktësisht se “ku” jemi në lutje. Vetë-reflektimi i tillë, i futur në lutje, në të vërtetë e frenon dhe e vret atë. Pas përgatitjes së duhur për leximin e Shkrimit të Shenjtë më me rëndësi është ndjekja e shtytjeve të brendshme të cilat i ndojmë gjatë marrjes lutëse me Shkrimin. Etapat e përshkruara e kanë vlerën e tyre orientuese, por nuk guxojmë që me to të veprojmë si me mburojë ose kallëp që aplikohet vrazhdë. Kur “gjëja” të na kalojë në shprehi (të mirë), nuk do të ketë më nevojë ta kthejmë vëmendjen në etapat e veçanta të rrugës lutëse.

Më herët a më vonë, lutësi do ta përjetojë rezultatin specifik të pranisë së Shpirtit të Zotit në lutjen e tij, që mund ta quajmë si njëfarë ngushëllimi të ndërlidhur me gëzimin dhe paqen e qetë e të thellë. Kjo nuk është doemos të ndjehet, por do të jetë e vërtetë sepse ka lindur nga vështrimi i *gajbit*, misterit hyjnor. Njeriut i zgjerohet zemra ngase e ka vërejtur shkëndijën e atij Misteri që është shpeshherë aq i largët dhe i huaj, i vështirë dhe i errët. E tani është aq afër dhe i afërt. Këtu fryti i Shpirtit – dashuria – tregohet në zemër si lumturi dhe paqe.

Lutësi e zbulon në vete aftësinë për ta kuptuar atë që në jetën e tij, në botë dhe në histori u përgjigjet qëllimeve të Zotit për shpëtimin. Sipas mendimit të M. Arabiut, kjo dhuratë e dallimit të asaj që është në pajtim me vullnetin e Zotit – *hidajetin* e Tij, nuk del nga të menduarit e thjeshtë me arsye të përfundimeve, por nga përjetimi i thellë i brendshëm *edenian*. Dallimi e ndihmon dhe e nxit vendimin. Bëhet fjalë për aftësinë e zgjedhjes midis akteve dhe vep-

rimeve të mundshme në jetën tonë të cilat duhet t'i përgjigjen porosisë së Shpalljes. P.sh.: çfarë duhet të them, çfarë të hesht; çfarë duhet të bëj, e çfarë ta anuloj. Edhe gjatë këshillimit, në kontaktet me njerëzit, në çështjet disiplinore në fe dhe në shoqëri, në edukim, shpesh vetvetiu do të imponohet vendimi se duhet t'i studiojmë gjërat, t'i përdorim mjetet përkatëse, të kemi kujdes, ta thellojmë situatën e caktuar dhe të mos e quajmë si të përfunduar ose të zgjidhur përgjithmonë. Në gjithë këtë gjithmonë do të bëhet fjalë për vendimin që do të na udhëzojë të veprojmë sipas Kur'anit Famëlartë.

Kështu edhe duhet të jetë, ngaqë Fjala e Zotit duhet të mishërohet në veprimin tonë, në sjelljen tonë dhe në veprat tona. Kësisoj leximi lutës i Fjalës së Zotit do të bëhet shkollë e lutjes dhe shkollë e të jetuarit, ndërsa Fjala e Zotit do të na bëhet Fjalë e jetës, që do të depërtojë deri aty ku ndan shpirtin dhe frymën.





TEOLOGJIA E RAMAZANIT

“Hâ, Mîm. Pasha Librin e qartë, Ne atë e zbritëm në një natë të bekuar. Ne me siguri tërheqim vërejtjen kur zgjidhet çdo çështje e urtë sipas urdhrit Tonë! Ne me të vërtetë kemi dërguar profetë, nga mëshira e Zotit tënd, Ai me të vërtetë dëgjon dhe i di të gjitha.”

(Duhan, 1-6)

Muaji i Ramazanit konsiderohet si muaji në të cilin përsëritet dhe verifikohet teksti i shenjtë i muslimanëve, sepse në këtë muaj ka zbritur Kur’ani në natën e cila shquhet me emrin *Lejletin mubareketin*. Muslimanët sipas traditës në këtë muaj fizikisht dhe psikikisht bëjnë një përgatitje shumë të madhe për pritjen dhe përcjelljen e Ramazanit, i cili konsiderohet muaj i lutjes, i Kur’anit, i dashurisë dhe i reformës shpirtërore. Interpretuesit e fesë duhet të jenë të kujdesshëm ndaj leximit dhe interpretimit të Kur’anit, sidomos gjatë këtij muaji kur te ne mbahen ligjërata të shumta, dhe as të mos i shtojnë e as të mos i lënë gjë mangët fesë.

Në këtë vrojtim dëshiroj që shkurtimisht ta parashtroj atë që ndodh në botën e teologjisë, se si shpirti i kohës pasqyrohet mbi teologjinë sot, sepse teologjia dëshiron ta ndriçojë tërë botën e krijuar dhe jetën në të, që nga guri i vdekur deri tek galaktikat qiellore, që nga ameba e deri te ringjallja e njeriut dhe jeta e tij në amshimin e Zotit. Ajo interesohet për të gjitha dukuritë dhe ngjarjet që sjellin njohje të reja dhe krijojnë vlera të reja të cilat e përcaktojnë dhe formojnë njeriun dhe shoqërinë, duke futur shpirtin e

ri të kohës nga e cila, dhe sipas së cilës, jeton ai. Gëzimi dhe shpresa, hidhërimi dhe brenga e njerëzve të kohës sonë, e sidomos të varfërve dhe të gjithë atyre që vuajnë, janë gëzim dhe shpresë, hidhërim dhe brengë edhe të teologjisë, kështu që nuk ka pothuajse asgjë vërtet njerëzore që nuk do të gjente jehonën në zemrat e tyre. E gjithë kjo pasqyrohet te teologjia, e cila para vetes ka Kur'anin si fenomen të shpëtimit dhe mbarë gjininë njerëzore me realitetin e llojllojshëm, botën si skenë të historisë njerëzore, të shënuar me ndërmarrjet e tij, disfatat dhe fitoret e tij. Kështu ajo mendon për problemet të cilat sidomos sot e shënojnë dhe e mendojnë Ummetin dhe botën bashkëkohore: Për muslimanët dhe *kur'anizimin* e tyre, për agnosticismin, për pluralizmin, për afrimin e religjioneve botërore në kërkimin e konsensusit rreth vlerave të përbashkëta njerëzore dhe religjioze, për globalizimin dhe neokolonializmin – politik, ekonomik, kulturor; për terrorizmin – kriminel, të armatosur, të masmediave, për frikën nga ai dhe nga ardhmëria, për përplasjen mes qytetërimeve, për të drejtën e pronësisë dhe solidaritetin, për dinjitetin e njeriut dhe devijimet e ndryshme të tij të cilat përlijen si vlera të pranuar, e kështu me radhë.

Nuk ka dyshim se teologjia duhet të merret me problemet bashkëkohore, këtu nuk ka asgjë të diskutueshme. Mirëpo, teologjia nuk ka guxuar të lejojë që shpirti i kohës të futet në të, që në mënyrë negative të pasqyrohet në të, që t'i vërë në pyetje vetë themelet e fesë, respektivisht ekzegjezën, *Sunnetin*, ibadetin dhe lutjen.

Teologjia e emancipimit

Ne sot e përjetojmë botën, në të cilën shihen vetëm varfëri, sëmundje, fatkeqësi, katastrofa, mynxyra, padrejtësi të të gjitha llojeve, vuajtjet e të drejtëve dhe të pafajshmëve, kriminalitet, korrupsion, terror, luftëra, vrasje... Të gjitha këto janë shenja të kohës së sotme, por edhe të të gjitha kohërave të mëparshme. Për shkak të kësaj vuajnë individë dhe bashkësi, popuj dhe mbarë gjinia njerëzore. Gjendja e këtillë, mendojnë njerëzit me vullnet të mirë, nuk guxon të mbetet kështu. Gjendja e këtillë e keqe, mëson teologjia e emancipimit, mund të tejkalohet me ndryshim radikal të strukturave të botës sonë, strukturat e mëkatit, të cilat në të vërtetë janë strukturat e të Ligut. Kjo nuk mund të arrihet vetëm me qëllime të mira dhe me konvertim individual të zemrës, por me luftë të denjë kundër të ligës.

Këtu feja nga teoria kalon në praktikë, bëhet akt shpëtimi në procesin e çlirimit. Këtu filozofia marksiste ka ofruar disa udhërrëfyes. Të gjitha premtimet e paplotësuara të religjioneve dukeshin të realizueshme përmes praktikës shkencërisht të themeluar politike. Mirëpo, kur teologjia shndërrohet në politikë, ajo premtion shumë pak. Ndërsa aty ku politika dëshiron të jetë shpëtim, ajo premtion tepër. Aty ku ajo dëshiron të kryejë vepër të Zotit, ajo nuk bëhet hyjnore por jonjerëzore. Ajo nuk mund të jetë një formulë përgjithësisht e vlefshme për formimin shpëtimtar të rrjedhës historike të veprimtimit. Plani shpëtimtar ndërtimor i historisë së botës është një plan tjetër – *sunnetullah* – plani i Zotit, që vetëm sa vjen e përtërihet me kuptime të reja. Teologjia e emancipimit apo çlirimit në këtë muaj nga ne kërkon shqyrtimin dhe ruajtjen e *amanetit* të dhënë në Eden. Nëse nuk e bëjmë këtë atëherë ne kemi

tradhtuar premtimin e dhënë Zotit. Emancipimi shpirtëror, kulturor, shkencor mund të bëhet kurdoherë. Roli i teologjisë është shumë i madh që garanton suksese vetëm atëherë kur me vetëdije, dashuri e dëshirë i nënshtrohem Zotit, përndryshe nuk do t'i largohemi hijes së robërimit.

Relativizmi në kërkimin e së vërtetës

Relativizmi është bërë problem kryesor për fenë në kohën tonë. Ai është krijuar si dorëheqje para pafundësisë të së vërtetës, e cila si e tillë paraqitet njësoj për të gjithë. Karakteristika kryesore e saj është toleranca e cila promovon njohjen dhe lirinë dialogjike. Religjionin e sheh si pikënisje filozofike të demokracisë që bazohet mbi atë se askush nuk guxon ta përvetësojë të drejtën se e di rrugën e drejtë, se e di të vërtetën. Të gjitha rrugët pranohen si drejtime legjitime të arsyes, të cilët në dialog e kërkojnë korridorin e përbashkët të rrugës. Sistemi i lirisë sipas përkufizimit të vet duhet të jetë përbërje e pozicioneve relative, që përpriqen të merren vesh mes vete, të cilat para së gjithash varen nga konfigurimet historike që duhet të jenë të hapura ndaj proceseve zhvillimore.

Mirëpo nuk ekziston relativizëm total: ekziston e pa-drejta e cila kurrë nuk mund të bëhet e drejtë (për shembull vrasja e të pafajshmit). Dhe e kundërta, ekziston e drejta e cila kurrë nuk guxon të bëhet e padrejtë (për shembull e drejta për jetë). Në jetën politike-shoqërore relativizmit mund t'i jepet një e drejtë e caktuar. Mirëpo, kur ai dëshiron të zbatohet në fushën e etikës, atëherë shndërron në problem. Sot e ashtuquajtura teologji "pluraliste" e zë pothuaj se atë vend të cilin një kohë e zinte teologjia e emancipimit.

Duke u thirrur në dallimin e Kantit mes “*phainomenon*” dhe “*noumenon*”, ne kurrë nuk mund ta shohim realitetin përfundimtar në veten e tij, por gjithnjë vetëm paraqitjen e tij në mënyrën e perceptimit tonë përmes thjerrave të ndryshme të cilat i kemi në sytë tanë. Mësimi ynë fetar na mëson se çdo gjë është relative, përpos *vexhhu-Llah* – Fytyrës së Zotit. E gjithë ajo që ne e vërejmë nuk është ai realiteti i vërtetë që është në vetveten e tij, por është vetëm pasqyrim i tij sipas masave tona. Absolutja respektivisht Absoluti personalisht nuk mund të ekzistojë në histori, por mund të ekzistojnë vetëm modele, pamje ideale të cilat na orientojnë në diçka krejtësisht tjetër, respektivisht në dikë krejtësisht tjetër, që si i tillë aspak nuk mund të paraqitet.

Relativizmi religjioz mbështetet mbi filozofinë pas-metafizike të Evropës dhe mbi teologjinë negativiste të Azisë, për të cilën hyjnorja kurrë vetë dhe pa u fshehur nuk mund të paraqitet në botën e halucinacionit në të cilën jetojmë ne. Ajo gjithnjë paraqitet vetëm në pasqyrimet relative, ndërsa personalisht ngel jashtë të gjitha fjalëve dhe jashtë të gjitha kuptimeve në transcendencën absolute.

Edhe pse të dy filozofitë, edhe sipas pikënisjes së tyre edhe sipas orientimit, janë tërësisht të ndryshme, duket sikur megjithatë të dyja dëshmojnë mes vete në relativizmin dhe metafizikën e vet religjioze. Relativizmi në shenjë e takimit të kulturave krijon filozofinë e njerëzimit, e cila në Lindje dhe në Perëndim dukshëm e pushton hapësirën dhe fiton fuqi të tillë depërtuese, e cila pamundëson çdo përpjekje të kundërvënies. Kushdo që i kundërvihet, i kundërvihet demokracisë dhe tolerancës, që paraqesin “rregullat themelore” të unitetit njerëzor. I tilli i largohet unitetit të kulturave, që qartas është urdhër i çastit të tash-

ëm. Kushdo që dëshiron të ngelë në fenë e Librit të Shenjtë, duhet që në rend të parë të jetë i kujdesshëm në leximin dhe praktikimin e fesë, por jo duke kërkuar “të metat dhe shtrembërimet” në kulturat dhe religjionet e tjera.

Ortodoksia dhe ortopraktika

Premisa bazohet mbi përparësinë e ortopraktikës para ortodoksisë. Kjo ngritje e praktikës mbi njohjen është trashëgimi komuniste. Me flakjen e metafizikës materializmi në mënyrë logjike konstaton: aty ku njohja është e pamundshme, mbetet vetëm veprimi. Shkatërrimi i komunizmit shtrihet pikërisht në atë se është vepruar, por nuk është dëshiruar të dihet për çka, dhe sepse bota nuk u bë më “e mirë”.

Kjo është ajo pikë me të cilën ortopraktika e ka dënuar veten me dështim. Ajo, në të vërtetë, parakupton ortodoksinë. Ortodoksia do të thotë të menduarit e drejtë, të dihet mënyra e drejtë se si Zoti dëshiron të lavdërohet. Kjo ka të bëjë me besimin, ndërsa nga besimi bartet në jetë. Duhet njohur mësimin e detyrueshëm të fesë dhe të pranohet *kredoja* e përkufizuar saktë. Pra, fillimisht njohje e pastaj veprim! Në diskutimin relativist për etikën thuhet se e mira si e tillë dhe e liga si e tillë në të vërtetë nuk ekzistojnë. Teoritë relativiste nuk dëshirojnë kurrfarë obligimi me çka veten e shpallin si të tepërta, të panevojshme. Aty ku nuk ekziston më *gajbi* (Zoti), aty ideologjia dhe politika bëhen religjion.

Ortodoksia për të cilën bëhet fjalë këtu, dhe e cila shpesh herë gabimisht kritikohet duke thënë se është pengesë për zhvillim, është ortodoksia ndaj Fjalës së Zotit, ndaj tekstit të shenjtë, e cila arrihet vetëm me besim të thellë në

originalitetin e tij. Brenda kësaj ortodoksie ne mund ta gjejmë lirinë. Zoti në Kur'an thotë: *“Unë udhëzoj... dhe kush dëshiron beson, e kush nuk dëshiron nuk beson...”* Kjo është pra ajo ortodoksi: kush si dëshiron të besojë, sepse kjo ka të bëjë me pronësinë dhe të drejtën e Zotit. Ne si duket shpesh herë këtë e shndërrojmë në pronësi dhe të drejtë tonën dhe marrim ingerenca të cilat as që guxojmë t'i ëndërrojmë. Si teologë, dijetarë ne jemi të thirrur t'i paraqesim këshillat që gjenden brenda tekstit të shenjtë dhe traditës së Pejgamberit a.s. dhe jetën tonë ta jetojmë të pajisur me kulturë dhe siguri, sepse feja nuk i njeh termet “por” dhe “ose”.

Paraqitja e “New Age”

Relativizmit se “gjithçka është relative” në shumë çka i bashkëngjitet edhe *New Age*, apo Epoka e Re. Ngjashëm si gnoza antike, kjo është në pajtim me gjithçka na mëson shkenca. Nga ana tjetër, ajo i drejtohet një lloji të “mistikës” moderne: në Absoluten nuk besohet, por ajo përjetohet me përvojë. Zoti nuk është person i cili qëndron përballë botës, por ai është energji shpirtërore e cila përshkon çdo gjë. Religjion do të thotë ngritja e “unit” personal deri te “Gjithçka” kozmike. Unë-ekzistenca na ndan nga plotësia e realitetit kozmik, e shkatërron harmoninë e tërësisë dhe është arsyeja e vërtetë e mosshpagimit tonë. Shpëtimi përbëhet në çlirimin e “unit” personal përmes zhytjes në tërësinë e të Gjallit, në kthimin gjithësisë. Kërkohet ekstaza, dehja me të Pamatshmin, që mund të ndodhë në tekno-muzikën, në ritmin, në vallëzimin, në lojën e shkëmbyeshme të dritës dhe errësirës, në masën e njerëzve etj. Para-kulturat duhen përtërirë, në të cilat “uni” im futet në

fshehtësinë e gjithësisë dhe lirohet nga vetvetja. Njerëzit, sidomos të rinjtë, duhet tërhequr me aktivitetin e tyre personal, që dehja e vërtetë, të cilën e përjetojnë në ekstazat, t'i përfshijë në mënyrë aq të pasionuar që të paktën për një çast të ndjehen të lumtur, duke e harruar tërë mjerimin e jetës.

Njeriu i ri i *New Age* nuk ka më nevojë për fenë: atë e zëvendëson gnoza, frymëzim në të cilin njeriu bëhet i vetëdijshëm se është vet hyjnor. Njeriu i *New Age* nuk ka më nevojë për mëshirë: mjafton që të vihen në lëvizje fuqitë e vetëdijes së tij të cilat akoma janë pamjaftueshëm të shfrytëzuara. Ai është i pavarur, kështu që nuk ka nevojë për shpëtim: deri te shpëtimi ai do të ngjitet përmes frymëzimit të brendshëm dhe një vargu lindjesh të përsëritura, të cilat pa kurrfarë ndërmjetësimi do t'i sigurojnë pastrim dhe vetëdijesim gjithnjë e më të fuqishëm. Përshpirtshmëria e religjiozitetit të ri është përshpirtshmëri e shpëtimit të njeriut sipas njeriut.

Kjo mënyrë e mendimit dhe veprimit, që është bërë një dukuri e shpeshtë edhe në hapësirën tonë nën petkun e modernizmit, është në kundërshtim me traditën fetare dhe me vetë fenë. Aty humb besimi në Zotin me të gjitha format e lezetshme që i ka, siç janë *imani*, *takvaja*, *ibadeti* por dhe aroma e Ramazanit. Kur'ani gjendjen e lartpërmendur e konsideron si kohë të injorancës – *xhahilijet*. Paraqitja e Ramazanit faktikisht është një thirrje që shpirtin e njeriut ta mbajë nën kontrollin e burimit të vet.

Parimi i shumicës

Përveç atyre ofertave “shpaguese” dhe pos zgjidhjeve të teologjisë së emancipimit vërehen edhe dy fenomene në

bashkësinë fetare sot. Fenomeni i parë është përpjekja që parimi i shumicës të shtrihet mbi fenë dhe moralin, ashtu që përfundimisht institucioni fetar të “demokratizohet”. Kjo do të thotë: çka nuk pranon shumica, nuk mund të jetë e detyrueshme. Këtu menjëherë duhet pyetur: Cila shumicë? Mirëpo “feja”, të cilën vetë ne mund ta përcaktojmë, aspak nuk është fe. Dhe asnjë pakicë nuk ka arsye të lejojë që shumica t’ia përshkruajë fenë. Feja dhe praktika e saj vijnë tek ne ose nga Zoti, ose aspak nuk është fe.

Fenomeni tjetër ka të bëjë me *ibadetin* – lutjen. Fazat e ndryshme të “reformës” së *ibadetit* kanë krijuar mendimin se ai mund të ndryshojë sipas dëshirës dhe tekeve. Ekzgjekja e teologjisë islame mundëson kuptime të ndryshme të cilat nuk janë në kundërshtim me thelbin e fesë. Mirëpo, nuk duhet harruar se *ibadeti*, lutja aspak në vete nuk ka energjinë e konfliktit; konsensusi fetar është i pranuar dhe i lejuar me qëllim që njerëzit të kenë të drejtë të jenë nën hijen e marrëveshjes, në të cilën është edhe mëshira e Zotit. Format asnjëherë nuk guxojnë të bëhen shkak i përçarjes dhe mosmarrëveshjes. Për një gjë të tillë kërkohet njohja, dituria dhe strategjia e ekzistimit të qëndrimit të një harmonie dhe dashurie të Ummetit musliman. Mu për këtë arsye energjia e *New Age* nuk ka mundësi të gjejë strehim në fenë që ka Shpalljen dhe Pejgamberin.

Çështja e ekzegjzës dhe ajo për kufijtë dhe mundësitë e arsyes sonë, qartazi paraqesin problem kryesor në teologjinë bashkëkohore, i cili njëkohësisht ka sjellë edhe deri te kriza e fesë tek njerëzit (në Perëndim). Sa i përket vetë ekzegjzës, gjithsesi duhet theksuar se këtu nuk bëhet fjalë për rezultat të njohur dhe të provuar. Kjo, shikuar pastër historikisht dhe fjalëpërfjalshëm, thjesht nuk është e mundshme. Prandaj, bëhet fjalë për interpretim të

tekstit dhe asgjë më tepër. Ekzegjeza kurrë nuk guxon të bëhet filozofi. E këtu vlen edhe e kundërta: filozofia kurrë nuk mund të bëhet ekzegjezë, por që të dyjave u duhet Shkrimi i Shenjtë si themel, që të mund gjithnjë më shumë e më mirë ta kuptojnë porosinë e Shpalljes së Zotit.

Temat aktuale

Përveç përpjekjeve të arsyeshme rreth çlirimit nga teologjia hegjemoniste evropiane dhe promovimit të teologjive kontekstuale rajonale, temat aktuale, të cilat e kaplojnë vëmendjen teologjike, siç janë homoseksualizmi, eutanazia, aborti, mbarsja artificiale, klonimi, bioetika, ekologjia e të tjera, kanë të bëjnë me çështjet kufitare shkencore, të cilat mund të reduktohen nën një emërues të përbashkët: A është, sa është dhe si është etikisht dhe moralisht e lejuar të bëhet e gjithë ajo që është e mundur në mënyrë shkencore-teknologjike? Ose, thënë ndryshe, a guxon njeriu – krijesë, ta “zë vendin e Zotit – Krijuesit në botë?

Pavarësisht nga dhe duke patur parasysh të gjitha këto, këtu vlen parimi themelor: Nëse përjashtohet Zoti, nëse nuk ka Zot, çdo gjë lejohet dhe qëllimi arsyeton çdo mjet (komunizmi). Në rast se nga ana tjetër pranohet se ka Zot, atëherë pyetjet kufitare nga temat e lartpërmendura nuk do të duhej të mbeteshin pa përgjigje, respektivisht Zoti e ka krijuar botën dhe Ai është Zotërues i tij. Ai ia ka dorëzuar njeriut që të jetë drejtues dhe shfrytëzues i tij. Kjo do të thotë se njeriu është përgjegjës para Zotit për botën, se është i obliguar ta ruajë dhe ta shfrytëzojë për ato qëllime për të cilat është i krijuar nga Zoti dhe që atij i është besuar. Njeriu nuk ka të drejtë të pakufizuar që me botën të bëjë çfarë të dojë dhe si të dojë, por që me të të

veprojë sipas ligjeve të përhershme dhe të pandryshueshme të cilat Zoti i ka vënë në natyrën njerëzore, në natyrë dhe në mbarë gjithësinë.

Si përfundim

Por, ne si muslimanë në prag të Ramazanit me këtë kapacitet a thua vallë kemi mundësi të merremi me këto çështje të rëndësishme me një institucion i cili me vite të tëra është duke u zhytur në provincializmin religjioz dhe arrogancën fetare, i cili lirisht mund të thuhet se ka humbur garancinë e besimit dhe mëshirën e Zotit? Vetëdija për “fjalët e kota” në radhët e hierarkisë së institucionit fetar, si dhe në teologji, gjithsesi se ekziston, por akoma në masën më të madhe mbetet vetëm “shaka pa kripë” në bisedat private. Arsyeja për këtë me siguri qëndron në faktin se në këto hapësirat tona në qarqet teologjike është zhdukur kundërshtimi apo qortimi si vlera aq tipike të fesë sonë, me çka është nxitur hipokrizia e vetë institucionit dhe përgjegjësisë së tij. Prandaj nuk është aspak për t’u habitur se kohëve të fundit në opinionin më të gjerë leksionet morale popullit aq shpesh ua ndajnë njerëz nga qarqet ateiste – duke na përkujtuar për koordinatat e harruara të të jetuarit etik (fetar).

Që të mundet fjalët t’i drejtohen botës, duhet që fillimisht ne të jemi të prekur nga ato fjalë, e pas kësaj të guxojmë t’i ndajmë ato me të tjerët. Në të kundërtën, vetëm do t’u ndajmë fjalë boshe, respektivisht leksione. Pra, çështja është se paraprakisht a na tronditin vetë fjalët tona, a janë ato fryt i mrekullisë personale të “hapjes së syve”, të cilën e kemi përjetuar përmes tyre, ose në masë më të madhe bëhet fjalë për përpjekjet për të folurit e pëlqyeshëm

(për hir tonin, për hir të të tjerëve, nga kujdesi për hierarkinë e institucionit fetar etj.), respektivisht të kryerjes së detyrimit? Çështjet e reja me të cilat ballafaqohemi dhe përpjekjet teologjike për nevojën e mënyrës së re të jetesës vajtojnë edhe për një mënyrë të re të të folurit, sepse ekziston edhe etika e fjalës së thënë, pra edhe e të folurit teologjik. Mu për këtë arsye i lutem Zotit që ky Ramazan të jetë fillim i një rilindjeje shpirtërore!



Fettah Efendi Ataullah Efendi Memduh Efendi Rıza Efendi

PASQYRIMI METAFIZIK I AGJËRIMIT

*“Kur hyn muaji i Ramazanit hapen dyert e qiejve dhe mbyl-
llen dyert e xhehennemit, ndërsa shejtanët lidhen me zinxhirë.”*

(Hadith)

Agjërimi është njëra nga shtyllat më kuptimplota të besimit islam. Simbolika e tij e brendshme rrezaton me një lloj natyre tejet të fuqishme sintetizuese, meqë agjërimi në Islam në mënyrë të veçantë dhe tipike në vete i përmbledh të gjitha kuptimet, simbolet dhe shenjat e brendshme metafizike të dy shtyllave të para dhe dy të fundit të besimit islam. Duhet thënë se ai shpreh një nga parimet e rëndësishme të mënyrës individuale dhe komunitare të jetës së përditshme brenda shoqërisë muslimane. Në këtë drejtim nuk çudit ajo thënia e shenjtë e Pejgamberit a.s., me të cilën transmetohet mendimi i gjallë i urtësisë hyjnore: “Për çdo vepër të mirë Allahu shpërblen me shpërblim të dhjetëfishtë apo shtatëqindfishtë, përveç për agjërimin si dhuratë e drejtpërdrejtë e Shpirtit Hyjnor, për të cilin si shpërblim Zoti e dhuron Vetën e vet, sepse agjërimi është vet porta e devotshmërisë”.

Agjërimi në Islam paraqet udhën e qetësimit personal ekzistencial, qëllimi përfundimtar i të cilit është zhytja në mbretërinë e paqes së amshueshme, mbinatyrore që karakterizon vetë jetën brenda-hyjnore. Vendosmëria për t’u nisur asaj udhe duhet të jetë e fuqishme dhe e palëkundshme, me vetëdijen e plotë për barrën e udhës e cila e pret çdo trashëgimtar të kësaj dhurate shpirtërore.

Meqë bëhet fjalë për heqjen dorë dhe privimin këmbëngulës nga gjithçka që jeta e përditshme ia lejon çdo individit nga kënaqësitë e pastra dhe të lejuara me ligjin fetar, atëherë nuk është e rastit që institucioni i agjërimit në Islam në rend të parë kërkon nga agjëruesi që në rrugën e cekur të niset me pastrimin shpirtëror të veçorive më të jashtme të individualitetit personal. Kështu, ai që në fillim duhet ta privojë individualitetin e vet nga llomotitja dhe të folurit e tepërt për atë që i kundërvihet kënaqësisë Hyjnore, urtësisë së Tij dhe vullnetit të Tij, mu si në heshtjen e Merjemes me të cilën ajo në mënyrë shembullore dëshmonte agjërimin në nivelin e të folurit të saj të jashtëm fizik. Agjërimi i gjuhës së saj e solli deri te suksesi i plotë shpirtëror, e furnizoi me frutat e freskëta të palmës të cilat në kontekst të teksteve të shenjta qartë simbolizojnë ëndjen dhe lumturinë e plotë të jetës shpirtërore në paqen, bashkësinë, sigurinë dhe praninë e amshueshme të Zotit. Mirëpo, udha e cekur ia mundësoi edhe parashijen e qartë ekzistenciale të së vërtetës së fjalëve hyjnore të cilat me hare ia paralajmëruan pranimin si dhuratë të fëmijës së pastër, peygamberit të Allahut, Isait a.s., bashkë me të cilin do të shkelë në tempullin e amshuar të urtësisë së shenjtë dhe të palëndueshme të Shpirtit Hyjnor.

Që këtu, agjëruesi në Islam duhet ta frenojë shikimin e tij nga çdo gjë e ndaluar, duke shikuar vetëm atë që e ka të lejuar dhe të domosdoshme, që do të thotë se shikimi nuk duhet të bredhë nëpër tërë peizazhin e kopshtit me shumë lule të dynjasë, por qenësisht duhet të jetë i përqendruar mbi qendrën e atij kopshti, si paradhënie për të gjitha ekzemplaret e tij në Parajsën qiellore. Ose, të shikojë në atë malin e Musait a.s., në të cilin tërësisht iu shfaq e vërteta e fjalëve Hyjnore; me një fjalë, të shikojë aty ku e

vërteta i lë gjurmët e saja të dallueshme, e jo aty ku gënjeshtër, iluzioni dhe shtirja i vendosin vezët e tyre të qyqes. Më tutje, agjëruesi nuk mund ta drejtojë dëgjimin e tij nga të dojë, e sidomos jo andej nga vjen urrejtja, ofendimi, të folurit e kotë, shpifja, spiunimi dhe çfarëdo dëshmimi i rrejshëm, sepse “edhe dëgjimi edhe shikimi edhe zemra, të gjitha do të përgjigjen”. Shqisa e shijes gjithashtu duhet të jetë e përmbajtur nga çdo lloj shijimi fizik të begative tokësore, të cilat çdo shpirt i gjallë i shijon në ditët jashtë agjërimit, si dhe shqisa e ndijimit të cilës gjatë agjërimit i janë të ndaluara të gjitha aromat tokësore, të këndshme apo të pakëndshme. E sa për shqisën e prekjes të mos flasim në veçanti, ajo duhet të jetë e kursyer nga çdo lloj kënaqësie.

Agjërimi nuk është dhënë për arsye të realizimit të dhunës ndaj shqisave fizike të çdo personi individual. Qëllimi i tij është krejtësisht fisnik dhe pashtershëm i përshatshëm. Me dhuratën e agjërimit çdo shpirt musliman tenton që shqisat e veta fizike t’i shndërrojë në ato krejtësisht shpirtërore. Në të vërtetë, dhurata e agjërimit jo vetëm që nivelohet mbi shqisat fizike, por gjithashtu edhe mbi ato shpirtërore të njeriut. Ajo bën që cilësia e kujtesës t’i pranojë dhe ruajë ato horizonte të Qenies hyjnore në botë, të cilat më drejtpërsëdrejti e udhëzojnë çdo shpirt musliman në udhën e urtësisë hyjnore dhe në shtegun e njohjes mendore që shpie drejt asaj urtësie, respektivisht dhurata e cekur përpiqet që vertikalen njerëzore ta bëjë sa më të përputhshme me atë hyjnore, mendjen kozmohistorike njerëzore me Mendjen metahistorike hyjnore, që paraqet mundësinë e vetme reale të arritjes në shkëlqimet e Parajsës së harruar qiellore.

Dhurata e agjërimit e ushqen imagjinatën njerëzore dhe e mëson që të dijë t’i ruajë kufizimet të cilat ia ka cak-

tuar vullneti hyjnor, që të ndalet në format e jashtme të gjërave dhe të mos merret me hamendjet dhe opinionet që janë të privuar nga përmbajtja e mjaftueshme. Vetë imagjinata është e privuar nga fuqia e tillë shpirtërore, dhe që këtu përpjekja e saj në atë drejtim lind frytet e mashtrimit, dyshimit, supozimit që kërcënon ekzistencën fizike të individit. Dhe kështu me radhë deri te kulmi i vertikales njerëzore dhurata e agjërimit përpiqet që t'i tubojë të gjitha fuqitë më të mira shpirtërore për çdo veti psiko-fizike dhe për çdo shqisë të individualitetit të veçantë musliman.

Kur të përmblihdeshin të gjitha thekset qenësore të cilat nxirren nga ajo që do të mund ta shënonim si pedagogji e veçantë shpirtërore e dhuratës së agjërimit në Islam, atëherë do të na imponohej qëllimi unik, më i lartë dhe përfundimtar i kësaj përpjekjeje shpirtërore dhe këtij udhëtimi ekzistencial që e parasheh kuptimi më i ngushtë i agjërimit në Islam. Ky qëllim shihet në dëshirën e çdo shpirti të veçantë musliman që në kuptimin më të ngushtë të fjalës të orvatet, të paktën për një kohë të caktuar, të jetojë me jetën të cilën e jeton vetë Shpirti Hyjnor, duke ia shëmbëllyer kësisoj natyrën personale natyrës së Emrave dhe Atributeve të Zotit dhe, në pajtim me këtë, natyrës së veprimeve të Zotit në botën e formave të dukshme.

Nga ana tjetër e zbulojmë edhe një qëllim shumë të rëndësishëm të këtij institucioni shpirtëror, që, shikuar më me vëmendje, paraqet parakushtin e pashmangshëm dhe parashijen për atë qëllimin e parë të përmendur. Ky qëllimi i fundit shihet në ndikimin shpirtëror të agjërimit, i cili individualitetin e veçantë musliman pagabueshëm e mban në shtegun e ngushtë të ecjes së baraspeshuar, e cila është e thurur me prapësi të shumta. Më seriozja nga të gjitha është ajo që shpie në çfarëdolloj shirku apo mëkati të rëndë, hija

vdekjeprurëse e të cilit bie deri mbi nivelin e fundit të qenies individuale njerëzore që do të binte në mëkat të tillë.

Dhurata shpirtërore e agjërimit në Islam, ndër të tjerat, është këtu që me sendërtimin e përpiktë nga ana e agjëruesit në mënyrë shpirtërore ta shërojë pjerrjen shpirtërore të shqisave psiko-fizike dhe vetive të çdo “vetë”-sie individuale muslimane, dhe t’i qetësojë dhe frenojë të gjitha thirrjet trupore brenda nesh, të folurit e zhurmshëm të trupit, që të mund t’i dëgjojmë thirrjet mbinatyrore të paqes qiellore në thellësinë e zemrës sonë, në hapësirën e shenjtë gjeografike mikrokozme në të cilën takohen boshti vertikal i mendjes sonë dhe boshti horizontal i shpirtit tonë. Thirrjet mbinatyrore të asaj paqeje atje dëgjohej me fuqinë e agjërimit plotësisht të sendërtuar sipas fjalëve të Pejgamberit a.s. në hadithin kudsî: “Kushdo që Më kërkon, Më gjen; kushdo që Më gjen, orvatet të Më njohë; kushdo që vjen të Më njohë, fillon të Më dojë fuqishëm...” Ata që janë veçanërisht të talentuar për këtë lloj hermeneutike shpirtërore në Islam konsiderojnë se këto fjalë paraqesin dëshmi kryesore për kuptimin ekzistencial dhe shtrirjen epistemologjike të dhuratës së agjërimit në Islam.

Veçanërisht mbresëlënëse është konteksti kohor brenda të cilit ndodh agjërimi në Islam, e që është koha e muajit të Ramazanit, i cili paraqet kohë-fron në kalendarin kozmohistorik të vitit tokësor. Ajo është po ashtu kohë-fron në kalendarin metakozmik të vitit qiellor, një ditë e të cilit zgjat sa pesëdhjetë mijë vitesh tokësore. Shifra e cekur, pa dyshim, është më tepër me vlerë simbolike sesa ekzakte. Kjo, me fjalë të tjera, do të thotë se koha e Ramazanit është kohë eminente qiellore ose kohë e vetë rendit mbinatyror hyjnor në të cilin të gjitha distancat hapësinore janë të reduktuara në një ‘këtu’ të pandryshueshme, ndërsa të

gjitha dallimet kohore në një 'tani' të amshueshme. Koha e Ramazanit sipas natyrës së saj të brendshme është e tillë madje edhe në kalendarin kozmohistorik të vitit tokësor, megjithëse në botën dhe jetën e kësaj bote mbi vete mbath petkun ekzistencial të thurur nga distancat e ndryshme kohore dhe format e shumëfishta hapësinore.

Më tej, koha e Ramazanit ka edhe petkun e vet mbi-natyror ekzistencial të nxjerrë drejtpërsëdrejti dhe të rritur nga natyra luksoze e Urtësisë hyjnore dhe Vullnetit hyjnor dhe që mund të vërehet lehtë për shkak të vizualizimit dhe individualizimit të vet metahistorik dhe metakozmik. Dëshmia më e mirë për këtë pohim është Shpallja hyjnore, ky akt qendror i vetëzbulimit dhe vetë-sendërtimit të shumëllojshëm të Shpirtit Hyjnor në ecjen e tij qenësore nëpër vertikalen zbritëse të Qenies hyjnore, që i formon të gjitha botët këtej dhe andej yjeve. Aq më tepër që Shpallja hyjnore nuk paraqet dëshmitarin e tillë shpirtëror për pohimin e mësipërm, i cili qëndron në distancën e pakapërcyeshme përballë kohës së Ramazanit, por paraqet akt të gjallë dhe të pashkëputshëm të Urtësisë dhe Vullnetit hyjnor, akt i cili sendërtohet brenda kohërave të Ramazanit. Të gjitha të dhënat kompetente nga tradita konstituive e besimit islam tregojnë se Zoti hapësirën dhe kohën shpirtërisht më të përshtatshme e ka gjetur në Ramazan, që për të parën herë dhe në tërësi t'u shpallet botëve të natyrës së arsyeshme dhe të paarsyeshme të çdo gjëje të krijuar. Pra, në Ramazan filloi të folurit e Shpirtit Hyjnor në mënyrën e të amshuarës Fjalë të Zotit, që do të thotë se të gjitha shpalljet hyjnore, që nga kohërat e *suhufeve*, pastaj nëpërmjet atyre të Zeburit, Tevratit, Inxhilit e deri te kohërat kur'anore të Fjalës së Zotit, janë zbuluar në muajin e bekuar të Ramazanit.

Që aty Ramazani është si një Libër i Shenjtë i hapur që në vete njëkohësisht përmban Natyrën si *Liber mundi* dhe Historinë si *Liber revelatus*, Makrokozmosin (Botën) dhe Mikrokozmosin (Njeriun), e kjo është pikërisht ajo që në mënyrën më të mirë shpreh procesin e gjithmbarshëm shpirtëror të vizualizimit dhe individualizimit të vetë shpirtit të kohërave të Ramazanit.

Nga ana tjetër, shpirti i kohërave të Ramazanit në vete njëkohësisht e shkrin vetë vertikalen e amshimit metakozmik të shprehur me Natën e Kadrit ose natën e njëzeteshtatë të Ramazanit. Ajo natë është vetë teatri parajsor i Fjalës së Zotit në të cilin luhet drama qiellore-tokësore e Misterit dhe Njëmendësisë hyjnore. Është kjo natë e baraspeshës nga e cila shihen të gjitha botët e Natyrshme dhe të Mbinatyrshme. Përveç kësaj, është kjo nata e intimitetit më romantik, nata e zemrave të ndriçuara me një të vetmen dritë të së amshuarës Fjalë Hyjnore. Në të sidomos dy *intima* shikojnë njëra-tjetrën dhe janë të ndriçuara nga përsosuria dhe bukuria e vet: njëra pejgamberiane si pasqyrë e lustruar, ndërsa tjetra hyjnore, qartë e pasqyruar në pasqyrën e lustruar të asaj të parës. Është kjo natë në të cilën Fjala Hyjnore mbipersonale vizuelizohet dhe sendërtohet në dritën transparente të Shpirtit Hyjnor dhe në nuancat e dritës së melekëve brenda të cilave Shpirti Hyjnor ka derdhur begatinë e brendshme të dritës së vet dhe natyrës së vet. Ajo natë vështirë se do të mund t'ia siguronte tiparin e absolutes shpirtit të kohërave të Ramazanit sikur në vete të mos i paqësonte, përveç dimensionit zbritës-manifestues të vetëzhvillimit të Parimit hyjnor (*el-Batin*), edhe dimensionin ngjites-njohës të vetë-sendërtimeve të Manifestimit hyjnor (*edh-Dhahir*). Në zbritjen e natës të Shpirtit Hyjnor nëpër vertikalen e rreptë të Kadrit

të Ramazanit detyrimisht është parakuptuar kthimi ditor i atij Shpirti të njëjtë nëpër horizontalen e Agjërimit. Ashtu siç është nata e njëzeteshtatë e Ramazanit (*Lejletu-l-Kadr*) koha nyjore e vertikales së Ramazanit, njësoj edhe dhurata shpirtërore e agjërimit (*saum*) është kohë nyjore e horizontales së Ramazanit. Mes tjerash fjala është për dy ngjarje kyçe brenda kohërave të Ramazanit nga të cilat e para paraqet përfundimin e kremteve të Ramazanit, ndërsa tjetra paraqet kubënë e tyre të gjithmbarshme. Ngjarja e parë në vete ngërthen tërë bukurinë metafizike të kohërave të Ramazanit, ndërsa ajo tjetra simbolizon virtytin e plotë etik dhe mirësinë e Ramazanit. Në Natën e Kadrit Shpirti Hyjnor i trumbetoi të gjitha të vërtetat për Fytyrën e vet metafizike, ndërsa në ngjarjen e Agjërimit i dëshmoi të gjitha dhuratat shpirtërore që dalin nga qendra e të vërtetave për Fytyrën metafizike të Shpirtit Hyjnor.

Në të vërtetë, në Natën e Kadrit ndodh pranvera metafizike e Fjalës së Zotit, ndërsa në Agjërimitin piqet vjeshta eskatologjike me të gjitha frytet e veta shpirtërore, nga të cilat më të çmuara janë fryti i mëshirës (*rahmet*), fryti i faljes (*magfîret*) dhe fryti i shpëtimit (*selamet*). Me dhuratën e *rahmetit* Shpirti Hyjnor e themelon qenësinë e botës në mënyrën e së Mirës Supreme, në rast se ajo e Mirë mbillet në natyrën e makro dhe mikrokozmosit nën llojin e emrit hyjnor i Mëshirshmi (*er-Rrahman*). Nga ana tjetër, me atë dhuratë e themelon llojin gjithëpërfshirës të qenësisë së vet brenda natyrës së arsyeshme mikrokozmiqe, brenda hapësirës qendrore të veçantisë njerëzore nën llojin e emrit hyjnor Mëshirëploti (*er-Rrahim*), që me fuqinë e vet mëshiruese nga brenda e përshkon çdo krijesë. Më tutje, me dhuratën shpirtërore të *magfîretit* Shpirti Hyjnor brenda kohërave të Ramazanit vendos një dimension

të veçantë të kohës së shenjtë. Ky është dimension i kohës së shenjtë brenda të cilit janë të përfshira të gjitha ngjarjet kyçe të vetë-shpalljes hyjnore në mënyrën e Librit të Shenjtë, e cila deri në plotësimin e kohës mbetet si shenjë e faljes së gjithmbarshme hyjnore dhe lidhjes së përhershme të vendosur me shpirtrat devijues të botës, me theks të veçantë mbi shpirtrat e krijesave të arsyeshme në botë. Përfundimisht, me dhuratën shpirtërore të *selametit* nuk i është vënë vetëm guri i kubesë periodizimit të shenjtë historik të kohërave të Ramazanit dhe, kësaj, periodizimit të Shpalljes hyjnore, por me dhuratën shpirtërore të lartpërmendur i është dhënë parashija ekzistenciale përfundimit të gjithë gjithësisë, simbolizimit total kohor dhe ritmit të vitit kozmik.



AGJËRIMI NDËRMJET FESË DHE BESIMIT

“Kush nuk e braktis të folurit e rrejshëm dhe veprimin sipas tij, Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë ushqimin dhe pijen e tij.”

(Hadith)

“Agjëruesi ka dy gëzime: në iftar dhe me rastin e takimit me Zotin e tij.”

(Hadith)

“Agjërimi është mburojë, ndaj kur dikush nga ju të agjërojë, le të mos flasë fjalë të turpshme dhe le të mos bërtasë; e nëse dikush e shan apo e sulmon, le të thotë: unë agjëroj!”

(Hadith)

Përsëri Ramazan... a thua është përsëritje? Nëse po, ç' do të thotë kjo; nëse jo, ç' do të thotë kjo?! Ajo se si përsëritet, pse përsëritet, çfarë do të thotë përsëritja janë pyetje që në vete i ngërthen Ramazani. Përsëritja është në natyrën njerëzore, kurse në urdhrat e Zotit nuk ka përsëritje: çdo urdhër i Zotit ndodh vetëm një herë dhe është gjithmonë i ri. Si duket ne, duke u mbështetur mbi natyrën tonë, përpiqemi ta përvetësojmë këtë natyrshmëri jo të natyrshme dhe me përsëritjen t'ia humbim vlerën. Botëkuptimi i këtillë është i pranishëm në mendësinë tonë, në ambientin jetësor tonë dhe në rrethin tonë. Ne kemi shkuar aq larg sa që këtë muaj të shenjtë përgatitemi fuqishëm ta largojmë nga burimi i tij dhe ta bëjmë muaj të “ahengut”. Kjo tregon se ne nuk jemi duke e kuptuar atë agjërimin që Kur'ani na e prezanton dhe Muhammed Mustafai a.s. e praktikon; ose thënë duke u bazuar në raportin mi-

dis religjionit/fesë dhe besimit: kurdo që religjioni është shfaqur si institucion, ka vdekur besimi; sepse religjioni nuk beson, por vetëm e zbaton në realitetin historik mosbesimin e vet. Prandaj – njëherë e përgjithmonë – duhet ndarë besimin nga religjioni mosbesimtar. E agjërimi është çështje e besimit.

Agjërimi islam, agjërimi që na e ka urdhëruar Zoti, burimin dhe mbështetjen e ka tek besimi, kurse bukuria, përsosuria e besimit, *ihsani*, siç është thënë në takimin midis Xhibrilit a.s. dhe Pejgamberit a.s. në prani të as'habëve, është: “ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë Atë; ngaqë edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty”. E tërë jeta jonë është dhe duhet të jetë nën mbikëqyrjen e Zotit. Natyrisht, jam i ndërgjegjshëm se besimi është *iman*, por trajta më e lartë e asaj që ty të bën ta ndjesh veten se je afër Krijuesit, se Krijuesi të do, të mbikëqyr, të bën të sigurt, të afrohet që ti të kënaqesh me ato gjashtë shtyllat e *imanit*, është forma më e bukur e praktikimit edhe e agjërimit, por në një trajtë të një bukurie të veçantë, siç është *ihsani*. Kjo është ajo enigma më e thellë e një privatësie, intimiteti të besimit, ngaqë besimi është dhuratë dashamirëse, sepse vjen me mëshirën e Vullnetit hyjnor, që është i ethshëm për besëlidhjen e besnikërisë midis Zotit dhe njeriut si kurorë e krijimit të përgjithshëm.

Sa i përket fjalës *ihsan*, ajo ka shumë domethënie, trajtat e shumta të së cilës japin një fotografi ekzistuese tonën. Disa nga domethëniet e fjalës *ihsan* janë: të bëhesh i shkëlqyer; të bëhesh i hijshëm; të bësh mirë, të dukesh i mirë apo i bukur; “të shkëlqyer janë ata si shoqëri” (4:69); “Ai e bëri të mirë vendqëndrimin tim” (12:23); “Ai ishte shumë i sjellshëm ndaj meje” (12:100); “Dhe bëju mirë (të tjerëve), ashtu siç të bëri Allahu ty” (28:77). E në fjalorin e gjuhës së sotme

shqipe, fjala “bukuri” ka këto domethënie: 1. Që ka tipare të rregullta, vija e lëvizje të harmonishme, brendi të shëndoshë e tërheqëse etj., dhe që me këto të jep kënaqësi e të bën ta admirosh; që është përkryer në llojin e vet; i hijshëm; 2. Që shquhet e çmohet për përmbajtjen e lartë; që vlerësohet e pëlqehet shumë për vetitë e mira morale, për ndjenjat, për karakterin etj. etj.

Ihsani, pra, ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë Atë; ngaqë edhe pse nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty, do të thotë ta adhurosh Zotin se e sheh; do të thotë të jesh nën hijen e Bukurisë; ajo është fjala më tërheqëse e gjithçkaje, ajo na bën ta harrojmë fiziken; ajo na “djeg”, na detyron ta “shkrijmë” vetveten vetëm për ta arritur kulmin, apo për ta prekur atë të fshehtë, vetëm për një çast, që të shkrihet i tërë trupi; që ta arrijmë kënaqësinë e Zotit, që Ai të na dojë, pra ta përjetojmë *ihsanin*.

A thua i këtillë është agjërimi ynë?! Fatkeqësisht, atë jemi duke e shndërruar në një metafizikë të panevojshme, ndonëse kjo nuk do të thotë se e shterim anën metafizike të agjërimit, por ku do të ishte kjo anë metafizike e agjërimit pa *ihsan*, pa bukurinë e tij, pa fiziken e tij, pa përgatitjen e një lartësie morale, një shoqërie më të shëndoshë. Çfarë kuptimi do të kishte ana metafizike e agjërimit pa këto? Agjërimi nuk do të kishte kuptim pa devotshmëri, pa *ihsan*, pa drejtësi, pa uri, pa lodhje, pa anën e prekshme, pa anën përsëritëse, pa anën e ditës dhe natës, pa atë të kohës që ne e presim dhe që ai na vjen, pa syfyryn. Pra, qëllimi i agjërimit është pikërisht kjo forma e lartë: *ihsani* dhe devotshmëria (*takva*), ndërsa në agjërimitonë as njëra as tjetra nuk shihen, nuk përputhen me domethëniet e lartshënuara: në jetë, në kulturë, në fe, në filozofi, në shkollë, në universitet, në xhami, në politikë etj.

Duke u mbështetur mbi përmbajtjen e agjërimit dëshiroj ta përshkruaj anën e dukshme të jetës sonë si agjërues, e ajo është përplot paradoks dhe zhurmë. Si është jeta jonë, sa është e bukur ajo, pas cilës bukuri rendim ne, çfarë bukurie jemi duke lënë? Për këtë flet fotografia jonë ekzistuese, që nga ajo se si e kemi të rregulluar shtëpinë tonë; sa i japim rëndësi pastërtisë; sa kemi fjalor të pasur dhe të mirë; sa përpiqemi të praktikojmë atë fjalor; sa dëgjojmë dhe si dëgjojmë; sa kemi respekt ndaj Librit, Fjalës së shenjtë dhe jetës së shenjtë, ndaj vetvetes, ndaj prindit, ndaj bashkëshortes/it, ndaj fëmijës? Pa patur nevojë për t'u përgjigjur me "po" ose "jo", mjafton të them se të gjitha kërkimet sociologjike-psikologjike dëshmojnë se ne sot jetojmë në një mjerim shumë të frikshëm, të dhimbshëm.

Sot, nuk mund të ecim rrugëve lirshëm, ngaqë ato e kanë humbur bukurinë dhe funksionin e tyre; mëhallët janë shndërruar në zhurmë dhe tollovi, të ngushtuara nga veturat, të shëmtuara nga "bukuria", përplot muzikë tallava, ke frikë të flesh dhe të gëzohesh, sepse dëgjohesh nga "shija" jonë arkitektonike; larg turpit dhe dashurisë, thuajse je futur në një humnerë dhe mezi pret dritën dhe sigurinë. E ku haset e gjithë kjo? Tek ata që "agjërojnë", tek ata që i thonë vetes se i përkasin fesë më të përsosur, më të bukur, më të dashur, më të sigurt, më të pastër.

Pa marrë parasysh kohën, njeriu për çdoherë ka vrapsuar dhe është përpjekur me mish e me shpirt ta mbrojë, ruajë, ndërtojë "kiblen", qendrën, vendin për lutje. Në fjalorin tonë musliman, kjo është xhamia. Xhamia ka qenë gjithmonë hapësirë apo zonë e shenjtë, e mbrojtur. Duke patur parasysh të gjithë këtë, shtrohet pyetja se ku është shenjtëria e xhamisë sot? I vetëdijshëm se këtë që po e them është përsëritje, nuk mund ta anashkaloj faktin se xhamitë tona janë

shndërruar në vende të “humbjes së kohës” vis-à-vis kafe-neve/çajtoreve; edhe ezani nis me një zhurmë të madhe që i kapërcen përmasat e thirrjes për lutje, dhe që fatkeqësisht dëshmon inat dhe frikë. A thua “ezani” i tillë i zhurmshëm ka lidhje me besimin, apo mos ka vazi/ligjërata e zhurmshme që i bën njerëzit ta humbasin kontrollin nëpër rrugë nga zëri gjerrës? Edhe ezani i tillë, edhe vazi i tillë janë shprehje e “kulturës” personale, private të llojit katundaresk, apo tepër “qytetar” të atyre që e thërrasin apo ligjërojnë, natyrisht në emër të Kur’anit. Pastaj, ku është kultura e dialogut, pesha e urtësisë në mesin e xhematit? Për momentin nuk jemi duke e parë. E të mos flas për estetikën e xhamive tona, kulturën e heshtjes, qetësisë dhe dëgjimit të ibadetxhinjve ku duhet të pasqyrohet bukuria e *imanit* dhe siguria e *islamit*, sidomos në muajin e agjërimit.

Agjërimi ynë duhet të jetë përgatitje e besimtarit për përsosmëri morale e intelektuale, dhe nuk guxon të lejojë të ketë zbrazëti në këtë dimension. Mirëpo, a është kështu në realitet? Jo, ngaqë sot në shkollë shkohet jo për të mësuar; fakulteti kryhet pa u përgatitur; nuk studiohet, por intervenohet; arsimtarët nuk “guxojnë” ta kryejnë obligimin e tyre prej mësimdhënësi, sepse kanë “frikë” nga dhuna dhe terrori i “prindërve” që edhe “agjërojnë”; e vërteta heshtet, ndërsa ndihmohet zullumi i organizuar në formë familjesh, klanesh madje edhe nga “haxhilerë” që “agjërojnë”, ndërsa vetë paraqitjes së tyre i vjen era kriminelë dhe amoralitet, ndonëse marrin mbi vete rolin e “shpëtimtarëve”. Të njëjtit përpiqen ta mashtrojnë “fenë” dhe fetarin edhe me iftare me hurma, mish, bakllava, por me asgjë që ka të bëjë me *saumin*, *ihsanin* dhe *imanin*.

Duket qartë se ne i kemi përzier gjërat: fenë e kemi lënë pa besim, besimin e kemi lënë pa fe; besimin mund të

mos e vërejmë, sepse ai është një lidhje intime midis shpirtit të përhershëm të njeriut dhe Krijuesit të atij shpirti, Krijuesit të gjithësisë. Andaj mund të pohohet se askush nuk mund ta dijë se sa është dikush besimtar dhe çfarë besimi ka. Po, plotësisht pajtohem, ashtu është dhe ashtu duhet të jetë. Por ç'të bëjmë me zullumin, me frikën, pandershmërinë, uzurpimet, shpërdorimet, vjedhjet, shkatërrimet, papërgjegjësinë në punë dhe në jetë?! Feja thotë kështu: ne gjykojmë sipas asaj që e shohim. E për atë që jemi duke e parë, Zoti na shpëtoftë dhe na ndihmoftë!

Qëllimi i agjërimit të muajit të Ramazanit mes tjerash është përtëritja e Shpalljes, përkujtim i së kaluarës, prezantimi i shpëtimit dhe udhëzimit, ngritja lart e njeriut dhe mbrojtja e tij. Në këtë muaj ne duhet ta kujtojmë kohën e Ademit a.s., Nuhut a.s., Zekirijait a.s., Junusit a.s., Lutit a.s., Musait a.s., Isait a.s. dhe Pejgamberit Muhammed a.s. Duhet t'i kujtojmë të gjitha sprovat nëpër të cilat kanë kaluar këta dhe pejgamberët e tjerë në kohërat e tyre, dhe dënimet që ranë mbi popujt e tyre për shkak të mëkateve që bënë, e që për fat të keq edhe në këtë kohë përsëriten. Dënimi i të gjithë atyre popujve ka qenë rezultat i mospranimit të plotë të njëshmërisë (*tevhidit*) së Zotit dhe heshtja para dukurive të shëmtuara brenda shoqërive të tyre. Në besimin musliman të gjithë e dinë se *ummeti* i Pejgamberit Muhammed a.s. nuk do të ndëshkohet në mënyrë të tillë. *Amenna/Besojmë!* Por, kjo nuk do të thotë se neve na lejohet e ndaluara, sepse vetë Kur'ani urdhëron që të bëhemi të drejtë, të devotshëm, të dobishëm për shoqërinë, të bëhemi njerëzit më të mirë.

Koha e agjërimit duhet domosdo të ketë një qëllim, një fuqi, një porosi, një kërkesë, përndryshe agjërimi nuk do të ishte ai që ka qenë dhe është; agjërimi ka qenë një

nga sprovat e profetëve, një nga shpëtimet më të mëdha ku është dëshmuar e vërteta, siç ishte rasti me të ëmën e Isait a.s. kur iu vërsulën mushrikët me ofendime dhe përçmime nga më të ndryshmet. Le ta shohim kohën tonë: i madh e i vogël ankohet, ka frikë të jetojë; fotografitë e refugjatëve do të jenë *ajete*/shenja të përhershme për gjininë njerëzore.

Pa u thelluar në thellësitë e prezantimit të problemeve ekzistuese edhe në këtë kohë, është mirë që të bëjmë njet e t'i lutemi Zotit të na përgatisë ta kalojmë këtë kohë të vështirë, këtë çnjerëzi të rrezikshme, dhe që të përgatitemi ta mbrojmë vetveten tonë, pra njeriun brenda nesh; të mësohemi të jetojmë të pavarur, tamam të pavarur ne muslimanët shqiptarë, sepse e tërë e kaluara jonë ka kaluar dhe është duke kaluar me "mbrojtjen" nga të tjerët, me kërkimin e ndihmës nga të tjerët; i harrojmë dhuntitë që na i ka dhënë Zoti, ato dhunti duhet të na mësojnë të jetojmë të pavarur nga gjithkush, por të plotësuar me të mirat e kulturës, besimit dhe natyrës së përhershme njerëzore.

Mënyra më e mirë për ta plotësuar këtë dëshirë për përmirësim dhe pavarësi intelektuale, kulturore, "politike", është puna, por edhe lutja. Ndërsa nuk ka kohë më të mirë për lutje se gjatë muajit të agjërimit, dhe gjithsesi brenda tij në Natën e Kadrit. Në të vërtetë, në Natën e Kadrit ndodh pranvera metafizike e Fjalës së Zotit, ndërsa në agjërimin piqet vjeshta eskatologjike me të gjitha frytet e veta shpirtërore, nga të cilat më të çmuara janë fryti i mëshirës (*rahmet*), fryti i faljes (*magfiret*) dhe fryti i shpëtimit (*selamet*). Me dhuratën e *rahmetit* Shpirti Hyjnor e themelon qenësinë e botës në mënyrën e së Mirës Supreme, ne rast se ajo e Mirë mbillet në natyrën e makro dhe mikrokozmosit nën llojin e emrit hyjnor i Mëshirshmi (*er-*


Rrahman). Nga ana tjetër, me atë dhuratë e themelon llojin gjithëpërfshirës të qenësisë së vet brenda natyrës së arsyeshme mikrokozme, brenda hapësirës qendrore të veçantisë njerëzore nën llojin e emrit hyjnor Mëshirëploti (*er-Rrahim*), që me fuqinë e vet mëshiruese nga brenda e përshkon çdo krijesë. Më tutje, me dhuratën shpirtërore të *magfiritit* Shpirti Hyjnor brenda kohërave të Ramazanit vendos një dimension të veçantë të kohës së shenjtë. Ky është dimension i kohës së shenjtë brenda të cilit janë të përfshira të gjitha ngjarjet kyçe të vetë-shpalljes hyjnore në mënyrën e Librit të Shenjtë, e cila deri në plotësimin e kohës mbetet si shenjë e faljes së gjithmbarshme hyjnore dhe lidhjes së përhershme të vendosur me shpirtrat devijues të botës, me theks të veçantë mbi shpirtrat e krijesave të arsyeshme në botë. Përfundimisht, me dhuratën shpirtërore të *selametit* nuk i është vënë vetëm guri i kubesë periodizimit të shenjtë historik të kohërave të Ramazanit dhe, kësajori, periodizimit të Shpalljes hyjnore, por me dhuratën shpirtërore të lartpërmendur i është dhënë parashija ekzistenciale përfundimit të gjithë gjithësisë, simbolizimit total kohor dhe ritmit të vitit kozmik. Elementet e kësaj bote në kohën e përgatitjes së iftarit shumë lehtë të bëjnë që ta nuhasësh një aromë tërësisht tjetër të një metafizike edeniane.

Por, ne si muslimanë në prag të Ramazanit me këtë kapacitet a thua vallë kemi mundësi të merremi me këto çështje të rëndësishme me një organizim i cili me vite të tëra është duke u zhytur në provincializmin religjioz dhe arrogancën fetare, i cili lirisht mund të thuhet se ka humbur garancinë e besimit dhe mëshirën e Zotit. Vetëdija për “fjalët e kota” në radhët e hierarkisë fetare, si dhe në teologji, gjithësesi se ekziston, por akoma në masën më

të madhe mbetet vetëm “shaka pa kripë” në bisedat private. Arsyeja për këtë me siguri qëndron në faktin se në këto hapësirat tona në qarqet teologjike është zhdukur kundërshtimi apo qortimi si vlera aq tipike të fesë sonë, me çka është nxitur hipokrizia. Prandaj nuk është aspak për t’u habitur se kohëve të fundit në opinionin më të gjerë leksionet morale popullit aq shpesh ua ndajnë njerëz nga qarqet ateiste – duke na përkujtuar për koordinatat e harruara të të jetuarit etik/fetar. Që të mundet fjalët t’i drejtohen botës, duhet që fillimisht ne të jemi të prekur nga ato fjalë, e pas kësaj të guxojmë t’i ndajmë ato me të tjerët. Në të kundërtën, vetëm do t’u ndajmë fjalë boshe, respektivisht leksione. Pra, çështja është se paraprakisht a na tronditin vetë fjalët tona, a janë ato fryt i mrekullisë personale të “hapjes së syve”, të cilën e kemi përjetuar përmes tyre, ose në masë më të madhe bëhet fjalë për përpjekjet për të folurit e pëlqyeshëm (për hir tonin, për hir të të tjerëve), përkatësisht të kryerjes së obligimit? Çështjet e reja me të cilat ballafaqohemi dhe përpjekjet teologjike për nevojën e mënyrës së re të jetesës gjakojnë edhe për një mënyrë të re të të folurit, sepse ekziston edhe etika e fjalës së thënë, pra edhe e të folurit teologjik. Mu për këtë arsye i lutem Zotit që ky Ramazan të jetë fillim i një rilindjeje shpirtërore!

“Agjërimi është mburojë, ndaj kur dikush nga ju të agjërojë, le të mos flasë fjalë të turpshme dhe le të mos bërtasë; e nëse dikush e shan apo e sulmon, le të thotë: unë agjëroj!” (Hadith)

Ramazan 1437



RAMAZAN I RI

(Përshkrim sipas kohës dhe vendit)

Prapë po vjen muaji i agjërimit – Ramazani. Pse? Sipas asaj që veprohet, respektivisht, sipas asaj që është bërë shprehi ndër ne, ne nuk kemi Ramazan të ri, por të përsëritur, kurse Ramazani i Zoti është gjithnjë i ri. Nuk e di nëse mund të ketë ndonjë përgjigje që e plotëson përmbajtjen e pyetjes, dhe që i jep kuptim vazhdimësisë së këtij fenomeni shumë të rëndësishëm në tërë procesin e shpalljes. Edhe në kohët më primitive, agjërimi ka qenë një praktikë e rëndësishme; kurse Shpallja këtë e bën shumë më të afërt, më kuptimplotë dhe agjërimi disi e sfidon edhe Shpalljen; kur them e sfidon, mendoj në atë se ai i zhduk të gjitha fuqitë materiale dhe e bën hapësirën e qetësisë dhe pastërtisë, “vdekjes”, brenda një sekreti shumë të thellë, vetëm e vetëm që ta mbrojë, t’i japë kuptim të pamundshmes, me një mekanizëm të mundshëm, por prapëseprapë që mbetet enigmë.

Të agjërosh do të thotë të heshtësh; të agjërosh do të thotë të haramin “ta bësh” hallall, e hallallin “ta bësh” haram dhe atë ti si agjërues. Ky dimension mund të dëgjohet, por kjo për ne për momentin është shumë e vështirë; paramendoni atë fluturimin në hapësirë, ku hesht gjithçka – ky është agjërimi; aty pandërprerë agjëron. Mu për këtë arsye edhe thuhet se në këtë muaj, në këtë kohë kanë ndodhur ngjarje të mëdha dhe çdoherë kanë qenë përgatitje dhe dëshmi se njerëzimit i vjen diçka, i jepet diçka, i merret diçka. Faktikisht, koha kur çdo gjë zhduket, vetëm paraqitet mëshira e Zotit, *vexhhu-Llah*.

Koha e agjërimit është kohë e metafizikës, kurse metafizika është shpirti që duhet ta kontrollojë anën materiale. Në këtë muaj ka zbritur dhe zbret Kur'ani; muaj i Fjalës së Zotit; muaj kur kontrollohet besimi dhe si obligim kërkohet një përkushtim i veçantë. Edhe pse si kusht sipas asaj që radhitet në traditën e Pejgamberit a.s., agjërimi është *emr*, urdhër i Zotit, i katërt ose i pestë, nuk e di, por për mua më e kuptimtë do të ishte që agjërimi të ishte urdhri i parë, sepse duke agjëruar te njeriu hapen dyert e pamundësisë, respektivisht mundësisë që sa më tepër të dashurohem me atë që kam në brendësi; se me të e shoh nevojën që t'i besoj Zotit. Por, pasi që Muhammed Mustafa a.s., kështu e ka radhitur, edhe unë ashtu i besoj. Si duket lezetin e besimit në Zot, lezetin e agjërimit, lezetin e haxhit dhe zekatit, që të gjitha këto mund t'i gjejmë në këtë kohë të agjërimit.

Gjithë këtë që e thashë më sipër nuk e kisha ndër mend, sepse mu ky dimension nuk është i lehtë; ky është dimension i ngjashëm me momentet me të cilat janë ballafaquar shkencëtarët, respektivisht që i ka bërë ata shkencëtarë: molla ia hapi sytë Newtonit; Hajdegerit metafizika; Kolakovskit ia hapi sytë heshtja ku e gjen Zotin. Po mirë, neve çka është duke na bërë agjërimi!? A thua ne kemi të drejtë që këtë urdhër *Rabbani* ta bëjmë urdhër kasetofoni!? Realiteti i sotëm e vërteton këtë, sepse është mbyllur për ta pranuar një moment siç është graviteti, një moment siç është agjërimi, ose siç është mëshira e Zotit.

Nëse duhet ta përshkruaj gjendjen tonë, që është gjithsesi shumë e rrezikshme, mendoj për besimtarët, nuk do të duhej shumë të thuhet, sepse të gjithë e dinë se rrena është mëkat i madh, vjedhja shkatërron gjithçka, *gibeti*, përgojimi, prish shpirtin dhe familje; kryelartësia të bën

hiçgjë; e çka të themi për urdhrat e Zotit i Cili thotë: Namazi që falet në emër të Zotit pastron mëkatet dhe e shton *takvanë*, devotshmërinë, dhe ai që nuk e praktikon – nuk është besimtar. Ndaj, ai që e harron Fjalën e Zotit, përjeton ngërçe shpirtërore dhe çmenduri. Po ashtu, ai që nuk e jep *zekatin* ballafaqohet me varfëri. Shumë urdhra të ngjashëm kemi, që sot te ne janë bërë si pjesë e “besimit” tonë. Kështu, në kuptimin e kundërt, kanë vepruar popujt e mëparshëm dhe kanë përjetuar dënimet më të rënda; dënimet e këtilla mund t’i shihni edhe nëpër emisionet speciale, po ashtu edhe në librat e shkruara për historinë dhe qytetërimet e mëparshme. Sa për mëkatet që i theksova më sipër, ato disi kanë mundësi të duken si të vjetruara, sepse koha është duke na sjellë dhe duke na ballafaquar me gjëra që janë shumë “më të mëdha”, më të lashta se të lashta (ashtu të paktën mendojmë), e ne i kemi lënë anash dhe nuk merremi me to.

Sa për fotografinë e muslimanëve, kërkoj falje që do të bëj përsëritje, por e kam të domosdoshme që rishtas ta them se ajo që është duke ndodhur vetëm brenda këtyre 15 viteve, nuk ka ndodhur te popujt e mëparshëm; jemi dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha, shkatërrimeve të mëdha, vjedhjeve të mëdha, respektivisht një kolonializëm i paparë në botë. Mjafton ta dëgjojmë se çka janë duke thënë shtetet të cilëve sot më nuk u dihet as fillimi e as mbarimi, mendoj në shtetet me popullatë që i përkasin fesë islame, që janë dëshmitarë të shkatërrimit të vet, tamam siç ka ndodhur edhe në kohët e mëparshme, ku shumë popuj përjetuan ndëshkimin e Zotit, si popujt Ad, Themud, Lut; kurse sot Irak, Libi, Siri... ngjashëm, për së gjalli janë duke e parë se çfarë po u ndodh. Kur’ani këtë mënyrë të dënimit e përshkruan në një *ajet* të vetin: “...

sepse ishin nga ata që nuk e largonin njëri-tjetrin nga e keqja, nga ndalesat e Zotit..." dhe u bënë lanet, të mallkuar. Ja mallkimi i Zotit, çfarë kërkojmë ne mallkim më të madh kur brenda këtyre viteve të fundit me miliona fëmijë vdiqën, me qindra e mijëra u konvertuan, e të mos flas për miliona e miliona njerëz të pastrehë, dhe vetëm një Zot e di se çfarë ka ndodhur me moralin, me dinjitetin njerëzor. Çdo fotografi ma bën me dije se unë nuk e meritoj agjërimin, sepse jam duke heshtur, e lejoj mashtrimin.

E lejoj mashtrimin... edhe atë disa herë jam i dënuar ta pranoj mashtrimin dhe të "kënaqem" me të. Sot dënohet një përkatësi fetare në formën më vulgare, edhe pse as fjalori e as kultura nuk mund të pranojnë se në Islam ka terrorizëm, fundamentalizëm. Dhe a e dini se nga kush vjen kjo: vjen nga ata që janë mburrë se e kanë përdorur edhe armën bërthamore për të zhdukur qytetërimin, e të mos flas për garat që zhvillojnë se si të armatosen më tepër, e prapë nuk konsiderohen terroristë. Kur i lexoni thënie të shkencëtarëve që kanë marrë pjesë në këtë lëmi, habiteni; disa kanë thënë se ky është fundi i botës. Ne e harrojmë këtë trishtim të shkencës, për të cilën tregohemi se jemi të etur, e për çfarë?!? E ç'të themi për dëgjimet, përgjimet, spiunimet, a ka terrorizëm më të madh se ky që sot sillet vërdallë rreth nesh?

InshaAllah nuk më thoni: zbrit në tokë. Po, keni të drejtë, ne u ankuan dhe shkruam histori derisa morëm madje edhe dëmshpërblime nga koha e vështirë e komunizmit. Por, a thua kjo dha rezultat të mirë? Jo, neve në këtë kohë të "lirisë" kemi dështuar edhe më shumë, thuajse jemi besimtarë për arsye se nuk kemi mundësi të jemi mosbesimtarë dhe anasjelltas; fenë e kemi marrë nën kontrollin tonë dhe ajo nuk ka mundësi të dalë jashtë korniza-

ve të përshkruara, të përkufizuara sipas kohës, vendit, traditës, emrit, mbiemrit, firmave. Por a nuk jemi duke e vërejtur se kjo nuk është asgjë, kjo nuk është fe, kjo nuk ka të bëjë asgjë me besimin. Ne jemi bërë aq shumë “besimtarë” sa që edhe Zotit, *hasha*, mundohemi t’i themi se Ti nuk ke mundësi të na e marrësh neve besimin, nuk ke mundësi të na e marrësh agjërimin; agjërimi dhe feja janë nën kontrollin tonë. A e dini kur kemi mundësi të kemi të drejtë për këtë? Vetëm atëherë kur nuk ka Zot; përndryshe është Ai Zot që i ka lëshuar këta urdhra dhe i lëshon si mëshirë, dhe se si shpëtim për ne i ka rregullat e Veta, që janë të përshkruara në Kur’an dhe që ne i përsërisim shpeshherë. Besimtar i mirë është ai që nga goja dhe dora e tij janë të sigurt të tjerët. Edhe goja, edhe dora janë duke na luftuar neve. Për çfarë besimtarësh, për çfarë agjëruesh flasim ne?!

Dikush mund të pyesë se çfarë dua të them me këtë? Dua të them se ky muaj duhet të jetë muaj i një fillimi të ri dhe atë që nga plotësimi i besimit e deri te ringjallja e fesë; sepse këtë tablo ekzistuese nuk kemi mundësi ndryshe ta largojmë nga ne, nga njeriu, derisa ai të mos frymëzohet ashtu siç urdhëron Shpallja. Shpallja nga ne kërkon të çlirohemi nga frika, nga robërimi i mendjes dhe i shpirtit, të çlirohemi nga mashtrimet dhe trillimet që krijohen vetëm e vetëm për robërimin dhe mashtrimin tonë; të çlirohemi nga frika e varfërimit/pasurimit.

Muaji i heshtjes, agjërimit, është ky; ky muaj që kërkon nga ne të heshtim nga të folurit e kotë, por të mos heshtim përballë së pavërtetës, që kërkon që të jetë e plotësuar dhe e ndriçuar zemra jonë me Shpalljen e Kur’anit, të shtohet devotshmëria, të mendohet vëllazërimi njerëzor, të kuptohen besimtari dhe jobesimtari, të respektohet feja

e tjetrit; kërkohet nga ne të mbisundojë kultura e lartë në xhami, *sexhdeja* të jetë e plotësuar, kërkohet nga ne të jemi larg nga format e ndryshme që për çdo ditë kanë filluar të bëhen forma që krijojnë urrejtje dhe mashtrim; kërkohet të mendohet vetvetja dhe në këtë vetvete të futet edhe tjetri. Vetëm kështu mund ta dëgjojmë atë heshtjen e madhe, të fuqishme me një *nur* në fytyrën e besimtarëve përballë *iftarit* “modest”, por me një arome të Xhennetit.

Pikërisht në këtë kohë hapjani zemrën Zotit, luteni Allahun e Gjallë, të Përhershëm, të Pavdekshëm, i Cili thotë: “Lutmuni, kërkoni nga Unë”. E ne duhet të lutemi dhe të kërkojmë si besimtarë të jemi të ndërjegjeshëm për peshën e Fjalës Tënde: O Zot, na e pastro zemrën, na e shtu dashurinë, mos lejo që të kemi sprova të mëdha para të cilave jemi duke dështuar; o Zot, pranë nesh janë duke vdekur fëmijë, pranë nesh përdhunohen gra, pranë nesh feja keqpërdoret; na ndihmo të mos lejojmë diçka të tillë të ndodhë, sepse Ty të besojmë dhe nga Ti presim udhëzimin dhe shpëtimin; o Zot, mos na mundëso ta keqpërdorim Fenë Tënde; o Zot, djalli është duke na lodhur dhe munduar, në çdo sekondë, edhe Ty kur përpiqem të të lutem ai përpiqet të futet mes nesh, Zot përjetoma pranë gjosjen e tij; Zot, na e largo frikën që është duke na e robëruar shpirtin dhe trupin; Zot mos na bëj nga ata që shiten e blihen, mos na bëj shërbëtorë të të tjerëve, por vetëm shërbëtorë të Tu. Zot, na ndihmo të mos e hidhërojmë Pejgamberin Muhammed Mustafa, a.s., i cili flijoi gjithçka vetëm për hir të asaj që ishte kumtues i Fjalën Tënde.

Amin!

Shkup, 1 Ramazan 1438



KUR ËSHTË BAJRAM?!?

*“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut
dhe mos u përçani...”*

(Ali Imran, 103)

Çështja që do ta diskutoj në vijim është shumë e rëndësishme dhe si shkas për të ishte ngjarja që ndodhi më 27 maj 2016, dhe e cila po të mos ishte tragjike, do të ishte qesharake. Isha në një xhami të Vjenës për ta falë namazin e së xhumasë; xhamia i përkiste komunitetit arab, që me shumicë ishin jordanëzë. Në një çast imami iu drejtua xhematit me fjalët: “vëllezër kini kujdes, *vaktijen* e namazit, respektivisht *imsakijen* e Ramazanit nuk do ta bëjmë sipas kësaj (dhe ngriti dorën me një *imsakije*), sepse kjo nuk është në rregull.” E keni parasysh, bëhet fjalë për kohët e namazit, ndërsa dihet se një ndër kushtet e domosdoshme – *farz*, të namazit është që ai të falet në kohë saktësisht të përcaktuar, njësoj siç janë edhe koha e syfyrit dhe iftarit.

Ky rast më ktheu në kohën e rinisë sime, në vitet 1975 e këndej. Ishte ajo kohë kur në vendin tonë kishte studentë nga bota arabe; Jugosllavia e atëhershme kishte një numër goxha të madh studentësh arabë, sidomos nga Libia, ngaqë Xhamahiria e Gadafit, e cila sot është në shpërbërje e sipër (fatkeqësisht), dërgonte numrin më të madh të studentëve, dhe atë deri në atë shkallë sa që edhe në Akademinë Ushtarake të Jugosllavisë kishte studentë nga Libia, që ishin tamam nën kontrollin e ushtrisë jugos-

llave, dhe kishte edhe departamente të veçantë në Beograd dhe në Sarajevë për studentët e Gadafit. Që të mbetet si shënim dëshiroj të cek edhe këtë paradoks në “emër” te Islamit, se studentët e vitit të fundit të studimeve të mjekësisë, vinin për t’i kryer ushtrimet e tyre në lëndën e mjekësisë ligjore në universitetet jugosllave, ngaqë në Libi ishte “haram” obduksioni. Ja një haram të panjohur në Islam, por të pranishëm te muslimanët.

Pra, në ato vite shumica e këtyre studentëve që përmenda, si dhe nga vende të tjera si Siria, Iraku, Jordania, Palestina dhe një numër shumë i vogël nga Kuvajti, i ndiqnin studimet nëpër universitete të ndryshme, por vetëm një numër shumë i vogël i tyre e praktikonin Islamin, kurse dalëngadalë, një numër i madh i tyre pasi erdhën këtu u “fetarizuan”. Si dhe pse, është një temë që i përket fushës së sociologjisë së religjionit, por ajo që dua ta them në mënyrë të veçantë është se me “fetarizimin” e tyre filluan të dalin në shesh edhe disa çështje shumë interesante, dhe atë me një metodologji “racionale”, por larg urtësisë dhe qetësisë shpirtërore dhe fetare. Këta faktikisht Islamin filluan ta mësonin duke u mbështetur vetëm mbi njohjen e gjuhës arabe, e jo sipas traditës së medresesë së teologjisë dhe urtësisë së Kur’anit. Deri në atë kohë, tek ne nuk ishin si temë çështjet se kur fillon Ramazani, kur bie Bajrami e kështu me radhë. E këta studentë përpiqeshin t’i mësonin për fenë edhe disa kolegë të tyre vendas, shqiptarë që, për arsye të kohës së komunizmit, nuk ishin shumë të familjarizuar me Islamin. Në të vërtetë, asokohe xhamitë ishin të zbrazëta nga studentë dhe intelektualë. Për çudi, këtë mënyrë të Islamit “të përkthyer” vetëm nga arabishtja filluan ta mësonin pikërisht ky lloj i muslimanëve “të vonuar”. Po, fjala ishte për atë siç thotë Kur’ani:

“Agjëroni në kohën e caktuar në muaj të caktuar...” dhe syfyri duhet mbyllur “kur të dallohet peri i bardhë nga peri i zi...” Kritika ishte se imsakijet/takvimet e asaj kohe të Bashkësisë Islame nuk ishin në rregull dhe se patjetër duhej shkuar nga ajo që të shihej me sy hëna dhe atëherë të fillonte agjërimi. Ky veprim filloi të praktikohet në disa familje muslimane, por më e dhimbshme ishte se u krijua një çrregullim i madh brenda familjes muslimane, brenda shtëpisë muslimane. Këtë mënyrë patologjike të praktikimit të Islamit duke u mbështetur vetëm mbi gjuhën arabe, ma përkujtoi paralajmërimi i imamatit në Vjenë. Fatkeqësisht, kjo mënyrë e veprimit vazhdon edhe sot pothuajse në mënyrë identike me atë Islamit e “gjuhës arabe”, me qëllim që vetëm të “islamizohet” me çështje “atraktive”, por pa *terbije* shpirtërore të Islamit të familjarizuar nëpër shtëpitë tona.

Në vijim do të orvatem që deri diku ta paraqes aktualitetin e sotëm që mbretëron në shumë vende të botës në kohën e muajit të agjëritimit, respektivisht rreth çështjes së “iftareve” dhe të “bajrameve”. Vite me radhë përsëritet i njëjti problem me caktimin e fillimit dhe mbarimit të agjëritimit, edhe pse kjo *elhamdulillah-Lah* në hapësirën e Ballkanit, pra edhe në trojet shqiptare, disi është e stabilizuar. Kjo anomali është më e pranishme në vendet e Perëndimit si SHBA, Australi dhe Europë, ndaj ndodh që në një vend kemi çeshit-çeshit kohësh ramazanesh/bajramesh dhe namazesh. P.sh., në një fabrikë ku ka të punësuar muslimanë nga vende të ndryshme, ata ulen ta presin iftarin së bashku, por dikush e prish agjërimin më herët, dikush më vonë, të gjithë të bindur se pikërisht ata e bëjnë iftarin në kohë. E tani paramendoni se çfarë përshtypjeje len kjo te jomuslimanët. Ehhh, kështu ndodh kur me “telefon/inter-

net” merren *fetva* nga “ulemaja” qe dinë arabisht. E njëjta ndodh edhe me bajramet, me ç’rast dikush kërkon ditë të lirë në filan datë, e të tjerë pas një dite, pas dy ditësh, apo kur pyeten se në cilën datë bie Bajrami që t’u mundësohet ditë e lirë, ata përgjigjen me hutit: nuk e dimë!?! Për ta parë paksa se pse dhe si ndodh kjo vizitova disa faqe në Internet. Dhe, ja me çka u ballafaqova kur kërkoja t’i shoh kohët e namazit për Shkupin:

<http://www.muslimpro.com/Prayer-times-adhan-Skopje-Macedonia-785842;>

<http://www.prayertimes.com/macedonia/skopje-prayer-times.html;>

<http://www.abmrsal.com/prayer-times/en/macedonia/skopje;>

http://sunsunrisetime.com/prayer-time/Skopje_13826.html;

<http://www.prayertime.net/macedonia/skopje-prayer-times.html;>

<http://www.namazvakti.com/Main.php?cityID=8757;>

<http://takvim.ihya.org/makedonya/shkupi-uskup-skopje-namaz-vakitleti.html>
etj., etj...

Ja, kjo është gjendja e muslimanëve, pra as për gjërat fizike nuk mund të merremi vesh – as për kohën e namazit. Është fakt se *ulemaja* (*muxhtehidët*) kanë të drejtë të shfaqin dallime në kuptimin e ndonjë çështjeje të dhënë, por assesi nuk guxojnë t’i lënë muslimanët në dyshim. Pastaj, kohët e namazit, koha e agjërimit janë ndër kushtet e domosdoshme për plotësimin e *ibadetit* të Zotit. Kjo aq më pak nuk duhet lejuar të bëhet në programet televizive të llojit “show”, ku shpesh herë na dalin “prof. dr.”-a të *hadithit* dhe të *tefsirit*, edhe të *shariatit*, që përpiqen t’i tregojnë aftësitë e tyre intelektuale duke u treguar muslimanëve se ja, tash është koha e iftarit/syfyrit, e kështu me radhë, e në anën tjetër e kanë *imsakijen* e përcaktuar nga komuniteti musliman i tyre. Ose, siç veprohet në disa vende të botës arabe, duke marrë dy dëshmitarë beduinë arabë, pa marrë parasysh kapacitetin e tyre, që dëshmojnë se kanë parë hënën e re dhe aty për aty i drejtohen radios

dhe televizionit (pra teknologjisë) për t'i informuar muslimanët se ja fillon Ramazani, apo erdhi Bajrami.

Çfarë mjerimi; në njërën anë kemi një lloj “tradiciona-lizmi” të panevojshëm, e në anën tjetër kemi shkencën. Nga natyra nuk jam njeri që mahnitet me përparimin e shkencës, por për hir të së vërtetës duhet pranuar se shkenca dita-ditës është duke u zhvilluar me një hov marra-mendës dhe këtë çështje mund të na e zgjidhë shumë lehtë, duke na larguar nga çeshit-çeshit... Duhet vetëm vullnet i mirë nga ata që merren me këto çështje.

Siç e pamë, është ky një realitet shumë nënçmues për ne, ngase kjo dëshmon një zbrazëti të thellë dhe një dyshim të madh për atë se ne nuk e kuptojmë rëndësinë e Islamit dhe mësimet e Islamit, ose nuk dimë t'i kuptojmë urdhrat që Kur'ani dhe tradita e Pejgamberit a.s. na i paraqesin. Në kohën e Pejgamberit a.s. nuk ka patur kësi lloj mosmarrëveshjes, pra një kohë e lutjes në një vend të caktuar të thirret në kohë të ndryshme. Sidomos kohën e namazit nuk kemi të drejtë ta kuptojmë me dyshim, sepse diçka e tillë nuk është në vetë natyrën e të kuptuarit tonë.

Siç thashë më lart, një ndër krizat e interpretimit të fesë tek ne ishte mbështetja e interpretimit të Islamit vetëm mbi njohjen e gjuhës arabe, faktikisht një Islam i përkthyer apo interpretuar nga gjuha. Përpos kësaj, kohëve të fundit kemi interpretime që mbështeten mbi thëniet fetare; thëniet fetare asnjëherë nuk e japin kuptimin e plotë, pa u mbështetur mbi tërësinë e problemit, e *Usul-i Fikh* këtë e shpjegon shumë mirë. Por, për fat të keq, edhe te ne “teologët” e shumtë, të cilëve nuk u dihet as fillimi e as mbarimi, mund ta paramendoni se çfarë mund të bëjnë dhe çfarë janë duke bërë me interpretimin e fesë: pandërrerë fusin dyshime edhe në ato momente, edhe në ato

praktikime fetare tona ku nuk ka fare nevojë të ketë dyshime. Ky lloj subjektiviteti nuk ka mbështetje në mësimet e fesë islame, por për fat të keq më tepër në “mendësinë” e paedukuar dhe egoizmin e trishtueshëm që shpeshherë është duke i turpëruar edhe ata me vetë kohën. Kur them me vetë kohën mendoj në atë se shumica e këtij soji teologësh për çdo vit sa vinë e mbushen me diçka dhe i ndryshojnë interpretimet, duke filluar nga koha e iftarit, kohët e namazeve, e deri te mbulesa: në fillim këmbëngulet se duhen mbuluar edhe sytë, e pastaj dalë-ngadalë mbulesa bëhet më “moderne”. Natyrisht se faji është i yni, i teologëve, sepse jemi duke lënë shumë zbrazëtira të mëdha, nuk jemi duke shfaqur përgjegjësi të lartë për atë se çfarë duhet thënë; problemet e këtilla sa vijnë dhe shtohen. Paramendoni që për shkrimet dhe përkthimet e shumta që janë duke u publikuar nuk kemi fare një trup intelektual teologjik të organizuar mirë që do të bënte recensimin e asaj që shkruhet dhe prezantohet. E Allahu xh.sh. në Kur’an na urdhëron: *“E mos flisni gënjeshtër që i shqiptojnë gjuhët tuaja: ‘Kjo është e lejuar (hallall) e kjo e ndaluar (haram)’ që të mos shpifni ndaj Allahut...”* (en-Nahl, 116).

Këtë shkrim dëshiroj ta përfundoj me një shprehje që përmendet disa herë në Kur’an, e ajo është *“li uli’l-elbab”*, apo *“të zotët e mendjes së kthjellët”*, ose siç mund të gjendet shpesh nëpër *tefsire*: *“të mençurit”*, *“të urtët”*, ata që dinë të bëjnë përcaktimin dhe përkufizimin; ata që bëjnë shpjegimin e fesë pa e koklavitur problemin. Vetë fjala *“uli’l-elbab”*, në një kuptim paksa më të *“largët”*, me tre shkronjat e saj *bab*, ma përkujton edhe një përmasë tjetër, e ajo është fjala *“babun”* që ka kuptimin e derës. Kuptimi i derës në mënyrë figurative nënkupton të dish të depërtosh lirshëm brenda problemit, dhe të jesh i mbrojtur. Kur-

se te ne, fatkeqësisht, i tërë shpjegimi dhe interpretimi i shumë çështjeve fetare po bëhet në një përmasë të stilit të hysh nga të duash, e jo nga duhet.

Shkup, 1 Ramazan 1437 / 3 qershor 2016.



INTERVISTA PËR “SHENJA”

(Me rastin e muajit Ramazan 1439/2018)

I nderuar profesor:

1. *Jeni ndër të rrallët që jeni disi i mishëruar me nocionin e teologjisë, çfarë ju shtyu që në moshë të hershme ta studioni teologjinë dhe t’ia kushtoni një jetë asaj? Përkundër faktit që është një koncept dinamik, a mund të na shpjegoni se çfarë ju kuptoni me teologjinë?*

I.B.: Që të jetë përgjigja e plotësuar, e kam të domosdoshme t’i kthehem të kaluarës, të bëj një pasqyrim të saj, se përndryshe do të bëhemi teologë apo filozofë “të thatë”. Fusha e mësimit fetar ose e teologjisë ka qenë e mbyllur me vite të tëra në hapësirën muslimane. Për këtë dëshmon fakti se emrat e teologëve tanë, që ne shpesh i përmendim, i përkasin “lashtësisë”; por, ne nuk e kemi përjetuar gjallërimin e teologjisë në dimensionin e *kelamit*, siç ka qenë rasti mes kelamistëve tradicionalë dhe racionalë, respektivisht *esharizmit*, *maturidizmit*, *mutezilizmit*. E ç’të flasim për dyqind vitet e fundit!? Pra, bëhet fjalë për kohën kur filloi rënia e Perandorisë Osmane dhe pas shpërbërjes së saj. Ndodhën, gjatë kësaj kohe, ndryshime të mëdha me pasoja të dhimbshme mendore dhe jetësore. Mos harroni edhe varfërinë e asaj kohe, atë ekonomike, por edhe dëbimet dhe dyndjet e hatashme. Kjo është përjetuar sidomos në hapësirën intelektuale muslimane të kohës, në kohën kur Perandoria ishte bërë “i sëmuri i Bosforit”. E dhimbshme, por e vërtetë. Po jua përkujtoj një qortim filozofik-poetik të Mehmet Akif Ersojit, i cili në

pyetjen se si e sheh Perëndimin, u përgjigj me sarkazëm: “Ata i pashë duke bërë *tefsirin* e Kur’anit, e juve duke bërë politikë...”, ose do të shtoja unë “duke spiunuar”.

2. A mund ta shtjelloni pak më gjerësisht këtë?

Natyrisht. Perandoria Osmane, pra muslimanët, akuzohen se i kanë luftuar jomuslimanët, se i kanë rrënuar faltoret e tyre, se e kanë shkatërruar traditën e tyre e kësh-tu me radhë. Megjithatë, faktet e dëshmojnë të kundërtën. Kishat më të vjetra, apo toponimet edhe sot e kësaj dite e dëshmojnë këtë. Edhe në ditët e sotme në hapësirën e Tur-qisë keni ende kisha të lashta, edhe pse të rrethuara thua-jse tërësisht me popullatë muslimane. Në rastin e musli-manëve, në hapësirën e Ballkanit dhe më gjerë, kjo nuk ka ndodhur, ngaqë në këtë hapësirë për një kohë të shkurtër janë çrrënjosur objektet fetare islame; në Beograd ka mbe-tur vetëm një xhami, të cilën kur u teket vendasve e dje-gin, ndërsa diplomatët e huaj e rinovojnë. E mos të flasim për hapësirën “helene”, “bizantine” ose “ilire”, ku Islami zyrtarisht ka ekzistuar mbi 500 vjet. Po e them në mënyrë hipotetike: asaj Perandorie i është dashur pak kohë që të mos lërë asnjë gjurmë nga qytetërimet paraprake kudo ku ka sunduar, por nuk ka bërë diçka të tillë, natyrisht falë Islamit dhe teologjisë islame.

T’i kthehemi tani çështjes paraprake. Teologjia musli-mane asokohe e ka përjetuar “dënimin” më të madh, du-ke i mbyllur dyert e *ixhtihadit*, pavarësisht se ka patur mu-ndësi të zhvillohet dhe të bëhet vazhdimësi e kohës së përndritur të teologjisë muslimane të hershme. Teologjia muslimane ka qenë e burgosur brenda traditës së mbylljes dhe injorancës së kohës, respektivisht nënshtrimit herë pas here ndaj politikës. Ne sot jemi duke e parë se Kisha

perëndimore i është nënshtruar tërësisht politikës së Perëndimit; muslimanët e kanë paguar shumë shtrenjtë një gjë të tillë, andaj do të ishte mirë nëse edhe këta e mendojnë pak se çfarë çmimi do të paguajnë për diçka të tillë në këtë kohë kur është robëruar mendja dhe dashuria.

Hapësirat tona, pas këtij portretizimi, i cili është shumë i dhimbshëm dhe i diskutueshëm, janë dëshmi për diçka të tillë. Jo vetëm që “nuk” është lejuar të zhvillohet teologjia, por edhe është vonuar në të kuptuarit e paraqitjeve të fenomeneve të ndryshme të kohës, respektivisht të shenjave të kohës. Ajo i është përgjigjur me vonesë zhvillimit dhe kërkesave të kohës. Sa për hapësirën tonë mund të themi se pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane kush kanë qenë teologët tanë, ku janë ata emra? Përpos ligjëratave “të mira”, “të lezetshme”, nuk kemi patur asgjë tjetër. Më kujtohet teksa isha student i Fakultetit Teologjik në vitin e parë, e kisha detyrim studentor të shkruaj një punim seminari rreth fenomenit të fesë të shqiptarët. U përpoqa të gjeja literaturë nëpër bashkësitë tona muslimane, por nuk gjeta asgjë, përpos “kripto-katolicizmit” (laramanisë) dhe bektashizmit plot sinkretizëm!? Teologët më të mirë shqiptarë, që i kam takuar gjatë jetës sime, kanë qenë Sherif ef. Ahmeti, Hasan ef. Nahi, hafiz Bedri ef. Hamiti, por, për fat të keq, ky i fundit nuk na ka lënë asgjë “me shkrim”. Megjithatë, ka patur edhe disa dijetarë të tjerë me peshë, si: Mehmed efendiu, hafiz Mustafa efendiu, hafiz Idriz efendiu, tek i cili e kam mësuar leximin e Kur’anit dhe mësim-besimin e fesë islame (Zoti i mëshiroftë!). Por, e gjithë kjo është vetëm nga respekti, por jo diçka që mund t’i përgjigjej çështjes së teologjisë muslimane, e në kuadër të saj edhe të asaj shqiptare, e cila do të bënte përgatitjen e pranimit dhe refuzimit të fenomeneve

që paraqiten si nga shkenca, ashtu edhe nga politika. Për shembull, kemi kohën e marksizmit, komunizmit ose ateizmit tek ne, kur feja është interpretuar dhe refuzuar në mënyrë shumë primitive. Thënë shkurt, disa herë ajo më shumë është munduar ta islamizojë komunizmin, marksizmin edhe ateizmin sesa ta ketë qëndrimin e vet duke u mbështetur në shenjat e Kur'anit, i cili është përplot me mundësi të tilla. Koha mekase, medinase ose kuptimi i abrogimit brenda tekstit të Kur'anit teologjisë sonë nuk i ka interesuar shumë se nga është duke shkuar shoqëria, shpëtimi i njerëzimit. Në kohën kur “bota perëndimore” mendohej “të fuqizohej”, “stabilizohej” e të dënohej me mishërimin e nacionalizmit të fesë/kombit, teologjia jonë është munduar vetëm që t'i refuzojë të gjitha këto. E ajo nuk ka guxuar të bëjë diçka të tillë. Teologjia muslimane është dashur të jetë e vetëdijshme se përballë çfarë zullumqari gjendet, duke u mbështetur mbi një humanizëm. Pejgamberët e mëparshëm e kanë patur Nemrudin, Faronin, Karunin, ndërsa Pejgamberi ynë a.s. edhe Ebu Xhehl-in/Ebu Lehebin; ndërkaq ne, për kohën për të cilën flas, e kishim nacionalizmin, ateizmin; ja së fundmi kemi edhe shekullarizmin ose, thënë më mirë, globalizmin e pashpirt, i cili dita-ditës është duke i treguar “dhëmbët” e vet. Ne sot jetojmë në një kohë kur nuk dimë se kush është duke na sunduar dhe nga jemi duke shkuar.

Studimi i teologjisë për mua ka qenë padyshim *kader* (përcaktim) i Zotit, që disa herë më ka kënaqur e disa herë më ka bërë të jem i vrazhdë me dhimbje shpirtërore, sepse dhimbjes së kohës nuk kemi mundësi “t'i përgjigjemi”, duke filluar që nga përgjegjësia që duhet ta kemi ndaj saj, e deri te plotësimi i mësimin të saj, ashtu siç kanë bërë kel-

amistët tanë, respektivisht teologët tanë të hershëm ose imamët e shkollave juridike islame.

3. Shpjegimin e një nocioni të tillë, siç është teologjia, e rezervoni veç për fenë islame apo edhe për fetë e tjera? Apo ajo ka një karakter tërësisht universal? Si mund të ofrohet dhe të reduktohet një teori e tillë e avancuar dhe hermeneutike e fesë, për masat popullore?

I.B.: E them me keqardhje se fjalori ynë është tepër i varfër për nga terminologjia teologjike dhe filozofike; sot ne kemi fjalorë që akoma janë “të robëruar” nga mendësitë e ideologjisë, kemi terma fetarë, natyrisht shumë të lezetshëm në gjuhën tonë, si: shpirti, feja, dashuria, devotshmëria... (ngeca, se nuk di të tjera). Besoj se ne, gjithsesi, duhet ta kapërcejmë këtë siklet të varfërisë së terminologjisë fetare nëpër fjalorët tanë dhe të mos e shohim si diskriminim, por si dobësi që mund të përmirësohet, zhvillohet dhe pasurohet. Pra, vetëm përshkrim, interpretim dhe emërtim i fenomeneve të fesë, që mbështetet mbi Fjalën e Zotit.

Kohërat kanë ndryshuar, por kjo nuk nënkupton që ne duhet t’i dorëzohemi këtij ndryshimi. Pavarësisht se ne e kemi bërë këtë. Vetë teologët dhe filozofët bashkëkohorë e quajnë këtë si kohë të perëndimit, të dridhjeve, kohë të dhimbjeve dhe dështimeve plot frikë. Si teologjia, ashtu edhe filozofia, kanë qenë nënat e disiplinave shpirtërore; sot disi është e tepërt të flitet, por është e domosdoshme që këtë disiplinë ta zhvillojmë duke u mbështetur mbi traditën burimore të saj, nga e cila pasqyrohet heshtja, dashuria dhe respekti për humanumin.... sot teologët janë duke u zëvendësuar me “mekanikët”. Një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm katilët e teologjisë.

Sa u përket masave popullore, ne nuk kemi çfarë të prekim aty, sepse ata presin çështje të kryera, të “padyshimita”; çdo kohë, çdo shoqëri, çdo brez e ka patur këtë “ndasi”, që disi është edhe shpëtimtare; kryesorja është të mos i ndërrojmë ulëset, siç po ndodh sot, kur për hir të dy gishtave të ngritur (pra votës), pranojmë gjithçka, pa marrë parasysh se a ka të bëjë me thelbin e çështjes. Xhahili ose injoranti le të mbetet në vendin e tij, por edhe *alimi*, teologu le të qëndrojë në vendin e tij. Kaq mjafton.

4. *Njëra ndër çështjet më relevante me të cilën merret teologjia është edhe dogma. Dogma shpesh është një koncept i keqkuptuar dhe keqinterpretuar mbase. Çfarë është dogma sipas interpretimit teologjik?*

I.B.: Si duket kjo bisedë pak po mbingarkohet me terminologjinë fetare, por, sidoqoftë, fetë qiellore kanë terminologjitë e tyre dhe pa marrë parasysh ngjashmëritë, ato në thelb i kanë veçantitë e veta për nga brendësia, por edhe për nga ana e jashtme. Në gjuhën arabe, për shembull, Shpallja është term universal për fetë qiellore; agjërimi, lutja (namazi) dhe pejgamberët... të gjitha këto janë universale. Kjo nuk duhet të na shqetësojë, sepse na pëlqeu neve ose jo, kjo disi korrespondon me përmbajtjen e mësimin fetar. Terminologjia latine dhe greke e lashtë i kanë futur në siklet fetë qiellore, sepse vërehet profaniteti i tyre. Kjo vlen edhe për termin “dogmë”. Për shembull, ky term në Islam përdoret për t’i përshkruar Kur’anin, *Hadithin*, *akiden*, pra ai përdoret për ta shënuar parimin themelor të një feje ose të atyre bindjeve filozofike të formuluar që vendosen në themel të mësimave të dhëna. Rëndësia dhe fuqia e dogmës qëndron në atë se besimtari, respektivisht ithtari, nuk guxon që atë ta vërë në dyshim.

Megjithatë, dogma, me gjasë, mund edhe të ndryshojë, të përshtatet, të shfuqizohet ose të plotësohet, por e vërteta e fesë nuk ndryshon me asnjë çmim. Ajo mbetet përgjithmonë, ngaqë Zoti e shpall dhe e formulon ashtu që ajo, ndonëse absolutisht metafizike, nuk është e verbër për historinë dhe kohën, për nevojat njerëzore dhe proceset natyrore, por është njëkohësisht e vulosur në çdo zemër të gjallë dhe në çdo detaj të “fletëve” të natyrës dhe gjithësisë. Pra, e vërteta e fesë i ofrohet çdo kohe dhe hapësire, por që me fuqinë e *ixhtihadit* duhet të njihet nga çdo kohë, të pranohet dhe të regjistrohet në çastin e dhënë kohor, duke e sjellë në harmoni të plotë me përmbajtjen e tij leximin tonë të këtushëm të shenjave të kohës që na i përcaktojnë dhe të cilat i jetojmë.

Duhet pranuar se te muslimanët vërehet një neveri, me të drejtë ose pa të drejtë, ndaj këtij termi, sepse është krijuar një botëkuptim se ky term e dëmton Islamin, në kuptimin se besimi (*imani*) është fjala e gjallë për Zotin, ndërsa dogma është mendim i trashëguar për besimin; besimi është përvojë personale, ndërsa dogma është bindje e mësuar; besimi është gjendje e natyrshme e shpirtit, ndërsa dogma është gjendje artificiale e mendjes; besimi e ndriçon shpirtin, ndërsa dogma e errëson mendjen; besimi është moral i natyrshëm, ndërsa dogma është dogmatikë artificiale; besimi fshihet në zemër, ndërsa dogma mbyllet në mendje. Besimi është liri e shpirtit, ndërsa dogma është robëri e mendjes. Mësimet e fesë janë nën mbikëqyrjen e Shpalljes, ato rriten, zhvillohen, afrohen, largohen, por e ndjekin njeriun në mënyrë konstante, duke i ofruar shpëtim, udhëzim, respektivisht humanizim me respektimin edhe të tjetrit.

5. *Njeriu bashkëkohor sot ballafaqohet mbase me problemet më absurde dhe situatat më të rënda ekzistenciale. Në këtë kontekst, si mund ta ndihmojë atë teologjia?*

I.B.: Me siguri këtu e keni fjalën për atë se si mund t'i ndihmojë njeriut feja, sepse feja i kapërcen përmasat e teologjisë; feja është *din* i Zotit; feja është Shpallja e Zotit, kurse teologjia, siç u tha edhe më lart, është një disiplinë që mbështetet mbi racion, mbi traditën, mbi kulturën, mbi përpjekjen shpirtërore dhe intelektuale për ta prezantuar mundësinë për kuptimin e bukurisë së fesë, *dinit*. Kjo është disi, do të thosha, një qytetërim, p.sh., të keni *alimë*, dijetarë që për çdo ditë ndriçohen me nurin e Allahut, respektivisht *dinit* të Tij, duke e prezantuar bukurinë e Fjalës së Zotit; duke ia lehtësuar mendjes atë barrë që e ka pasur.

Qëllimi i fesë ka qenë dhe mbetet shpëtimi dhe udhëzimi në rrugën e Zotit. Faktikisht, njeriu me lirinë e tij e ka dëshmuar pranimin e Fjalës së Zotit. Nuk duhet harruar rasti i thënies "*Kalu bela!*", por edhe "*zalumen xhehula*", pra ai që pohoi se e pranon Zotin si Krijues, u bë zullumqar injorant, me çka Zoti e tregoi se njeriu pranoi diçka që e veçon nga gjithësia dhe ky u bë *kaderi* i njeriut. Ai, me këtë, "e humbi" lirinë, sepse pranoi të jetë ose jobesimtar ose besimtar, me çka dëshmoi se Zoti është Ai që kontrollon gjithçka dhe Fjala e Zotit në mënyrë konstante e ka prezantuar këtë: se ju jeni ata që do ta prezantoni mono-teizmin e Zotit, do ta dëshmoni se Zoti është Një, Krijues i gjithësisë, Zotërues i gjithësisë, me atë që: "ata që besojnë kanë shpëtuar; ata që nuk besojnë janë të humbur".

Fenomeni i fesë, respektivisht Fjala e Zotit, siç është Kur'ani, na mundëson t'i studiojmë shenjat e kohës dhe ta kuptojmë se ku gjendemi. Kam një pyetje konkrete: a jemi ne besimtarë, a e presim shpëtimin nga Zoti?! A jeni duke

parë se çfarë është duke ndodhur me njeriun e sotëm? Është shkuar aq larg, saqë njeriu edhe besimin (*hasha*) është duke e përdorur për ta lejuar zullumin, padrejtësinë; lloji i njeriut të sotëm nuk besoj se ka ndodhur më parë: ta shesë veten, ta shesë mendjen, ta shesë arsyen, ta shesë unin për hiçgjë. Në praninë e njeriut sot janë duke ndodhur gjërat më të rrezikshme: për çdo ditë vrasje, zullum tokash, shkatërrime vendbanimesh, amoralitet, vjedhje, inskenime të papara, gjithë kjo me të vetmin qëllim që të dënohet me “lirinë” e dënimit. Zoti ka thënë: mos lejoni që zullumqarët t’ju sundojnë; mos i përkrahni zullumqarët; mos i përkrahni interesaxhinjtë; mos e shitni dinin, imanin, namuzin për para – përndryshe do të ndëshkoheni. Besoj se kemi literaturë të bollshme për ta parë gjendjen e sotme të njeriut. Njeriut, nga të gjitha anët, është duke i ardhur shkatërrimi nga dora e vet. Është e vështirë, por e vërtetë! Sprovat janë të mëdha, andaj besoj se është koha që t’i kthehemi asaj lirie jo të lirë që t’i besojmë Zotit, që ta shpëtojmë veten dhe tokën.

6. *Fundi i shek. XX dhe fillimi i shek. XXI janë tejshkuar me nevojën dhe publicitetin e lartë për një dialog ndërfaqetarak, siç kujtojmë edhe iniciativën e Hans Kungut, për një etikë universale apo parime të përbashkëta për një etikë të tillë. Ju jeni ndër të paktët, mbase i vetmi, që keni shkruar dhe keni kontribuuar aktivisht në këtë çështje. Kur është fjala tek dialogu, a kemi nevojë për një dialog të tillë dhe ky dialog a mbetet vetëm në stadin politik apo në stadin e nevojës për krijimin e një “religjioni” të ri universal?*

I.B.: Nëse dialogu ndërfaqetarak kërkon krijimin e një “religjioni” të ri, atëherë nuk është fare dialog. Sa i përket dialogut, Islami e ka patur dhe e ka parim nga vetë filli-

met e tij diçka të tillë. Ka *ajete* që u drejtohen besimtarëve dhe *Ehl-i Kitab* (Ithtarëve të Librit) që “të bashkohen me një fjalë”, të cilin për fat të keq Krishterimi e ka “inicuar” me Koncilin e mbajtur nga gjysma e dytë e shekullit XX. Sa u përket çifutëve, ata sinqerisht janë “rehat”, sepse për ta edhe Krishterimi edhe Islami janë fe “të vonuara”.

Dialogu ndërfeetar jo që është i nevojshëm, por është edhe detyrim fetar, pa marrë parasysh vonesën e asaj se a duhet apo jo një dialog i tillë. Në rend të parë ai është i domosdoshëm për arsye se fetë qiellore e kanë një thirrje universale – shpëtimin dhe udhëzimin, si shpëtim dhe lartësim shpirtëror, kthim në burimin e krijimit. Njeriu nuk është vetëm materie, nuk është thjesht prodhim biologjik, por është krijesa më e lartë me përgjegjësinë më të lartë; ai është i cili ka përgjegjësi për pranimin e Fjalës së Zotit dhe duhet të ketë mirëkuptim dhe pranim në formën më të mirë, e jo dënim. Islami e ndalon dhunën dhe nuk e pranon imanin/besimin që vjen nga dhuna; vetëm ata që janë të lirë dhe të vetëdijshëm e kanë për detyrim pranimin/refuzimin.

Ne, muslimanët e Ballkanit, këtë e kemi përjetuar dhe për ne gjithmonë ka qenë një shenjë frike, nga e cila nuk jemi çliruar akoma. Për diçka të tillë natyrisht se është e domosdoshme të mendohet mënyra dhe metodologjia e dialogut ndërfeetar. Por, që të jetë i tillë, dialogu ndërfeetar e ka të domosdoshme të mbështetet mbi mësimet e fesë. Përpos esencës së dialogut ndërfeetar, ai duhet të kalojë nëpër faza të tjera, duke e pastruar dhe mbrojtur monoteizmin fetar, e jo duke e ftuar njëri-tjetrin në largimin e pjesëve të Fjalës së Zotit, respektivisht *ajeteve* të Zotit.

Çështja themelore apo pyetja më e rëndësishme është se ku qëndron problemi i dialogut ndërfeetar? Apo, në emër të kujt është duke u zhvilluar dialogu ndërfeetar sot?

Padrejtësitë dhe luftërat që jemi duke i parë dhe përgatitjet për to dëshmojnë se dialogu ndërfeetar është duke iu shërbyer sistemeve të ndryshme, me çka mendoj në korporatat e fuqishme transnacionale. Në vend që të jetë në shërbim të Fjalës së Zotit, dialogu ndërfeetar është bërë mjet për keqpërdorimin e asaj Fjale. Harrohen 10 urdhrat e Zotit, që janë universale si për Judaizmin, ashtu edhe për Krishterimin dhe Islamin. Për fat të keq, kjo është frika më e madhe dhe rreziku më i madh. Në kohën kur aq shumë flitet për dialogun ndërfeetar dhe të ndodhin këto që ndodhin sot, a nuk e vë kjo në dyshim vetë këtë nismë?

Sa i përket thirrjes së Hans Kungut për një etikë universale, kjo tingëllon shumë mirë dhe është thirrje e mirë, por nuk duhet harruar se ne kemi personalitete të shquara të kulturës islame dhe joislame që ftojnë për mirëkuptim, për një etikë të lartë, si Sejjid Kutb, i cili e luftoi prapambetjen tradicionale të besimtarëve muslimanë, ose Ivan Supekun me humanizmin universal, duke i treguar botës se shkencat e sotme paraqet rrezik të madh. Pra, pyetja thelbësore është se a ka mundësi të bëhet pa Zot? Që etika, humanizmi të jenë në shërbim të njeriut, kjo është e mundur vetëm nëse i nënshtrohen dhe i besojnë humanizmit. Por, feja islame e ka edhe dimensionin tjetër, i cili është drejtësia. Kur bëhet fjalë për drejtësinë, nuk është me rëndësi a je besimtar apo jo, por a ke drejtësi apo jo. Këtë etikë, etikën globale, humanizmin universal, e bën të suksesshëm drejtësia universale. Pa drejtësi nuk ka as humanizëm, as etikë.

7. Deri më sot nuk kemi patur ndonjë studim sociologjik për religjiozitetin e shqiptarëve, por bazuar në përvojën tuaj të deritanishme, sa janë shqiptarët popull religjioz?

I.B.: Edhe shqiptarët, si të tjerët, së pari janë njerëz e pastaj shqiptarë. Meqenëse janë njerëz, edhe ata e kanë

përjetuar dramën që e ka përjetuar edhe njeriu i parë, i cili nuk ka lejuar të jetojë pa besim. Unë mendoj se shqiptarët janë një komb që e ka përjetuar dramën e Hajj ibn Jakdhanit, i cili në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar ta gjejë Zotin dhe nuk ka lejuar që të dënohet me politeizmat, respektivisht të mbetet pa një monoteizëm të pastër. Historia flet me gjuhë të ndryshme, por shpeshherë mendja është duke e akuzuar historinë me tradhti, respektivisht me tradhtinë që i prezantohet fesë. Ne jemi ndër kombet e rralla që i kanë përqaftuar librat e shenjtë. Pas përvojës së Krishterimit, shqiptari e pranoi monoteizmin e Kur'anit. Por, është e vërtetë se studime të mirëfillta në këtë drejtim nuk kemi, respektivisht nuk kemi një teologji të regjistruar për çështjen e fesë të shqiptarët. Edhe kur filloi historia e fesë, ajo filloi nga njerëz që u ka pëlqyer mashtrimi; ndërsa mashtrimi më i madh u bë nëpërmjet figurës së Skënderbeut. Aurel Plasari ka të drejtë kur thotë se Gjergj Kastrioti u shndërrua në një mit me të dhëna që shpeshherë i kapërcejnë faktet historike. Nënçmimi më i madh ndaj arsyes së shëndoshë të njeriut tonë bëhet pikërisht këtu. E them me keqardhje, por këta që mundohen ta prezantojnë fenë nëpërmjet figurave të tilla, kanë bërë që kjo tablo të na paraqesë shumë qesharakë para mendjes së ndritur, sepse është prezantuar një njeri i cili në brendësi ka diçka tjetër, ndërsa jashtë ka diçka krejtësisht tjetër. Edhe Skënderbeu “çmendet” kur “i sheh” të gjitha prezantimet e tij. Ndërkaq çështja është e thjeshtë: ai e ka përdorur metodën e hipokrizisë – nga Perandoria Osmane ka kërkuar pushtet e pasuri, ndërsa kur i është rrezikuar kjo, ka vendosur ta tradhtojë atë. Pastaj, i tradhtoi edhe ata nga të cilët kërkonte derman dhe me këtë u mitizua dhe, me sa duket, pikërisht ky tipar është shumë preze-

nt sot tek ata që e zhvillojnë këtë debat, duke harruar shumëçka: pse shqiptarët të mbeten kështu siç janë, më të vonuarit në histori, më “të mençurit”, “më trimat”, më të humburit, më të urryerit, më të papranuarit, më të nënçmuarit.

8. Shqiptarët shquhen për tolerancën fetare. Kjo tolerancë shpesh është kritikuar dhe është interpretuar si rezultat i indiferencës religjioze që kanë, në përgjithësi, shqiptarët si komb? Si e interpretoni tolerancën fetare tek shqiptarët?

I.B.: Islami ka qenë dhe është fe që thotë: “*lekum dinukum ve lije din*” (juve feja juaj, mua feja ime). Kjo kërkon një interpretim më të thellë, por në mënyrë sipërfaqësore do të përpiqem t’i shpreh disa bindje që mbështeten mbi interpretimet tek ne. Për një popull të mençur nuk ka nënçmim më të madh se kur i thuhet: “Ju nuk i jepni shumë rëndësi fesë!”, mendoj për ne shqiptarët. Te shqiptarët nuk ka patur problem se cilat festa festohen. Por, diçka e tillë nuk ka ndodhur as te popujt e Afrikës, e lëre më te një popull siç është ai shqiptar dhe kjo nuk është çështje feje, por kulture, tolerance. Një populli që shquhet me inteligjencë; një populli që njihet për vuajtje për arsye se ka qenë i dhënë pas termit “drejtësi” dhe “respekt”, t’i përshkruhen gjëra të tilla, është nënçmim i madh, por edhe tradhti. E shihni se ky nënçmim, në mënyrë të vazhdueshme, i bëhet këtij populli në dimensionin metafizik, pra nënçmim metafizik. Pyetja kryesore këtu është se pse pikërisht kjo të na ndodhë neve, muslimanëve shqiptarë? Siç duket, në këtë mënyrë dikush mundohet të na mashtrojë dhe ta fusë brenda nesh sindromën më të rrezikshme, si mes popujve sllavisht-folës, edhe pse te ata është dëshmuar se kush janë dhe si janë. Ndërkaq te ne është dëshmuar diçka tjetër: ne kemi qenë dhe do të jemi tolerantë

ndaj feve qiellore, por nuk do të lejojmë të na përshkruajmë diçka që nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston, pra se ne nuk çajmë kokë për fenë. Paramendoni t'i thuhet ithtarëve të një feje tjetër se nuk e kanë shumë dert për fenë e tyre, çfarë do të ndodhte?!? Ata kanë shkuar aq larg, saqë kanë pranuar një udhëheqës shpirtëror të jetë me origjinë tjetër (si Janullatosi), pa marrë parasysh se nuk e njeh gjuhën tonë, edhe pse të jem i singertë, do të dëshiroja të kemi prijës muslimanë si ai. Për mua nuk ka prijës të mençur shpirtëror në hapësirën e Ballkanit si ai. Po të kishte ndodhur diçka e tillë për muslimanët, pra të ishte sjellë një prijës, një "mullah" nga Saudia ose Irani, çfarë do të ndodhte?!? Tërë kapaciteti "intelektual" dhe politbyroja e masmediave shqiptare do të tërboheshin.

Mbi këtë tradhti, mashtrim, plot "bukuri" është duke u ndërtuar politika shqiptare, e cila në çdo mënyrë është duke i ndihmuar kësaj sindrome, që t'i shkaktojë dëm të ardhmes brenda shqiptarëve. Ajo është duke e nënçmuar deri në thelb urtësinë e muslimanëve shqiptarë, drejtësinë e tyre; te ne ndodhë që programet dhe gazetarët popullarizohen vetëm sepse e fyejnë Islamin dhe muslimanët. Politika shqiptare është duke iu bërë diskriminim shpirtëror dhe material muslimanëve shqiptarë. Kjo vjen në shprehje me nënçmimin që ia bën kur trungun shqiptar e prezanton në mënyrë politike, me pronat që kurrë nuk ia ka kthyer, si dhe me diskriminim nëpër shkolla, ndërsa institucionet fetare heshtin. Prapë po e them: gabim i madh dhe nënçmim i madh është që politika të mbështetet mbi frazën se "muslimanët shqiptarë nuk i kushtojnë rëndësi fesë". Çfarë mendoni me këtë? Asgjë në botë nuk ekziston pa i kushtuar rëndësi, gjithçka ka rëndësinë e vet: shikimi, fjala, dora, trupi, të gjitha e kanë rëndësinë e tyre, ndërsa

ju e veçoni duke u përpjekur si ta tregoni si paradigmë të nevojshme për botën moderne. Kësaj i thonë pallavrë shqiptare ose, nëse doni, tolerancë shqiptare, madje edhe kur u dhuroni territor të tjerëve. Nuk i zë gjumi as sllovenët, as kroatët, as grekët e as serbët për këtë tezë shumë të rëndësishme intelektuale shqiptare, për tolerancën shqiptare të këtij lloji. Kjo nuk është asgjë, përpos keqpërdorim dhe thirrje për paraqitje dhe përgatitje për një ardhmëri të rrezikshme brendashqiptare në kontekstin fetar. A dëshironi ta dini se si flet Zoti për diçka të tillë? Ai edhe para Islamit edhe në Islam ka thënë përmes Kuranit: Do t'ju dënoj, përçmoj, me përçmime të papara për atë që e keqpërdorni fenomenin e fesë. Nuk e di, por është një e vërtetë e dhimbshme se diçka të tillë ne tashmë jemi duke e përjetuar. Edhe një herë po e përsëris se ne jemi të vonuar gjithandej: në politikë, në kulturë dhe në fe. E shihni se nuk është çështja nëse muslimanët janë tolerantë. Po, ata janë tolerantë, sepse e dinë se feja e tyre ua ndalon dhunën, ua ndalon të mendojnë keq, ua ndalon kripto-besimin, pa marrë parasysh nëse tjetri beson ose nuk beson. Kur'ani thotë: Nëse besoni në mënyrë të sinqertë dhe të drejtë, ju pret shpëtimi. Nëse ne dëshirojmë të jemi ashtu siç duhet të jemi, e kemi të domosdoshme ta kemi fushën e heshtjes me mësim dhe urtësi. Atëherë mund të jemi diçka, e jo duke u mburrë me kriptomizma të ndryshme.

9. Në kuadër të kritikës suaj shoqërore, theksin e vendosni në institucionet të cilat janë/duhet të jenë kompetente për organizimin e komunitetit musliman në Maqedoni. Sipas jush, çfarë nuk shkon me këto institucione, çfarë duhet të ruhet e çfarë të ndryshohet në to?

I.B: Institucionet fetare, shpeshherë, ia mbyllin dyert besimit të drejtë, respektivisht ia ndalojnë hovin. Por, me-

gjithatë, ne duhet ta konsiderojmë këtë çështje me konsiderata të veçanta. Nuk është e kotë se pas ndryshimeve të mëdha dhe luftërave të këtij qindvjeçari, çdo pushtet, çdo politikë, ka kërkuar që ta ketë nën kontroll institucionin e fesë. Habia më e madhe, edhe për botën komuniste, ka qenë vendimi i Jugosllavisë komuniste kur ka lejuar, respektivisht ka kërkuar, që të themelohet institucioni fetar. Për dikë ky institucion e ka luajtur rolin e vet të duhur dhe është munduar të ketë një autonomi, por për komunitetin musliman kjo nuk ka vlerë. Dokumentet e shumta arkivore dëshmojnë se udhëheqësit e këtyre komuniteteve kanë qenë nën mbikëqyrje dhe kontroll shtetëror. Ka patur raste që disa nga bashkëpunëtorët e këtyre institucioneve të jenë me përgjegjësi të larta në shërbimet shtetërore. Siç themi ne, dihet botërisht se disa prej këtyre hoxhallarëve e kanë patur “shpinën e fortë” në aparatën shtetëror dhe atyre nuk kanë guxuar t’u bëjnë asgjë, madje edhe u kanë shërbyer. E të mos flas për çmendurinë e tyre se si kanë qenë. Ata, disi, kanë bërë edhe gara se kush është “më i fortë”. Për shembull, në qarqet e të punësuarve të Bashkësisë Islame të Maqedonisë është ditur botërisht se Kryetari, Myftiu dhe Sekretari kanë bërë gara se kush mund t’ia nxjerrë dikujt më shpejt pasaportën. Duket qesharake, por është më tepër për të qarë. Për fat të keq, kjo hije e zyrtë, plot trishtim dhe frikë, akoma ekziston mbi kokat “e zbrazëta” të teologëve të zbrazët, sepse ata vetëm i kanë ndryshuar këllëfët: asokohe në mënyrë komuniste iu nënshtruan sistemit, ndërsa sot në mënyrë demokratike i nënshtrohen politikës. Natyrisht, çdo respekt për teologët e mirë me besim dhe kulturë.

Institucioni i fesë duhet ta ketë përgjegjësinë më të madhe sipas vetë emrit dhe ta zhvillojë një teologji të gja-

llë, të rrethuar me disiplinat tradicionale dhe racionale, duke filluar prej interpretimit të Fjalës së Shenjtë, shkencës së *Kelamit* plot urtësi dhe thellësi teologjike e filozofike, e deri te prezantimi i shenjave të kohës që muslimanët t'i bëjnë ashtu siç duhet, respektivisht të mos lejojnë të jenë në shërbim jashtë Librit të Shenjtë. Ky institucion është i detyruar të merret me teologjinë kontekstuale, që të ketë një pavarësi fetare, duke i parë problemet e brendshme të kohës, respektivisht të rrethit ku jeton një besimtar, e deri te teologjia e qytetit dhe qytetërimit. Për një gjë të tillë kërkohet seriozitet dhe aftësi intelektuale, kulturore e, sidomos, dashuri ndaj Fjalës së Zotit dhe një edukatë të veçantë në formën pejgamberiane. Por, këtë nuk kanë mundësi ta bëjnë ata që ulërijnë dhe gëzohen me kotësitë e tyre në emër të muslimanëve. Ka shumë dëshmitarë që e shohin një gjë të tillë: bashkësitë tona fetare islame janë të rrethuara me thashetheme, me hakmarrje, me nënçmime dhe ofendime, aty nuk ekziston fjalori i teologjisë, aty ekziston kabadaillëku me armë, mashtrimi dhe edepsëzllëku i vendit dhe kohës. Një pyetje e shpeshtë, që parashtrohet nga besimtarët e Zotit, është se si është e mundur të ndodhë diçka e tillë te njerëzit “e fesë”? Po, ndodhë, sepse ne “i ndihmojmë” një gjëje të tillë: dikush i lutet Zotit të mos ia marrë shpirtin kryetarit, dikush i lutet Zotit të mos ua marrë “mishin dhe qebapët” nëpër restorante, dikush i lutet Zotit që të mos e lërë pas nga çallëmi kur shëtisin në grup, por të gjithë ata e harrojnë Fjalën e Zotit në Kur’an, kur thotë: “U bënë lanet *Bijtë e Israilit* (lexo: bijtë e BFI-së), pse heshtën para së vërtetës”. Një numër nga këta e kuptojnë përgjegjësinë e tyre vetëm para vdekjes, sepse ngarkesa që kanë patur nga “katundarllëku” mezi u kalon.

Institucioni i komunitetit musliman ka qenë dhe mbetet i detyruar në mënyrë institucionale si *amanet* i muslimanëve, siç është ruajtja dhe mbrojtja e pronave, vakëfit. Për fat të keq, ata jo vetëm që nuk e kanë mbrojtur, por e kanë lejuar me pretekstin se politika ua ka uzurpuar, ua ka vjedhur ose, siç kemi dëshirë shpesh ta themi, “shkau na i ka marrë pronat”. Në krahasim me këtë shkatërrimi i bërë nga ata është shumë më i madh seç ua ka bërë shkau. Sot muslimanët nuk e dinë se ku dhe si është duke shkuar vakëfi. Kjo është një temë shumë prekëse dhe e frikshme. Nuk e di se si do t’u përgjigjemi besimtarëve për këtë dhe si do të vdesim.

Institucioni fetar musliman është i thirrur ta mbrojë Fjalën e Zotit, por për fat të keq këtë nuk është duke e bërë. Ai shumë më tepër është duke e ngarkuar dhe zymtuar fytyrën e fesë sesa që e mbron atë nga politika e vendit, sepse politikat e fyejnë pandërprerë Islamin, përgatisin armiqësi brenda muslimanëve, përgatisin armiqësi edhe brenda një etnikumi, në këtë rast atij shqiptar, për arsye se një fe në mënyrë zyrtare “e përkrahin” dhe e “llastojnë”, kurse tjetrës pandërprerë ia thyejnë turinjtë. Shikojini se si flasin për fenë kryeministrat shqiptarë, e të mos flas për vokabularin e ministrave të vegjël! Nuk është e jona të flasim për paraqitjen e tyre të bajate dhe nënçmuese, sepse flasin me diktatin e të tjerëve. Një kohë u thotë Serbia “flitni kështu”, pastaj Turqia, Amerika, Kina, Rusia ose Greqia u thonë “flitni kështu” dhe ata flasin kështu. Nëse sot një shtet u thotë se nuk ekziston ky fenomen, ata në çast e harrojnë se çka kanë folur. Ndërsa komuniteti fetar hesht ndaj këtyre shablloneve politike, që janë farë sherri për ardhmërinë. Ne e patëm rastin kur një prift shqiptar i quajti muslimanët shqiptarë “qej”. Çfarë ndo-

dhi?! Asgjë! Institucioni fetar ka punë “të rëndësishme”. Paramendoni se me çfarë soji ka punë! Ai e ka për detyrim ta mbrojë Islamit nga zullumqarët e fëlliqur, që nuk dinë asgjë, nuk u intereson as dini, as imani e as namuzi, por mundohen të pyesin ose të organizojnë tubime ku, përpos ulërimes, nuk mund të mësoni asgjë.

Institucioni fetar e ka për detyrë të merret me një teologji të përkryer, e cila do t'i ndihmojë bashkëjetesës, pa marrë parasysh multikonfesionalitetin e vendit. Ai do ta krijojë teologjinë ekumenike, ku do të mundohet të përgatisë dhe të aftësojë njerëz se në ç'mënyrë ne duhet të flasim për fenë, për besimet, sepse çdo komunitet që mbyllet në vete, e krijon fjalorin e urrejtjes për tjetrin. Ne këtë e përjetuam si qytetarë të një shteti si Jugosllavia, kur pamë se si flitet nëpër tempujt fetarë. Kjo nuk guxon të ndodhë, sepse nëse një fe fton në urrejtje, nëse një fe fton në katillëk, mendoj në fetë qiellore me Libra të shenjtë, ajo e ndërpret komunikimin, kontaktin me Fjalën e Zotit, ajo bëhet dexhall, “Antikrisht”. E ç'të flasim për të ardhmen, për të cilën shkencëtarët e shkencave ekzakte flasin me plot frikë dhe rrezik? Po ashtu, edhe shkencat shoqërore dëshmojnë në mënyrë bindëse se “çmenduria” është bërë pjesë e jetës sonë. Kujtoni vetëm titujt e librave të kohës si “Shkatërrimi i Perëndimit”, “Shkatërrimi i Lindjes”, “1 minutë para orës 12”, e gjithë kjo vetëm me qëllim të uzurpimit dhe mbajtjes së pushtetit. Kjo na detyron që të mendojmë se si dhe çfarë teologjie do të zhvillojmë, faktikisht na detyron për zhvillimin e një teologjie të “vetëmbrojtjes”, e cila do të na mbrojë nga rreziket e shekullit ose nga shenjat “e rrezikshme” të kohës.

Institucioni i fesë është i thirrur të mendojë se nga është duke shkuar dhe si është duke u zhvilluar teologjia

muslimane, respektivisht teologjia muslimane shqiptare. Siç përmenda më sipër, por edhe në raste të tjera, hapësira jonë është e zbrazët nga emra të njohur, ngaqë ne nuk kemi të tillë në fushën e teologjisë, përpos një plejade gjatë një periudhe 20-25 vjeçare para komunizmit në Shqipëri, të cilën – për fat të keq – institucionet fetare në Maqedoni e Kosovë as që e kanë përmendur. Pas kësaj nuk kemi më. Ne e kemi mbushur hapësirën intelektuale teologjike me kotësi të tepërta, që vetëm e lodhin mendjen e besimtarit; teologjinë e kemi shndërruar në telelogji dhe anasjelltas. Teologjia muslimane ka nevojë të prezantohet dhe e ka detyrim që fenë t’ua përcjellë të tjerëve, të mos mbyllet vetëm brenda historisë dhe kombit; ajo është e detyruar që ta prezantojë Fjalën e Zotit e të mos e mbajë vetëm për një etnikum, t’u ofrojë shpëtimin atyre që janë “të humbur”, madje deri te femohuesit, sepse ky është detyrimi i fesë. Qëllimi i fesë ka qenë dhe mbetet ky. Pejgamberi a.s., është dërguar mëshirë për tërë botën. Edhe dimensionin intelektual, edhe dimensionin më i gjerë, është i mbyllur, i burgosur brenda një injorance plot zhurmë dhe bajate. Këtë nuk guxon ta shpërfillë komuniteti musliman. Evropa është e hapur dhe pret intelektualë fetarë që do të merren me fenomenet e ndryshme që janë duke u paraqitur si nga “fetarët” ashtu edhe nga “jofetarët”, e sidomos nga ata që janë duke e keqpërdorur atë. Por, kjo nuk bëhet vetëm me çallma dhe çallëm.

Feja nuk ka ardhur t’i shërbejë politikës dhe demonëve të politikës, por ka ardhur pikërisht që të mos lejojë diçka të tillë, t’i ftojë në pendim dhe korrigjim, t’i ftojë besimtarët të mos mashtrohen nga fjalët e mira dhe parullat e bukura që na prezantohen nga ekranet. Sa mirë ka thënë Aleksandër Solzhenicin: “Gjithçka që ka ndodhur dhe që

është duke ndodhur (mendon në katastrofat dhe rreziqet), ka ndodhur sepse njerëzit janë duke e harruar Zotin". Kur'ani thotë: "... ata të cilët ia kthejnë shpinën Fjalës së Zotit, do të kenë një jetë, por një jetë plot frikë, shqetësim..."

10. Jemi në frymën e muajit Ramazan. Agjërimin si praktikë e stërroitjes shpirtërore e gjejmë në disa kultura dhe qytetërimi relevante. Por, muaji Ramazan, në kulturën e muslimanëve, ndërlihet me ngjarje shumë të rëndësishme, që e kuptimësojnë fuqishëm botëkuptimin religjioz. Çfarë, në të vërtetë, është agjërimi dhe cila është simbolika e muajit Ramazan?

I.B.: Fjala është për njeriun, si krijesa më e lartë. Çka ka mundësi ta zbukurojë këtë krijesë dhe ta lartësojë më mirë e më bukur se muaji pa ngrënie, pa pije, larg bashkëshortes(it)... tërë "hallalli" bëhet për një kohë "haram". Krijuesi e zbukuron njeriun, duke ia dhuruar këtë muaj të një metafizike, të cilin e ka përjetuar shpirti edenian, dhe e ka zbukuruar dhe edukuar në këtë formë. Kjo formë e agjërimin ia mundëson njeriut ta shohë fillimin dhe fundin e vet, ta përjetojë fuqinë e Zotit me përsëritjen e Shpalljes, që vetëm e lartëson këtë krijesë që ka flijuar shumë me pranimin e amanetit të Zotit. Ky muaj e ka në vete zërin hyjnor, që vetëm xhennetlinjtë kanë mundësi ta kuptojnë. Sa domethënie të lartë ka uria në emër të Zotit! E kupton njeriun me këtë, të bën më të afërt me atë si ti, si njeri; të detyron t'ia kuptosh dhimbjen, mundimin, shqetësimin, frikën; ta kuptosh se çfarë do të thotë t'i bëhesh rob Zotit, në një formë që është shumë "e lehtë" – të agjërosh në emër të Zotit, ta dëshmosh Njëshmërinë e Tij, Madhërinë e Tij, ta kuptosh se Ai është i Përherëshëm, i Pavdekshëm, i Cili dëgjon dhe të ofron mundësi të përmirësohesh. Koha e këtij muaji është koha kur në mënyrë konstante zbresin

shkronjat, fjalët e Zotit, duke u përforcuar memorizimi dhe duke iu afruar Zotit. Kjo është dasma e xhennetit, kjo është nata e parë... Kjo formë e ibadetit u është dhënë dhuratë *Ehl-i Kitabit*, që të bashkohen dhe ta luftojnë demonin, dreqin e madh të kohës dhe botës.

Në këtë muaj ka zbritur Kur'ani, andaj është mirë që muslimanët ta kalojnë kohën duke lexuar Kur'an, duke e dëgjuar leximin e Kur'anit, duke e përjetuar Kur'anin dhe duke menduar për përgjegjësitë që Zoti ua ka dhënë dhe pret se në ç'mënyrë ne do t'i plotësojmë ato përgjegjësi. Ky muaj është edhe një shenjë prej shenjave që fton në përjetimin e fazave të ndryshme që i kanë përjetuar mu'minët e parë të njëzetetrevjetëshit të misionit të Pejgamberit a.s. Paramendoni se pas fjalës "Lexo!" Pejgamberi përjeton një heshtje të gjatë nga qielli. Ne këtë heshtje e harrojmë. Prandaj besoj se është koha të mendojmë pak më shumë për atë periudhë të heshtjes. Por, kjo bëhet vetëm me një urtësi të lartë dhe besim të thellë, pa "u mashtruar" nga Kur'ani i shkronjave dhe letrës, por besimtarët duhet të mendojnë mbi këtë dimension, të përgatiten që ta përjetojnë zbritjen e Kur'anit, fuqinë e Kur'anit në zemër dhe në mendje. Nuk thuhet kot: "Kur e dëgjoni leximin Kur'anit, heshtni", dëgjojeni me *terbije*, me pastërti, mos bëni zhurmë, mos u bëni 'të mençur', siç është bërë traditë nëpër xhamitë tona, ku pikërisht kur lexohet Kur'ani bëhet zhurmë, thuajse janë edukuar me jo-Kur'an. Një gjë të tillë e kanë praktikuar mushrikët e Mekes, të cilët kanë thënë: "Kur të lexohet Kur'ani, mbyllni veshët dhe bëni zhurmë".

Ky muaj është me rëndësi të veçantë edhe nëse, eventualisht, e lexojmë *ajetin* e nënës së Isait a.s., Merjemes, kur Beni Israilët dhe të tjerët mundohen ta akuzojnë për papastërti dhe pandershmëri, ndërsa ajo nënë e madhe, e dë-

lirë, hesht dhe nuk flet. Ajo heshtje ka qenë dëshmi se vjen një krijesë e veçantë në botë, Isai a.s.. Sot, për fat të keq, ithtarët e tij nuk kanë kohë të urtësohen, të mençurohen, ta përjetojnë dhimbjen dhe vetminë që e ka përjetuar Pejgamberi i tyre dhe ummeti i tij. Kur i lexojmë këto *ajete* për këtë nënë të lartësuar, neve na dridhet zemra, kënaqemi. Këtë kënaqësi duhet “ta përjetoni” si në akuzën që i është bërë asaj/neve, që ashtu ta shihni, përjetoni Fjalën e Zotit, pejgamberin e Zotit, respektivisht pejgamberët e Zotit.

Ky muaj është edhe muaji i thirrjes drejtuar besimtarëve që të mendojnë se si ka mundësi të komunikojnë me Zotin, pa marrë parasysh vështirësitë që i kanë dhe ngarkimet që janë duke ua bërë edhe interpretuesit e fesë. A nuk jeni duke e parë se vaizët tanë “harrojnë” se kjo fe nuk ka nevojë për interpretimet tona që mbështeten mbi atë se sa “të mençur” dhe elokuentë jemi ne në ligjërimet tona, që dita-ditës janë duke e mbytur heshtjen e Kur’anit. Prandaj ky muaj është një thirrje që iu drejtohet zemrave të njerëzve, duke i edukuar dhe “dënuar” me një dënim të veçantë, me të vetmin qëllim që t’i lartësojë shpirtërisht dhe t’i bëjë ta lartësojnë Fjalën e Zotit si robër të Tij. Këtë mënyrë të agjërimit të Fjalës së Zotit kanë mundësi ta kuptojnë robërit e devotshëm, të cilët i përjetojnë kurthet e rrezikshme që iu bëhen besimtarëve nga njerëz të pafytyrë dhe pa traditë, por të cilët e kanë model faraonin e Musait a.s. dhe Ebu Lehebin e hazreti Muhammed Mustafasë a.s. Këtë muaj kalojeni duke heshtur, duke e kuptuar heshtjen, duke e përjetuar heshtjen, që vetëm ju lartëson dhe ju largon nga gabimet që ju detyrojnë të pendoheni dhe ju ndërgjegjëson që ta kundërshtoni dhe luftoni hilen e shejtanit të padukshëm dhe të dukshëm, që është i gatshëm të tallet me ne dhe të krijojë frikë që nuk ka mbështetje askund, pos në frazat e kota plot dënim dhe frikë.





SHKURT

Agjërimi është një mundësi se si duhet besuar Zotin, si duhet jetuar dhe si duhet vdekur. Agjërimi na përkujton momentumin e fesë, që nuk ka përsëritje. Kjo nënkupton se as Lindja e as Perëndimi, as “turku” e as “kauri”, as perandoritë e as demokracitë, nuk mund të japin/marrin besim/fe. Agjërimi është qytetërim dhe rrugëtim shpirtëror...

Fenomeni i agjëritimit ndodh gjithmonë në vend dhe në çast. Por, ai ka ardhur aty nga diku dhe prej aty shkon diku. Njeriu, si shfaqje qendrore e ekzistencës së gjithmbarshme, mund të dijë diçka për atë se nga ka ardhur dhe ku shkon. Në atë dije ka pak siguri, edhe pse ajo është dëshira më e rëndësishme e tij/saj. Dhe, kjo është arsyeja se përse përgjigjet ndaj pyetjeve “Prej nga?”; “Ku?” dhe “Kur?” janë pyetje themelore për individin, bashkësinë dhe njerëzimin. Ato janë në qendër të çdo tradite, ndërsa agjërimi e lehtëson gjetjen e tyre. Përgjigjet ndaj atyre pyetjeve janë gjithmonë edhe rrëfim i rrugës nga njëra skajshmëri në tjetrën. Nëse ato skajshmëri janë të paraqitura si tërësi, e cila është gjithmonë e njëjtë, njeriu është në kthim, me ç’rast gjithçka në rrugën e tij është e kushtëzuar dhe jo e përhershme.

Rrugët drejt asaj tërësie mund të jenë pafundësisht shumë, ngaqë ajo duhet të jetë pafundësisht e afërt ndaj çdo kushtëzimi. Ajo përshkon çdo dukuri si përmbajtje fillestare e saj. Por, gjithë këtë njeriu mund ta dijë vetëm nga ekzistimi në botë. Ndërkaq kjo nënkupton shumësinë dhe kushtëzimin. Ai është këtu qenie nga toka dhe në tokë, ndërsa të gjitha rrugët e njeriut në tokë mund të jenë

të duhura, pavarësisht nëse i kapërcejnë rrafshinat, malet ose detet. Mirëpo, secila e arrin kufirin e njohshëm, të cilin nuk mund ta kapërcejë.

Vetëm një rrugë është “e pamundur”. Ajo është rruga përpjetë, ajo drejt qiellit. Asaj, si rrugë, i përgjigjet brendësia njerëzore dhe duket sikur vetëm ajo e përcakton njeriun si çiltërsi. Këtë rrugë e mundëson.

Pyetjet: “Cila rrugë është e duhura?” dhe “Cila është koha e duhur?” mund të kenë përgjigje të shumta. Thuajse te të gjitha ato mund të veçohen dy si përmbajtje qenësore të tyre: e para është të mbijetohet tani dhe këtu, kurse e dyta është të qenit i lumtur tani dhe këtu. Edhe njëra përgjigje edhe tjetra janë të paplota. Së pari, ngaqë çdo vdekje është në ndonjë “tani dhe këtu”. Dhe, askush nuk i ik asaj. Së dyti, ngaqë asnjë lumturi nuk është përhershëmëri, ajo është gjithmonë përhershëmëri e papërhershëmërisë. Për aq sa njeriu aspiron pas saj, ajo i ik. Ndërsa ky largim i saj e nxit dhe e forcon aspiratën, dhimbjen dhe vuajtjen. Krahas kësaj, “këtu dhe tani” sjell deri te kufiri i të Pakufishmit, ku nuk vlejnë përgjigjet nga bota.

Kjo përmbledhje është shumë e shkurtër dhe ka për qëllim të mësojë disa rregulla se si duhet të jetë agjërimi; si mundemi edhe në mënyrë të arsyeshme të shëtisim brenda një metafizike që e paraqet agjërimi, si një lloj *logosi* të lutjes nga Edeni e deri tek eskatoni.

Në përgjithësi, kjo përmbledhje ka një thirrje drejtuar mendjes sonë, që të jemi sa më të kujdesshëm ndaj fenomeneve të ndryshme, e sidomos ndaj nevojës për kulturën e pranimit dhe refuzimit të “fesë”.

“Agjëroni që të jeni të shëndetshëm!”

Prof. dr. Ismail Bardhi që prej tre dekadash merret me hulumtime rreth çështjes së besimeve. Që nga viti 1987, kur është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajeve, profesor Bardhi ka arritur të bëhet njëri ndër emrat më të spikatur të teologjisë islame në rajon, por pse jo edhe në botë, duke sjellë një frymë të re të ligjërimit dhe transmetimit të dijes mbi fenë, në përgjithësi, dhe mendimin islam, në veçanti. Gjatë këtij rrugëtimi intelektual, prof. Bardhi ka vazhduar studimet pasuniversitare dhe të doktoraturës në Universitetin e Ankarasë, ndërsa në vitin 2004 ka marrë titullin profesor.

Në karrierën e tij profesionale, prof. Bardhi ka ligjëruar fillimisht në Medresenë "Isa Beu" në Shkup, ndërsa më pas ka ligjëruar edhe në Fakultetin e Shkencave Islame në po të njëjtën kryeqendër. Ndërkaq në periudhën 2000-2006 ka qenë dekan i këtij fakulteti. Për shkak të mospajtimit me autoritetet e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, është larguar nga ky fakultet. Si ligjërues dhe hulumtues shkencor ka punuar në disa qendra të rëndësishme shkencore, si në Islamabad, Stamboll, në SHBA (University of Southern California Center for Religion and Civic Culture), ndërsa aktualisht është pa ndonjë angazhim profesional.

Është themelues i Shtëpisë Botuese "Logos-A" në vitin 1990, ndërsa një vit më vonë, për dy vite radhazi, ka qenë edhe këshilltar politik i ambasadorit të Bosnjë e Hercegovinës në Tiranë.

Veprimtaria e tij shquhet me pjesëmarrje në shumë konferenca ndërkombëtare rreth dialogut mes feve, ndërsa në një numër të madh të tyre emri i tij figuron edhe si organizator.

Është autor i disa veprave, por edhe i shumë shkrimeve shkencore e publicistike, që shquhen për thellësinë e të menduarit dhe vështrim përtej kornizave triviale të të gjykimit intelektual.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

CIP - katalogu në publikim
Biblioteka Kombëtare Universitare
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

28-562

BARDHI, Ismail
Amanet Ramazani : doracak / Ismail Bardhi. - Shkup : Logos-A,
2019. - 150 fq. : илустр. ; 21см. - (Biblioteka Mendimi islam)

ISBN 978-9989-58-769-6

а) Рамазан
COBISS.MK-ID 110035466

